



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV  
TIRANË

NR.15600 (31103-04003-86-2017) AKTI

NR.1240 (86-2024-1342) VENDIMI

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Apelit Administrativ, në trup gjykues të përbërë nga:

Blerona Hasa-----Kryesuese;  
Aitina Nasufi-----Anëtare;  
Eriol Roshi-----Anëtar,

asistuar nga sekretare gjyqësore Sonja Traja, sot me datë 27.06.2024 ora 13.45, shqyrtoi në dhomë këshillimi, çështjen administrative Nr.15600 (31103-04003-86-2017) Akti Dt.24.07.2017, me:

PADITËSA: - Romina Mustafaraj.

- Tetem Mustafaraj.
- Kujtim Sulaj.
- Namik Lamçaj.
- Ahmet Skenderaj.
- Ylli Brahimaj.
- Riza Zekaj.
- Tetem Lamaj.
- Asaf Murataj.
- Çezar Haxhaj.
- Haxhi Brahimaj.
- Kastriot Brahimaj.
- Erdis Mustafaraj.
- Ismet Qamili.
- Qani Malaj.
- Mustafa Murataj.
- Tetem Myrtaj.
- Kastriot Musaraj.
- Robert Muhametaj.
- Kismet Murataj.
- Driseld Canaj.
- Trifon Murataj.
- Gentjan Dervishaj.
- Adriatik Mahmutaj.
- Xhentila Haxhaj.
- Nuri Malaj.
- Denis Canaj.
- Demir Murataj.
- Tefti Shehaj.

- Bajram Islamaj.
- Fatime Islamaj.
- Eduart Lamçaj.
- Guri Islamaj.
- Hekuran Brahimaj.
- Luan Canaj.
- Flatun Skenderaj.
- Agron Kapllanaj.
- OJF "EuroNatur".
- OJF "Riverwatch".
- Shoqata "EcoAlbania".

**TË PADITUR:** - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.  
 - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.  
 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

**PERSON I TRETË:** Shoqëria tregtare "Kovlu Energji" sh.p.k.

**OBJEKTI:** - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Deklaratës Mjedisore lëshuar nga Ministri i Mjedisit me nr. Identifikimi 19, nr. Vendimi 17, nr. Prot. 663, datë 24.04.2015 me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.  
 - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 228, datë 24.11.2015 dhe çdo akti tjetër të Ministrit që i paraprin atij që ka vendosur në parim realizimin e procedurave koncesionare;  
 - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 1, datë 21.04.2016 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë MEI dhe të gjitha veprimeve të tjera administrative të prejardhura nga Urdhri i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 228, datë 24.11.2015.  
 - Konstatimin e paligjshmërisë së kontratës së lidhur mes MEI dhe Subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "KOVLU ENERGJI" sh.p.k me NIPT L62010004L, kontrate Noteriale me nr. 2174 Rep., nr. 755 Kol., e datës:05.09.2016, njoftimi për të cilën është botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 43, datë 31.10.2016, si veprim që nuk prodhon pasojë juridike, ose nëse do të konsiderohet e nevojshme detyrimin e MEI për të zgjidhur kontratën për arsye të interesit publik.  
 - Pezullimin e zbatimit të kontratës së lidhur mes MEI dhe Subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "KOVLU ENERGJI" sh.p.k deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes me vendim të formës së prerë.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Ligji Nr. 8485 Dt. 12.05.1999 "Kodi i Procedurës Administrative", Ligji Nr. 125/2013 Dt.25.04.2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", Ligji Nr. 8561 Dt.22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publik", Ligji Nr. 8672 Dt.26.10.2000 "Për ratifikimin e Konventës "Për të drejtën e publikut për t'iu informuar, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore" (Konventa e Aarhusit), Ligji Nr. 8294 Dt.02.03.1998 "Për ratifikimin e Konventës "Për ruajtjen e

florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës" (Konventa e Bernës), Ligji Nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor", Ligji Nr. 10440 Dt.07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", Ligji Nr. 10431 Dt.09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr. 576 Dt.10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet", VKM Nr. 13 Dt. 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis", VKM Nr. 247 Dt.30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", VKM Nr. 507 Dt.10.06.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasojë negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor", VKM Nr. 127 Dt.23.03.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publik", VKM Nr. 416 Dt.13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit "Për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes "Për përdorim të burimeve ujore".

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me Vendimin Nr.1813 (1845) Dt.02.05.2017, ka vendosur:

*"- Pranimin e kërkespadiës së paraqitur nga paditësit Romina Mustafaraj, Tetën Mustafaraj, Kujtim Sulaj etj, banorë të fshatit Kute Mallkastër dhe shoqata "Eco Albania".*

*- Konstatimin e pavlefshmerisë absolute të Deklaratës Mjedisore nr.663 prot. dhe nr.vendimi nr.17 datë 24.04.2015 të lëshuar nga Ministri i Mjedisit.*

*- Konstatimin e pavlefshmerisë absolute të Urdhërit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr.228 datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhënien e koncesionit të hidocentralit "Poçëm" dhe Urdhërin nr.228/1 datë 22.01.2016 "Për një ndryshim në Urdhërin nr.228 datë 24.11.2015.*

*- Konstatimin e pavlefshmerisë absolute të Vendimit nr.1 datë 21.04.2016 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë MEI "Për vlerimin e ofertave për dhënien me koncesion të hidocentralit "Poçëm".*

*- Konstatimin e paligjshmerisë absolute të kontratës së koncesionit me nr.2174 rep. dhe nr.755/4 kol. datë 05.09.2016, e formës "Bot" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidocentralit "Poçëm" të lidhur midis Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "KOVLU ENERGJI" sh.p.k.*

*- Rrëzimin e padisë për palët paditëse, organizata jofitimprurëse "Riveratch" dhe organizata jofitimprurëse "Euro Natur" si të pabazuar në ligj, kjo për shkak të moslegjittimitit aktiv.*

*- Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga pala paditëse në shumën 43.000 (dyzet e tre mijë) leke lihen në ngarkim të palëve të paditura.*

*- Ky vendim është titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510/a të K.Pr.Civile, për pjesën që bën fjalë për shpenzimet gjyqësore dhe është drejtpërdrejt i ekzekutueshëm nga Zyra e Përmbarrimit shtetëror/privat, nga data që ky vendim merr formë të prerë.*

*- Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Administrative të Apelit Tiranë duke filluar nga e nesërmyja e shpalljes së vendimit, dhe për palët në mungesë nga e nesërmyja e marrjes dijeni për vendimin".*

**Të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit**, rezulton të kenë ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padisë, për këto shkaqe:

*"Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të Ministrisë, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, referuar ARM-te.*

*Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis/"Deklarata mjedisore", lëshuar nga Ministri, është dokumenti zyrtar për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis.*

*Gjykata në Vendimin e saj në mënyrë totalisht arbitrare dhe të pambeshtetur në ligj pretendon se: "nuk është respektuar procedura e parashikuar në ligjin 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, si dhe aktet nenligjore të nxjerra në zbatim të tij."*

*Fillimisht vërejmë se rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative parashikohen në bazë të nenit 108 të Ligjit 44/2015, si në vijim:*

*a)kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:*

*i) kompetencën e organit publik;*

*ii) procedurën e nxjerrjes së tij, ose*

*iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;*

*b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale;*

*c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;*

*c) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj".*

*Sipas Vendimit të Gjykatës pretendohet se akti administrativ "Deklarate mjedisore" e Ministrisë së Mjedisit vjen në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi lidhur me procedurën e nxjerrjes së tij.*

*Në të vertet, gjatë gjykimit në shkallë të parë kemi provuar se akti administrativ "Deklarate mjedisore" e Ministrisë së Mjedisit, është nxjerrë konform legjislacionit në fuqi, bazuara në faktet dhe argumentat në vijim.*

*I. Konsultimi me publikun.*

*Pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kuadër të organizimit të konsultimit me publikun, është bërë kërkesë shkresore me Nr Protokollit 317 datë 18.02.2015 për tërheqje të formularit tip për konsultim me publikun lidhur me aktivitetin dhe shogërinë Cinar-San Tirana BRANCH nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar GR Albania, me NIUS L01509004N, me objekt agjenci vlerësimi mjedisor.*

*Konsultimi i publikut është realizuar konform legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit si dhe VKM-se Nr.247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".*

*Dhe konkretisht, janë njoftuar dhe ftuar të gjitha palët e interesuara në debatit e hapur dhe janë bërë konsultimet me publikun në lidhje me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit që do të kryejë Cinar-San Tiran Branch.*

*Sa më lart, rezulton plotësisht e provuar në bazë të Raportit të Konsultimit me publikun për hartimin e VNM-se, që subjekti ka depozituar edhe në OKL, së bashku me setin e dokumentacionit sipas ligjit, për miratimin e deklaratës mjedisore.*

*Njoftimi së bashku me VNM u publikuan në WEB zyrtar të AKM-se: www.akm.gov.al tek dritarja Publiku, në Shkurt 2015 - njoftimi on-line që realizon AKM-ja.*

*Gjithashtu Konsulentit, që në këto rast ishte GRAlbania, shpërndau dhe njoftime të tjera me shkrim dhe verbalisht me telefon duke ftuar palët e interesuara në këtë proces.*

Per sa me lart rezulton se janë njoftuar dhe ftuar per konsultime disa kompani ndërtimi, organizata jofitimprurëse dhe përfaqësues te shoqërisë civile, përfaqësues te kadastrës dhe komunave si dhe ftese qe i është dërguar AKM-se.

Veme ne dukje, ne lidhje me realizimin e dëgjësës publike se keto procedura janë zhvilluar (sipas njoftimit perkates) rregullisht ne nje nga sallat e Hotel "Fieri" ne qytetin e Fierit.

Gjate dëgjësës ka pasur nje debat te gjere nga te pranishmit e shumte ne numër - rreth 50 persona te sferave te ndryshme te cilët përfaqësonin te gjitha palet e interesuara.

Gjate dëgjësës ka pasur pjesëmarrje edhe nga AKM-ja dhe nga firma e interesuar per te ndjekur nga afer procesin e konsultimit qe filloi sipas regjistrimit ne aren 11:00.

Gjykata nuk ka marr ne konsiderat dokumentacionin ne lidhje me listën e pjesëmarrësve si dhe nje material fotografik per realizimin e dëgjësës qe është niese integrale e Raportit per Konsultim me Publikun dhe qe jane paraqitur ne cilësinë e provës ne këtë gjykim.

Pra, ne kundërshtim nga sa pretendohet ne vendimin e gjyqates, është fakt i pakundërshtueshem realizimi i proceduarave ne lidhje me degjese publike, konform kërkesa te ligjit.

*II. Aplikimi i dosjes se subjektit nga konsulenti nëpërmjet QKL.*

Pasi realizohet konsultimi me publikun vijon faza e II e procedurës: Aplikimi i dosjes se subjektit nga konsulenti nëpërmjet QKL.

Bazuar ne Vërtetimin e Aplikimit nëpërmjet portalit te QKL me Nr. LC-2092-04-2015 date 7.04.2015, kërkuesi i licencës Cinar-San Tiran Branch me Nipt L22124014S kërkon te licencohet për kategorinë e veprimtarisë "Ndikim ne mjedis" dhe me specifike per veprimtarinë "Për procedurën e Thelluar te Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis per Projektin: Ndërtimi HEC-it Pocem (Shtojcal. pika 15) me vendndodhje fshati Pocem, Komuna Kute, Rrethi Mallakastër Qarku Fier.

Pasi dosja mbërrin ne forme elektronike pranë Agjencisë Kombëtare te Mjedisit, Drejtoria e Vlerësimit Mjedisor, Sektorit i VNM-se, dhe ne mbështetje te Urdhrit te Brendshëm Nr.140 date 19.09.2014 te Drejtorit te Përgjithshëm te AKM-se Z. Julian Baqiri, është ngritur Komisionit Teknik pranë Agjencisë Kombëtare te Mjedisit per verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave qe i nënshtrohen Procedurës Paraprake dhe te Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis me përbërjen si me poshtë:

- Drejtori i Drejtorisë se Vlerësimit Mjedisor i AKM-se;
- Pergjegjes i Sektorit te Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis, AKM;
- Juristi i AKM;
- Specialist ne Sektorin e Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis (protokoll);
- Specialist ne Sektorin e Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis (prezantim);
- Pergjegjesi i Sektorit te Lejeve Mjedisore;
- Pergjegjesi i Sektorit te Pergjegjesive Mjedisore.

Ky komision, bazuar ne rregulloren e miratuar nga AKM-se, verifikon saktësinë e informacionit te dhënë nga operatori Cinar-San Tiran BRANCH ne kërkesën e tij për t'u pajisur me Vendim per VNM te Thelluar e Deklarate Mjedisore dhe ka relatuar pranë Drejtorit te Përgjithshëm te Agjencisë Kombëtare te Mjedisit me date 22.04.2014 duke e shqyrtuar dokumentacionin e aplikuar nëpërmjet QKL (bashkëngjit prapësimit) si:

- 1-Kerkese per aplikim te QKL e Subjektit Cinar;
- 2-Autorizim +ID i studios konsulente;
- 3-Raporti konsultim me Publikun;
- 4-Tarfa e paguar per aplikimin e Deklarates;
- 5-QKR;
- 6-Shkrese MEI 05.03.2015;
- 7-Raporti i VNM;
- 8-Raporti teknik.

Ne Komisionin Nr.17, pas shqyrtimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKM-se vendosi "Te zbardhet Deklarata Mjedisore me kushte, per te minimizuar ndikimet ne mjedis. Deklarata është e vlefshme pasi subjekti të pajiset me Kontrate Koncesioni. Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të pajiset me Leje Shfrytëzimi të burimeve ujore nga KBU përkatëse."

Edhe ne këtë rast, ne kundërshtim nga sa pretendohet ne vendimin e gjykatës është fakt i pakundërshtueshem realizimi i te gjitha proceduarave, konform kërkesa te ligjit.

### III. Deklarata mjedisore.

Deklarata Mjedisore Nr. Prot.633 me date 24.04.2015 miratohet nga Ministri i Mjedisit me propozim te AKM-se.

Kjo Deklaratë Mjedisore permban te dhenat si me poshte:

Person juridik: "Çinar-San Tiran Branch" me LC-2092 me Nipt L22124014S.

Adresa e selite: Pallati Fitnes Nobis, Kulla F, Pruga "Samë Frackëri", Tiranë.

Personi përgjegjës: Yuksel Çinar.

Për të zhvilluar projektin: "Ndërtim i HEC-it Poçem".

Bazuar ne Ligjin Nr.10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", dhe Ligjin Nr.10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", Shtojca 1 pika 15. Diga dhe instalime të tjera, që janë projektuar për të penguar daljen e ujit ose për të depozituar ujin në mënyrë të përhershme, ku një masë e re ose shtesë uji e penguar ose e depozituar është mbi 10 milionë m<sup>3</sup>.

Vendodhja: Fshati Poçem, Komuna Kutë, Rrethi Mallakastër, Qarku Fier.

Të dhënat teknike:

- Tipi: Digë me rezervuar të madh.
- Kuotat e shfrytëzimit: 34-72 m asl.
- Sipërfaqja rezervuarit: 23.5 km<sup>2</sup>.
- Volumi i rezervuarit: 295 mil m<sup>3</sup>.
- Fuqia instaluar: 102.2 MË.
- Energjia e prodhuar: 366.8 GEh.
- Kosto investimi: ~160,1 Euro.

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr.10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", më poshtë po listojmë.

#### 1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike.

• Drejtoria e Pyjeve: Subjekti "Çinar-San Tiran Branch", me aktivitet "Ndërtim i Hecit Poçem", shprehemi se mbështetur në hartën zyrtare të Zonave të Mbrojtura, bazuar në koordinatat e dhëna nga subjekti në VNM-në paraprake, ST1, ST3, RR3, SK2, dhe Aksi i Digës Poçem ndodhen në lumin e Vjosës; ST2, RR2, RR4, SK3, SK4 ndodhen në komunën Vllahinë në kufi; RR1, SK1 ndodhen në komunën Kutë. Koordinatat e dhëna ndodhen në planshetën K-34-124-C-b, hartë topografike 1:25000 dhe nuk prekin në zone të mbrojtur.

• Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier: Në vijim të zbatimit të Ligjit Nr.10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të Ligjit Nr.10 431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi, Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Fier pasi bëri verifikimet e nevojshme në mjediset e aktivitetit dhe të Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nuk verejti mangësi.

#### 2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun.

Konsultimi me publikun: Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cenuar jetën e banoreve.

#### 3. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur ky vendim:

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk prek apo cenon:

• Zona të mbrojtura,

• Fond Pyjor.

- Burime ujore te vecanta/jetike.
  - Objekte kulturi, monimente kulturre me rendesi fetare, historike, arkeologjike.
  - Jeiën dhe shëndetin e banorëve përreth.
- 4.Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.
- Ky objekti të ndërtohet në përputhje të plotë me Kontratën Koncensionare, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT/ Bashkia/Komuna) dhe akteve ligjore në fuqi.
- Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të pajset me Kontrate Koncensionare.
- Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të pajset me Leje Shfrytëzimi të burimeve ujore nga KBU përkatëse.
  - Të instalohen të gjithë ngrengatet e deklaruar në raportin e VNM-së ku përfshihen edhe ato që parandalojnë apo minimizojnë ndikimet në mjedis.
  - Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda koordinatave të dhëna në relacionin teknik.
  - Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gërmimit gjatë fazës së ngritjes së digës të përdoren për sisteminin e shtratit të rrjedhes ujore.
  - Në periudhën e verës, për shkak të kohës së thatë, ndërhyrjet të bëhen në mënyrë shumë të kujdesshme.
  - Të sistemohet shtrati i burimit ujor me dherat dhe inertet që do të gjenerohen nga gërmimi për shtratit e tij.
  - Të forcohen brigjet e rrjedhes ujore duke mbjellë fidanë të rinj në brigjet e saj paralelisht me ndërtimin e veprës.
  - Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
  - Ndërtimi i HEC-it të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe objekteve të tjera në afersi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësullësi kanale etj.
  - Për asnjë arsye të mos çenohet aktiviteti i përditshëm bujqësor i banorëve përreth, duke minimizuar kështu impaktin social.
  - Të bëhet kujdes me ruajtjen e ekosistemit ujor, duke mos çenuar në asnjë mënyrë segmentet ujore.
  - Për asnjë arsye mos të ketë prerje pemësh në mjedisin ku do të kryhen punime.
  - Të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe standartet, për operimin e punës brenda subjektit sipas relacionit të përshkruar në VNM.
  - Niveli i zhurmave gjatë procesit të ndërtimit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët (jo herët në mëngjes dhe jo vonë në mbrëmje).
  - Të merren masat teknike dhe organizative për zbutjen e ndikimeve në mjedis të gjeneruara nga operacionet e gërmimit dhe gjenerimit të dherave.
  - Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
  - Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
  - Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, sidomos ato të ambalazhimit (ambalazhe, bidona, kuti, qese etj), duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore.
  - Të parashikohen dhe merren masa për parandalimin dhe kontrollin e ndotjeve në tokë gjatë fazës së instalimit të pajisjeve teknologjike për ndërtimin e veprave, si derdhje lëndësh ndotëse, vajra lubrifikues, graso, karburante etj.
  - Të përdoren mjete të kolauduara për ndërtimin dhe zbatimin e projektit, me qëllim evitimin e ndotjeve të mundshme si pasojë e dëmtimit apo avarie të mundshme.

Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve;

Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive të bëhet vetëm brenda sipërfaqes së kampeve të ndërtimit dhe në vendin e përcaktuar;

Transporti i materialit inert të bëhet me mjete të pastra sidomos nga balta (të pastrohen gomat para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjetet transportuese të mbulojnë me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e materialit në rrugë dhe emetimin e pluhrave;

Shërbimi i automjeteve, magazinimi ose mbajtja e mjeteve ndihmëse të punës si pjesë këmbimi për automjete, lubrifikante, goma etj, të bëhen në vende të tilla që të evitohet dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis;

Të marrin masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren (shpime, cigare etj) dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);

Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatet teknologjike të mbrojtjes së mjedisit; Subjekti të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

Operacionet e ndërtimit të veprës të shmangin në maksimum dëmtimin e tokës dhe pengojnë zhvillimin e proceseve të degradimit mjedisor, si erozionin etj;

Për parandalimin e rrjedhjes së sterve në drejtim të rrugës, përrrenjve apo proskave të zonës, të bëhet depozitimi i tyre duke ndërtuar mure gabioni, blloqe gurësh të çrregullt ose instalimi i rrjetave metalike në shpatet e malit, si dhe sistemimi i masave të dheut që dalin nga ndërtimi i veprës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave nga ndotjet e mundshme dhe kompaktësinë e formacioneve gjeologjike të zonës.

Masat e dheut që gjenerohen nga punimet ndërtimore duhet të mbahen nën kontroll dhe të mos lejohen të rrëshqasin dhe sedimentojnë në rrjedhat ujore në zonën e ndërtimit, përfshirë edhe shtratin e ujëmbledhësit (rrixin turbullirën, dëmtojnë gjendjen natyrale të lumit, etj.) dhe të sistemohen në vendepozitime të paracaktuara në bashkëpunim me qeverisjen vendore.

Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë kantierit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

Në rast aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktajnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM-në, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident. Para fillimit të veprimtarisë të trajtohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat e Deklaratës dhe pasojat e mos-zbatimit të tyre në mjedis dhe në marrëdhëniet e subjektit me organin e dhënies së Deklaratës që të evitohet dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis.

Më qëllim mbrojtjen e ekosistemit dhe natyrallitetit të përroit në segmentin ku do ndërtohet hidrocentrali shoqëria të lejojë rrjedhjen në shtratin egzistues të lumit dhe burimeve ujore sasinë e ujit minimalisht  $Q_{ak} = 35\%$  të prurjes natyrale të lumit dhe të burimeve. Në stinë të thatë kjo përqëndje të jetë më e lartë, në bazë të prurjes së lumit (deri në 100 % të prurjes), duke mos lejuar në asnjë mënyrë që në rrjedhjen e lumit të mos ketë ujë.

•Përgjatë gjithë perimetrit dhe sheshit ku kryhet aktiviteti të mbillen kurorë pemësh të larta në mënyrë që të reduktohet impakti negativ në pamjen e zonës.

•Për të ruajtur informacionin mbi zbatimin e kushteve të Deklaratës, gjatë fazës së ndërtimit të veprës, subjekti duhet të përpillojë një regjistër të veçantë për monitorimin e cilësisë së tokës, ajrit dhe ujërave, si dhe prurjen e rrjedhës ujore gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve; të cilin duhet ta vëre në dispozicion të institucioneve shtetërore si dhe të interesuarve të tjerë për përmbajtjen e këtij regjistri.

•Të pastronet menjëherë çdo rast ndotjeje të mjedisit brenda dhe jashtë objektit si pasojë e aktivitetit.



•Të dimensionohen dhe ndërtohen veprat e shuarjes së energjisë së rrymës ujore pas daljes nga kanali me deviacion, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e erozionit ujqor.

•Të bëhet pajisja me tabela informuese dhe drejtuese për shmangien e rreziqeve dhe pasojave me ndikim në mjedis brenda zonës së veprave.

•Të hartohet Plani i Përballimit të Emergjencave i plotë dhe i detajuar, para vendosjes në funksionim të veprës dhe të raportohet pranë AKM-së për përmbajtjen e këtij plani.

•Të trajnohen të gjithë punonjësit dhe të njihen me termat e Planit të Përballimit të Emergjencave.

Gjatë fazës së rehabilitimit:

•Në përfundim të aktivitetit ndërtimor të hidrocentralit të rehabilitohet sipërfaqja e ndikuar nga ndërtimi i tij (rrugë sheshe nër depozitim materialesh kanali i derivacionit)

•Para fillimit të operacioneve të ndërtimit të hartohet plani rehabilitimit mjedisor i plotë dhe i detajuar i rehabilitimit të bimësisë dhe territorit ku do të kryen punimet për realizimin e projektit.

•Të sistemohet sipërfaqja e shesheve të veprave dhe brigjeve të përroit dhe të bëhet mbjellja e pemëve dhe bimësisë autoktone.

•Plani i rehabilitimit mjedisor përfshin zonat ku do të realizohen punime rehabilituese, volumin dhe llojin e punimeve, përfshi dhe afatet kohore të realizimit të punimeve të rehabilitimit.

•Duhet të raportojë periodikisht pranë AKM-së për ecurinë e punimeve të rehabilitimit mjedisor.

5. Detyrime të monitorimit dhe raportimit mjedisor gjatë fazës së ndërtimit të veprës:

Monitorimi është procesi i vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave në mënyrë periodike ose të vazhdueshme mbi fenomenet natyrore që zhvillohen në objekt, si pasojë e ndërtimit të veprës. Vetmonitorimi i veprimtarisë realizohet në bazë të programit individual të monitorimit i cili duhet të trajtojë çështjet e mëposhtme:

•Monitorimi i ndotjes akustike si pasojë e punimeve të ndërtimit të veprës.

•Monitorimi i ndikimeve të veprimtarisë në mjedisin përreth dhe elementë të tij.

•Monitorimi i mënyrës së zbatimit të kushteve të Deklaratës.

•Monitorimi i ecursisë së realizimit të masave të rehabilitimit dhe efektivitetit të tyre.

•Monitorimi i rrjedhës natyrore të burimit ujqor që përdor hidrocentrali, prurjen ekologjike, si edhe zhvillimin e gjendjen e biodiversitetit.

6. Sanksionet e mundshme:

•Për mos respektimin e kushteve të Deklaratës dhe të legjislacionit mjedisor ka sanksione ligjore:

Ndëshkimi administrativ dhe penal i subjektit që nuk zbaton kushtet e Deklaratës.

•Pezullimi i aktivitetit për një afat kohorë.

7. Raportimi i të dhënave mjedisore:

•Në zbatim të kërkesave ligjore subjekti duhet të bëjë vlerësimin mjedisor periodik të veprës gjatë fazës së instalimit:

•Për të mbajtur informacionin mbi monitorimin, zbatimin e kushteve të Deklaratës subjekti duhet të përpilojë një regjistër të veçantë.

•Të dhënat e vetëmonitorimit dhe të zbatimit të kushteve të Deklaratës duhet ta vërë në dispozicion të institucioneve shtetërore, si dhe të interesuarve të tjerë.

•Të njoftohet DRM-ja e qarkut përkatës, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis.

•Gjatë fazës së ndërtimit, për të gjitha termat e mësipërme të Deklaratës, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë AKM-së një relacion shkresor në mënyrë periodike për mënyrën e zbatimit të kushteve (çdo 6-muaj).

•Në përfundim të punimeve subjekti të dorëzojë pranë AKM-se, një relacion ku të pasqyrohen edhe me foto, të gjitha punimet rehabilituese të territorit përreth.

#### **8.Vlefshmëria e Deklaratës:**

•Ky Deklaratës është i vlefshëm pasi veprimtaria të liçensohet nga institucionet përkatëse.

•Mosfillimi i aktivitetit brënda një periudhe dy vjecare sjell për pasojë pavlefshmërinë e Deklaratës për ushtrimin e këtij aktiviteti.

•Pavarsisht kushteve të Deklaratës, veprimtaria është e detyruar të zbatojë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi, Ligji. Nr.10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit.

•Për çdo ndryshim në teknologji, operacione të paparashikuara dhe deklaruar në raportin e thelluar të VNM-së subjekti duhet të riaplikojë për procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Afërditë.

Përfundimisht, duke pasur parasysh sa më sipër, kërkojmë pranimin e kësaj kërkesë ankimore duke vendosur ndryshimin e Vendimit nr. 1831, datë 2.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur për rrezimin e plote të padisë dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore paleve paditëse".

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me Vendimet Dt.02.06.2017 dhe 29.05.2017, pas shqyrtimit paraprakisht të elementëve formalë të ankimeve, ka vendosur në përfundim, pranimin e tyre.

**Avokati i Shtetit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Avokati i Shtetit pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**, rezulton të kenë ushtruar gjithashtu të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke i kërkuar Gjykatës së Apelit Administrativ, ndryshimin e tij dhe rrezimin e padisë, për këto shkaqe:

"Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në mënyrë krejtësisht të gabuar ka arritur në përfundimin se Deklarata Mjedisore me nr. identifikimi 19, Nr.Vendimi 17, Nr. Prot. 663, datë 24.04.2015, lëshuar nga Ministri i Mjedisit, është absolutisht e pavlefshme, pasi është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, e për rrjedhojë edhe Urdhri i Ministrisë të MEI nr.228, datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhënie e koncesionit të hidocentralit "Poçem", Urdhri nr.288/1, datë 22.01.2016 "Për një ndryshim në Urdhrin nr.228, datë 24.11.2015", Vendimi nr.1, datë 21.04.2016 i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe Kontrata Koncesionare Nr.2174 Rep., Nr.755/4 Kol., datë 5 Shtator 2016, janë akte administrative apo veprime administrative absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë mbi bazën e një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm.

Së pari, Fatkeqësisht apo fatmirësisht bëhemi dëshmitar të krijimit të një koncepti të ri juridik, që është pikërisht "paligjshmëria absolute".

Duke iu referuar Ligjit Nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pasi ky ligj ka qenë i zbatueshëm në momentin e zhvillimit të procedurës koncesionare, rezulton se, ky ligj, në asnjë nen të tij nuk parashikon "paligjshmërinë absolute", si një nga format e goditjes së një akti apo veprimi administrativ, e aq më tepër të një kontrate administrative.

Pra, Gjykata, nëpërmjet këtij vendimi, në mënyrë krejtësisht të paprecedentë, i hap rrugë përdorimit në të ardhmen të një koncepti juridik të purregulluar nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e mbi të gjitha ngre në sërë pikëpyetjeve rreth asaj se "çfarë do të kuptojmë me paligjshmëri absolute?", "përveç paligjshmërisë absolute a do të kemi edhe paligjshmëri relative?", " çfarë do të kuptojmë me paligjshmëri relative?" etj.

Duke qenë se, vetë kjo Gjykatë nëpërmjet këtij vendimi nuk i jep përgjigje pyetjeve të tilla, si dhe nuk shpjegon se pse Kontrata Koncesionare është konstatuar si absolutisht e paligjshme, atëherë do të krijohet një gjendje pasigurie për subjektet e të drejtës shqiptare,

pasi ata do të jenë gjithnjë nën frikën se aktet apo veprimet juridike (përfshirë aktet, veprimet dhe kontratat administrative), do të mund të konstatohen nga Gjykata si absolutisht të paligjshëm, pavarësisht se vetë legjislacioni apo doktrina juridike nuk e trajton një koncept të tillë juridik.

Gjithashtu vërejmë se, Gjykata nëpërmjet këtij vendimi ka "konstatuar" paligjshmërinë absolute të Kontratës Konçesionare.

Në bazë të rregullimeve të Kodit të Proçedurave Administrative dhe Kodit të Proçedurës Civile kuptojmë se, vetëm pavlefshmëria absolute mund të konstatohet, pasi është një gjendje e tillë që dëshmon për inekzistencën dhe nulitetin e një akti, si dhe të pasojave juridike që në momentin e miratimit të këtij akti. Atëherë, referuar nga sa konstatuam më sipër, lind pyetja: nëse Gjykata, nëpërmjet këtij vendimi ka konsideruar të barazvlefshëm pavlefshmërinë absolute me paligjshmërinë absolute. Dhe nëse po atëherë Gjykata kurrsesi nuk duhet të ishte shprehur në këtë mënyrë, pasi një kontratë administrative nuk mund të jetë kurrsesi absolutisht e pavlefshme.

Pra, Gjykata nëpërmjet këtij vendimi së pari nuk ka marrë në konsideratë rregullimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi, së dyti, ka krijuar një koncept të ri juridik, të parashikuar në ligj, duke mos dhënë asnjë shpjegim apo interpretim të këtij koncepti, si dhe në kapërcim të çdo parashikimi ligjor dhe interpretimi juridik është përpjekur të konsiderojë të barazvlefshëm pavlefshmërinë absolute dhe paligjshmërinë absolute, duke konstatuar në mënyrë arbitrare dhe të paprocedentë, pavlefshmërinë absolute të një kontrate administrative.

Së dyti, Gjykata ka çmuar se, Deklarata Mjedisore me nr.663 prot., nr.17 Vendimi, datë 24.04.2015 e lëshuar nga Ministri i Mjedisit është absolutisht e pavlefshme, pasi është një akt i nxjerrë në kundërshtim me proçedurën e parashikuar nga ligji nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Një përfundim i tillë është krejtësisht i gabuar dhe i pabazuar në ligj, për arsye se:

1. Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis, pra Deklarata Mjedisore, e lëshuar nga Ministri i Mjedisit, është dokumenti zyrtar për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit të thelluar në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në proçesin e vendimmarrjes për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar dhe që përfshihet në kategorinë III. 1. të shtojcës që i bashkëlidhet ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 "Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë."

Në pikën 7 të nenit 6 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, jepet përkufizimi i "Deklaratës mjedisore", përkatësisht:

"7. "Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis", më poshtë "Deklarata mjedisore", është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në proçesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar."

Proçedura e lëshimit të deklaratës mjedisore rregullohet nga ligji nr.10440, datë 07.07.2011, si dhe nga VKM nr.13, datë 04.01.2013 e VKM nr.247, datë 30.04.2014.

Duke iu referuar akteve të sipërcituara, rezulton se Deklarata Mjedisore është plotësisht e vlefshme, dhe ndryshe nga sa ka konstatuar Gjykata, kjo Deklaratë është nxjerrë në respektim të plotë të proçedurës ligjore.

Kërkesa për t'u pajisur me Deklaratën Mjedisore është paraqitur nga zhvilluesi, e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin shoqërues përkatës. Sipas parashikimeve të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë 07.07.2011, Ministria e Mjedisit mund të miratojë lejen e zhvillimit pa asnjë vërejtje, mund të miratojë lejen me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis, ose të refuzojë kërkesën për leje/licencë për zhvillimin e një projekti.

Deklarata Mjedisore objekt gjykimi është përkatësisht "miratim i lejes me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis", duke theksuar qëndrimin e ministrisë, si dhe duke evidentuar kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi.

Deklarata Mjedisore objekt gjykimi është lëshuar për zhvillimin e projektit, pasi ky projekt nuk çanon: a) zona të mbrojtura, b) fond pyjor, c) burime ujore të veçanta, jetike, ç) objekte kulturi, monumente kulturore me rëndësi fetare, historike, arkeologjike, d) jetën dhe shëndetin e banorëve përreth. Por njëkohësisht, nëpërmjet kësaj deklarate shpjegohen në mënyrë taksative të gjitha kushtet që duhet të përmbushë zhvilluesi, me qëllim marrjen e lejeve të mëtejshme, që i hapin rrugë kryerjes së punimeve në bazë të Kontratës.

2. Procesi i lëshimit të Deklaratës Mjedisore është i lidhur ngushtësisht me procesin e hartimit të Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisë.

"Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)" është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private. Neni 7 i ligjit nr.10440, datë 07.07.2011 parashikon se: "Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreu II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit".

Projekti për ndërtimin e HEC "Poçem" i është nënshtuar vlerësimit të ndikimit në mjedis. Sa i përket këtij projekti, nisur nga rëndësia dhe ndikimi që mund të kishte një projekt i tillë madhor në mjedis, është hartuar një Raport i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Referuar -parashikimit të nenit 25, pika 4, i ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", në të cilin parashikohet: "Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit", vlerësimi i ndikimit në mjedis është kryer nga zhvilluesi, nëpërmjet një eksperti të çetifikuar të VNM, përkatësisht kompanisë "GR ALBANIA Planning & Environmental Consulting Company".

Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata nëpërmjet vendimit, është ndjekur e gjithë procedura ligjore për informimin dhe konsultimin me publikun. Një ndër objektivat kryesore shtetërore është mbrojtja e të drejtës së çdo individi për të jetuar në një mjedis të përshatshëm për shëndetin dhe mirëqenien. Duke ditur rëndësinë që ka informimi dhe konsultimi i publikut është respektuar çdo parashikim ligjor në këtë drejtim.

Ashtu siç është evidentuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, zhvilluesi, pas hartimit të Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ka aplikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nëpërmjet depozitimit të formularëve të plotësuar, me qëllim publikimin nga Agjencia të njoftimit për zhvillimin e degjësës me publikun. Njëkohësisht me kërkesën për formularin është depozituar edhe draft VNM, e cila përmban në mënyrë të detajuar çështjet që do trajtohen në këtë degjëse me publikun, si dhe ato që do të trajtohen në VNM e thelluar. Në respektim të parashikimeve të pikës 2, kreu II të VKM nr. 247, datë 30.04.2014, AKM ka publikuar në faqen zyrtare të eeb njoftimin nr.317, datë 18.02.2015. Ky njoftim ka qëndruar i publikuar për 20 ditë derisa është zhvilluar edhe seanca dëgjimore në datën 28.02.2015. Dëgjesa me publikun është zhvilluar në ambientet e një hoteli në qytetin e Fierit, në të cilin kanë marrë pjesë rreth 50 persona të cilët preken nga ndërtimi i Hidrocentralit.

Ndryshe nga sa pretendon Gjykata, dëgjesa me publikun jo detyrimisht duhet të zhvillohet ekzaktesisht në vendin në të cilin do të ndërtohet hidrocentrali, por mjafton që të përzgjidhet një vend i përshatshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm. E rëndësishme është që, personat të cilët preken nga ndërtimi i hidrocentralit të kenë akses në njoftimin e bërë për vendin dhe orën e takimit me publikun. Dhe për sa kohë që, në këtë degjëse kanë marrë pjesë subjekte të caktuara, atëherë lehtësisht vërtetohet se është përmbushur qëllimi kryesor i njoftimit të publikuar.

Zhvillimi i seances dëgjimore, informimi i publikut të interesuar dhe të ndikuar është tregues i faktit se njoftimet e kryera nga zhvilluesi kanë ezauruar qëllimin e konsultimit publik që kërkon legjislaçioni në fuqi.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.10440, datë 07.07.2011, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Aplikimeve për vlerësimin e ndikimit në mjedis për miratimin e VNM së thelluar dhe deklarata mjedisore përkatëse janë publikuar në faqen elektronike të Agjencisë Kobëtare të -Mjedisit.

Pra, ndryshe nga përfundimi i arritur nga Gjykata, informimi dhe pjesëmarrja e publikut në VNM, nuk ka qenë aspak fiktive dhe joezauruese.

Gjykata, në mënyrë krejtësisht të paarsyeshme, të pabazuar dhe absurde, vetëm për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të Deklaratës Mjedisore, ka konstatuar si absolutisht të pavlefshëm edhe Urdhrin e Ministrit të MEI nr.228 datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhënten e konçesionit të hidocentralit "Poçem", Urdhri nr.288/1, datë 22.01.2016 "Për një ndryshim në Urdhrin nr.228, datë 24.11.2015", Vendimi nr.1, datë 21.04.2016 i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe Kontrata Konçesionare Nr.2174 Rep., Nr. 755/4 KoL, datë 5 Shator 2016.

Një përfundim i tillë përveçse është absurd, gjithashtu është krejtësisht i pallogjikshëm. Së pari, rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative janë të parashikuara shprehimisht në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative (Kodi i mëparshëm), i cili prashikon se: "Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

a)kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar,  
b)kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;

c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji."

Ky nen parashikon në mënyrë shteruese të gjitha rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative dhe nëse nuk ndodhemi në një nga këto raste, atëherë subjektet nuk mund të pretendojnë pavlefshmërinë absolute të aktit.

Duhet të theksojmë se, Urdhëri i Ministrit të Energjisë dhe industrisë nr.228, datë 24.11.2015, i ndryshuar me Urdhrin nr.288/1, datë 22.01.2016 "Për një ndryshim në Urdhrin nr.228, datë 24.11.2015", apo dhe akte të tjera administrative të nxjerra përgjatë zhvillimit të procedurës konçesionare janë akte të nxjerra nga një organ plotësisht i identifikueshëm siç është Ministria e Energjisë dhe Industrisë, të nxjerra në përmbushje të kompetencave që ligji i ka atribuar këtij institucioni, si dhe në respektim të plotë të procedurës së parashikuar në ligj.

Deklarata Mjedisore, të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e konstatuar si absolutisht të pavlefshme, pavlefshme të cilës ka qenë shkaku kryesor i konstatimit si absolutisht të pavlefshëm të akteve të nxjerra nga Ministri i MEI dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë MEI, nuk është pjesë e procedurës për nxjerrjen e këtyre akteve, por është pjesë e procedurës që rezulton me miratimin dhe publikimin e VNM së thelluar.

-Që të arrihej në përfundimin se dhe aktet e MEI konstatohen si absolutisht të pavlefshme, duhej bërë vlerësimi nga ana e Gjykatës në raport me parashikimet e ligjit nr.125/2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat", vlerësim të cilin Gjykata në mënyrë krejtësisht arbitrare nuk e ka realizuar.

E gjithë procedura e realizuar nga Ministria e Energjisë dhe industrisë është zhvilluar në respektim të plotë të ligjit nr.25/2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat", që është dhe ligji i aplikueshëm për këtë rast.

Shoqëria e të së drejtës turke, "Çinar-San Hafriyet Nakliyat infaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti", pas kryerjes së studimit tekniko-ekonomik dhe mjedisor, ka paraqitur pranë Ministrisë së Energjisë dhe industrisë propozimin e pakërkuar për ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit Poçem. Si pjesë e dokumentacionit të paraqitur me këtë propozim është Vlerësimi i Thelluar i Ndikimit në Mjedis dhe Deklarata Mjedisore. Dhe vetëm pas shqyrtimit

të detajuar të këtij propozimi, Ministri e Energjisë dhe Industrisë ka nxjerrë fillimisht Urdhërin nr.288, datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhenien e konçesionit të hidrocentralit "Poçem".

Në mbështetje dhe në zbatim të Urdhërit të Ministrisë të MEI, me nr.288, datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhenien e konçesionit të hidrocentralit "Poçem", i ndryshuar me Urdhërin nr.288/1, datë 22.01.2016, Komisioni së bashku me konsulentin e përzgjedhur nga BERZH, shoqërinë AF MERCADOS Energy Markets international" kanë diskutuar, hartuar dhe më pas Komisioni ka miratuar Dokumentet Standarde të Konçesionit (DSK) për hidrocentralin "Poçem", në përputhje me legjislacionin për konçesionet dhe Dokumentet Standarde të Konçesionit-Tip, të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP).

Më pas është vijuar me hedhjen në sistemin e prokurimit elektronik, procedura e konçesionit me datë 24.01.2016 me nr. Ref. -22092-01.24.2016

Duke qënë se në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.125/2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik-privat", procedura për dhenien me konçesion/PPP, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", atëherë njoftimi i kontratës është botuar si në sistemin e prokurimit elektronik që më pas është botuar dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, por edhe në gazetën prestigjioze "The Economist". Për rrjedhojë, si pjesë e Dokumentave të Tenderit janë hedhur në sistemin elektronik dhe versioni në anglisht i tyre.

Në datën 17 Mars 2015, datë e përcaktuar për hapjen e ofertave sipas DSK, u bë hapja e ofertave të dorëzuara për këtë procedurë konkurruese nga ku është konstatuar se është dorëzuar vetëm një ofertë, konkretisht nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive të së drejtës turke, "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi", krijuar nëpërmjet kontratës nr.18090, datë 18.12.2015.

Vlen të theksojmë se, ofertues ka qënë Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive të së drejtës turke, "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi", dh.jo vetëm shoqëria "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti", që është dhe zhvilluesi në favor të të cilit është lëshuar dhe Deklarata Mjedisore. Pra, një element i tillë shërben për të përforcuar faktin se, depozitimi i Deklaratës Mjedisore, si pjesë e dokumentave të ofertës, nuk nënkupton që depozitimi i Deklaratës është pjesë e procedurës së zhvilluar nga MEI, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kësaj Deklarate nuk passjell pavlefshmërinë absolute të akteve të ndjerra nga MEI, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Për më tepër që, MEI, gjatë shqyrtimit të propozimit të pakërkuar, përveç se ka kryer vetë një vlerësim të ndikimit në mjedis të këtij projekti, gjithashtu i është drejtuar edhe AKBN për kryerjen e një Oponence Teknike.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe kualifikues, u vlerësua se ky bashkim i përkohshëm i Shoqërive të kualifikohet më tej.

Më tej u vijua me vlerësimin e dokumentacionit ekonomik-financiar dhe teknik, ku u konstatua se ishin në përputhje me kriteret kualifikuese, për të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar janë mbajtur proces-verbalet përkatëse. Gjithashtu është konstatuar se ofertuesi ka paraqitur studimet e kërkuara mjedisore, hidrologjike, gjeologjike etj, si dhe zgjidhjen teknike të funksionimit të HEC-ve. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e HEC Poçem i paraqitur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive ofertuese parashikon ndërtimin e hidrocentralit të tipit me digë rezervuar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me asistencën e dhënë nga konsulenti "AF MERCADOS Energy Markets international", kualifikon si ofertë të vetme, ofertën e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi" në total me 92 pikë, plus 8 pikë nga bonusi.

Investimi i përgjithshëm për ndërtimin e hidrocentralit Poçem është në vlerën e 14.134.724.113 Lekë/ 100.926.315 Euro pa TVSH, për fuqi të instaluar prej 99.500 kw dhe

prodhim të energjisë elektrike prej 305.393.504 kwh. Ky projekt investimi rezulton rentabël dhe fizibël.

Në përfundim, me shkresën nr.1, datë 21.04.2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i propozon Titullarit të Autoritetit Kontraktues, shpalljen si fitues Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi".

Me shkresën nr.2632/34 prot., datë 29.04.2016, "Njoftim fituesi", Ministria e Energjisë dhe industrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, njofton përfaqësuesin e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi" se oferta e tyre është pranuar.

Njëkohësisht me shkresën nr.2632/33 prot., datë 29.04.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dërgon Formularin e Njoftimit të Fituesit.

Operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive të së drejtës turke, "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi" ka krijuar Subjektin për Qëllime të Veçanta, shoqërinë "Kovlu Enerji" sh.p.k, me të cilën është nënshkruar Kontrata Konçesionare me Nr.2174 Rep. Nr.755/4 Kol, datë 5 Shtator 2016.

Kontrata Konçesionare është publikuar edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike me Nr.43, datë 31 Tetor 2016.

Referuar nga sa u shpjegua më sipër, rezulton se procedura konçesionare, e cila ka konkluduar me nënshkrimin e Kontratës Konçesionare, është zhvilluar në përputhje të plotë me parashikimet e legjislacionit në fuqi për Konçesionat, duke respektuar çdo parashikim ligjor.

Për më tepër që, në nenin 40 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", parashikohet shprehimisht që: "Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta".

Kjo nënkupton se, Gjykata edhe në rast se konstaton ekzistencën e shkeljeve procedurale, në fund vendos për rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi vlerëson se pasojat do të ishin të njëjta. Dhe rasti objekt gjykimi është shembulli më konkret se shkeljet procedurale të cilat rezultuan në deklarimin e pavlefshëm të Deklaratës Mjedisore nuk ndikojnë në procedurën e zhvilluar nga MEI. Por, edhe sikur këto shkelje të kishin ndikuar, pavarësisht tyre, pasojat do të ishin të njëjta.

Së dyti, ndryshe nga sa ka pretenduar pala paditëse në gjykim, siç parashikohet në legjilacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht referuar ligjit nr.9000, dt.30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", parashikohet që fusha e veprimtarisë shtetërore, që përfshihet brenda një ministrie, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Fusha e veprimtarisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë është e përcaktuar me anë të VKM-së nr.833, datë 18.09.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe industrisë", në pikën II të së cilës parashikohet se:

"Ministria e Energjisë dhe industrisë harton dhe zbaton politika që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjetike e minerare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërinë publike, si dhe nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa më miqësore me mjedisin".

Pra, qartësisht kuptohet se ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka vepruar plotësisht në përputhje me kompetencat të cilat ligji dhe VKM-ja e mësipërme i njejnë këtij institucioni.

Me qëllim garantimin e furnizimit me energji të vendit, duke përdorur mjetet që konsiderohen më të përshtatshme, Ministria e Energjisë dhe Industrisë harton dhe zbaton politika që bëjnë të mundur shfrytëzimin e burimeve energjetike.

Duke qënë se, Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike, atëherë i ka dhënë prioritet prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj me anë të procedurave të konçesionit, pasi ndërtimi i hidrocentraleve është një element i rëndësishëm i politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë.

Sa më sipër, Ministria e Energjisë dhe industrisë, në përmbushje të detyrimeve të saj dhe brenda fushës së kompetencave që VKM-ja i rreh këtij institucioni, ka vlerësuar që forma "BOT" e konçesionit është një formë konçesioni e përshtatshme për ndërtimin e Hidrocentralit të Poçemit, me qëllim shfrytëzimin e këtij burimi energjetik në funksion të zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike.

Së treti, ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, studimi i fizibilitetit është pjesë e dokumentave konçesionare dhe Ministria e Energjisë dhe industrisë, si Autoriteti Kontraktues ka bërë një vlerësim të të gjithë aspekteve të projektit të propozuar.

Bashkimi i Përkohshëm të Shoqërive "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi" ka paraqitur studimin e fizibilitetit në të cilin parashikon ndërtimin e hidrocentralit të tipit me digë rezervuar.

Gjithashtu, Komisioni i Ngritur për Ndërtimin e HEC Poçem ka bërë vlerësimet e dokumentacionit teknik, tekniko-financiar, mjedisor, gjë e cila mund të provohet përmes procesverbaleve përkatëse.

Ofertuesi propozoi ndërtimin e Hidrocentralit "Poçem" me digë dhe rezervuar që do të shfrytëzojë ujërat e rrjedhjes së poshtme të lumit Vjosa, në afërsi të fshatit "Poçem", në anën e poshtme të HEC Kalivaç, që do të thotë se ky hidrocentral do të shfrytëzojë pjesën fundore të lumit Vjosë, pranë grykëderdhjes, pa dëmtuar ekosistemin e tij në tërësi apo atraksionet që ai disponon.

Ky projekt propozim i është nënshtruar disa herë vlerësimeve teknike nga grupe të ndryshëm ekspertësh për shkak të natyrës së aplikimit si një propozim i pakërkuar.

Projekti i është nënshtruar procesit të identifikimit të projektit nga një grup i ngritur pranë AKBN-së dhe oponentëve teknike të detajuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (prot në MEI me nr.5033/2, dt.16.06.2015), e cila e ka cilësuar projektin si një alternativë tekniko-mjedisore të pranueshme.

Gjithashtu theksojmë se dhënia me konçesion e një hidrocentrali bazohet në paraqitjen e një projekti dhe jo plani apo programi dhe sipas Ligjit nr.10440, dt.07.07.2011 përcaktohet se projektet, i nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas specifikimeve të shtojcave përkatëse të këtij ligji dhe jo Vlerësimit Strategjik Mjedisor i cili ka fushën e veprimtimit për planet dhe programet, detajuar në legjislaionin.

Ofertuesi ka aplikuar pranë autoritetit përgjegjës të Ministrisë së Mjedisit (AKM) me një raport të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, bashkëlidhur të cilit ndodhet edhe një material i konsultimit me publikun dhe procesverbalet përkatëse dhe është pajisur me Deklaratën Mjedisore përkatëse (Nr. Prot 663, dt.24.04.2015).

Bashkëlidhur dokumentave të tenderit, ofertuesi ka paraqitur edhe oponentën teknike të hartuar nga studio tekniko-ligjore "Elba" sh.p.k., e cila shprehet se studimi mjedisor dhe social i paraqitur, i parë në tërësinë e vet, për fazën e studimit të projekt idesë i plotëson kërkesat për aprovim.

Gjithashtu ju informojmë se gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien me konçesion të HEC Poçem, janë zhvilluar disa takime me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe siç rezultoi edhe nga takimi sqarues i mbajtur më datë 19.04.2016 ku morën pjesë stafi teknik i kompanisë turke, studios mjedisore të licensuar që hartoi studimin, dhe një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, ku ky i fundit u prononcua se duke analizuar koordinatat e projektit ky projekt propozim i paraqitur nuk shtrihet në zonë të mbrojtur dhe nuk çënon monumente natyre, si dhe projekti është nën kuotën e përcaktuar për dhënien e licencave, referuar koordinatave ekzakte.



Gjithashtu ekspertet e subjektit ofertues "Cinar San" u prononcuan se kompania ka bere studime dhe analiza te detajuara simulimesh hidrike per te parashikuar ecurine e prurjeve dhe parandaluar problemet me permbytjet duke perfshire edhe aspektin mjedisor dhe social te kesaj cheshtjeje.

Duke pasur parasysh se projekti per vleresimin e potencialit hidroenergjetik te HEC "Poçem" eshte i nje rëndësie te madhe ekonomike per vendin, jane dhene rekomandimet e duhura per fazat e metejshme qe konsistojne ne marrjen e lejeve perkatese pranë autoriteteve kompetente bazuar ne legjislacionin ne fuqi per konçensionet.

Bazuar ne legjislacionin ne fuqi per mjedisin lidhur me vleresimin strategjik mjedisor theksojme se Strategjia e Energjise eshte ne proces hartimi dhe nuk jane percaktuar ende objektivat apo planet e veprimit te cilat duhet te pajisen me VSM.

1 Ligji nr 91, dt. 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor"

2 VKM 507, dt. 10.06.2015 "Per miratimin e listes se detajuar te planeve apo programeve me pasoja negative ne mjedis qe do ti nenshtrohen procesit te Vleresimit Strategjik Mjedisor".

3 VKM nr 219, date 11.03.2015 "Per percaktimin e rregullave dhe procedurave per konsultimin me grupet e interesit dhe publikun si dhe degjesen publike gjate procesit te Vleresimit Strategjik Mjedisor".

Ministria e Energjise dhe industrise ka ndjekur te gjitha procedurat ligjore per shpalljen e fituesit te procedures konkurruese duke i hapur rruge lejeve perkatese nga autoritetet kompetente, po bazuar ne legjislacionin ne fuqi. Ministria e Mjedisit eshte vendimmarrëse per cheshtjet mjedisore. Ne studimin mjedisor te paraqitur jane vleresuar ne menyre te pergjithshme, nga ekspertet, parametrat dhe standartet mjedisore te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi sipas nje vleresimi pikesh jo te plotë si dhe jane dhene rekomandimet perkatese.

Sa me sipër, pretendimi i palës paditëse se nuk ka Vlerësim Strategjik Mjedisor, nuk qëndron, pasi siç u shpjegua më sipër, për projektin në fjalë është paraqitur një Raport i thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, oponenca teknike e AKBN dhe vlerësimi i bërë nga vetë Ministria e Energjisë, si Autoriteti Kontraktues.

Së katërti, Ministria e Energjisë dhe industrisë duke e vlerësuar rëndësinë që ka procesi i konsultimit me publikun në rastet e ndërtimit të hidrocentraleve, gjithnjë ka respektuar legjislacionin në fuqi që rregullon procesin e informimit dhe konsultimit me publikun.

Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", në nenin 4 të tij, parashikon se:

"Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me: c) aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe".

Paditësi referon në parashikimet e bëra në Konventën e Aarhus-it. Konventa e Aarhus-it është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 dhe për rrjedhojë është e detyrueshme dhe drejtpërdrejt e zbatueshme. Objektivi kryesor i kësaj Konvente është të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij si dhe për të garantuar të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'u drejtuar gjykatës në lidhje me çështjet e mjedisit.

Nëse i referohemi rregullimeve të parashikuara në këtë Konventë, përkatësisht në nenin 4 të saj, përcaktohet:

"Çdo Palë do të sigurojë që, në përputhje me paragrafët e mëposhtëm të këtij neni, autoritetet publike, në përgjigje të kërkesës për informacion mjedisor, ta bëjnë informacionin të disponueshëm, brenda kuadrit të ligjit kombëtar, përfshirë kopje të dokumentit aktual që përmban këtë informacion në rastet kur kërkohet dhe sipas nënparagrafit b) më poshtë."

*Pra, dhënia e informacionit mjedisor të kërkuar nga subjektet e interesuara duhet të rregullohet në bazë të legjislacionit kombëtar.*

*Ministria e Energjisë dhe industrisë, jo vetëm që nuk ka refuzuar t'i japë informacion palëve paditëse, por nëpërmjet shkresës nr.411/1 prot., datë 01.09.2016 i ka kthyer përgjigje një kërkesë të tillë, duke i dhënë sqarimet përkatëse.*

*Ndërkohë, nëse i referohemi nenit 6 të Konventës së Aarhus-it, nen i cili rregullon pjesëmarrjen e publikut në vendimet për veprimtari të veçanta, shohim që Konventa e lë në diskrecion të Shteteve Palë mundësinë për t'i nënshtruar klauzolarve të këtij neni një veprimtari të propozuar.*

*Sa i përket procedurës konçesionare objekt gjykimi, konsultimi me publikun është realizuar nga vetë shoqëria që ka paraqitur propozimin e pakërkuar dhe që i përket fazës së hartimit dhe idimit të projektit, duke marrë parasysh sugjerimet e shprehura nga publiku i interesuar në këto degjesa publike.*

*Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendon pala paditëse, në zbatim të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, është bërë njoftimi i secilit pronar që preket nga shpronësimi për shkak të ndërtimit të HEC Poçem, duke e njoftuar gjithashtu për të drejtën që kanë për të kundërshtuar vlerën e dëmshpërbllimit që përfitojnë nga shpronësimi.*

*Së pesti, Kontrata Konçesionare parashikon se vlera e investimit dhe kostot e investimeve deri në realizimin përfundimtar të veprës, do të përballohen nga Konçesionari. Dhe nuk kemi të bëjmë me një projekt i cili ka nevojë për mbështetje financiare nga ana e Autoritetit Kontraktues, e për rrjedhojë nuk nevojitet miratimi paraprak i Ministrisë së Financave.*

*Sigurisht që procedura e shpronësimit do të realizohet nga Autoriteti Kontraktues, pasi vetëm Autoriteti e ka një tagër të tillë, por theksojmë se e gjithë vlera monetare që shkon për dëmshpërbllimet për shkak të shpronësimit do të përballohet nga Konçesionari.*

*Në përfundim të procedurës konçesionare, Ministria e Energjisë dhe industrisë, në respektim të të gjithë parashikimeve ligjore ka nënshkruar Kontratën Konçesionare me Nr.2174 Rep., Nr.755/4 Kol., datë 5 Shtator 2016.*

*Kontrata Konçesionare është publikuar edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike me Nr.43, datë 31 Tetor 2016, e cila për asnjë arsye dhe në asnjë rast nuk duhet të konstatohej "absolutisht e pavlefshme".*

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me Vendimet Dt.17.05.2017, pas shqyrtimit paraprakisht të elementëve formalë të ankimeve, ka vendosur në përfundim, pranimin e tyre.

**Personi i tretë "Kovlu Energji" sh.p.k.**, rezulton të ketë ushtruar gjithashtu të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke i kërkuar Gjykatës së Apelit Administrativ, ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padisë, për këto shkaqe:

*"1.Gjykata ka keqinterpretuar ligjin material që rregullon mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Pavlefshmëria e deklaratës mjedisore nuk sjell pavlefshmerinë automatikisht edhe të procedurës së konçensionit.*

*2.Procedura e konsultimit me publikun është kryer në përpuhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis.*

*3.Pretendimet e palës paditëse EcoAlbania mbi mungesën e informimit janë të pabazuara në fakte dhe prova. Bazuar në ligjin dhe aktet nënligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis organizatat jofitimprurëse konsiderohen të njoftuara nga publikimi elektronik në faqen zyrtare të AKM konsiderohet e realizuar për këto subjekte.*

1. Gjykata ka keqinterpretuar ligjin material që rregullon mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Pavlefshmëria e deklaratës mjedisore nuk sjell pavlefshmëri automatikisht edhe të procedurës së koncesionit.

Në vendimin e saj gjykata shprehet se: "Në respektim të këtij përcaktimi ligjor dhe aktet e tjera administrative siç janë urdhri i ministrit të energjisë dhe industrisë nr.228, datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhënien e koncesionit të hidrocentralit poçem, si dhe kontrata e koncesionit nr.2174 rep/nr.755/4 kol, datë 05.09.2016, e formës BOT (ndërtim-operim- transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Poçem" e lidhur midis Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "Kavlu Energi" sh.p.k, janë akte administrative dhe veprime juridike të pavlefshme, pasi janë nxjerrë mbi bazën e një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, siç është deklarata mjedisore me nr.Vendimi 17, datë 24.04.2015, i cili është një ndër dokumentet kryesorë standarte të tenderit të përcaktuar nga Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat, i ngritur me urdhrin nr.221, datë 24.11.2015 i ministrit të energjisë dhe industrisë, të ndryshuar që siç u theksua me sipër nuk mund të sjellë pasojë juridike, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë".

Ky konkluzion i gjykatës është marrë në keqinterpretim të ligjit material dhe procedural. Gjykata nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm përse i përket procedurës së koncesionit. Në asnjë rrjesht të vendimit nuk rezulton të jetë analizuar kjo procedurë dhe të jetë argumentuar pavlefshmëria e urdhrit të ministrit për ngritjen e komisionit të dhënies me koncesion të HEC Poçem.

Bazuar në nenin 117, paragrafi 3, i kodit të procedurave administrative nëqoftë se vetëm një pjesë e aktit është e absolutisht e pavlefshme i gjithë akti administrativ mund të konsiderohet tërësisht i pavlefshëm nëse pjesa që anulohet është oq e rëndësishme sa pa të akti nuk e realizon qëllimin e tij. Bazuar në këtë nen gjykata duhet të kishte analizuar veçanërisht procedurën e koncesionit dhe të argumentonte se si mangësitë e procedurës së deklaratës mjedisore ndikojnë në procedurën e koncesionit.

Gjykata nuk ka bërë asnjë analizë të procedurës së koncesionit por është kufizuar vetëm në analizimin e procedurës për nxjerrjen e deklaratës mjedisore.

Gjykata duhet të kishte analizuar procedurën e koncesionit në bazë të ligjit 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, e cila është baza ligjore e marrëdhënies juridike objekt gjykimi.

Për shkak të mungesës së kësaj analize gjykata ka arritur në një konkluzion të gabuar lidhur me vlefshmërinë e procedurës së koncesionit.

Bazuar në nenin 22 të ligjit 125/2013, i ndryshuar, procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënien e kontratës ose me vendimin për ndërprerjen e procedurës së dhënies së kontratës.

Neni 23 i ligjit parashikon kriteret mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi për dhënien në koncesion.

Kriter vlerësimi për dhënien e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme, të lidhura me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat në fjalë, që përfshijnë cilësinë, meritat teknike, karakteristikat estetike, funksionale e të mjedisit, kostot e drejtimit, kosto të efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit.

Në kohën e kryerjes së procedurës ka qenë në fuqi neni 7 i ligjit 125/2013 (Shfuqizuar me Ligjin Nr.77/2015, por që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së procedurës objekt gjykimi), VKM 576/2013 "Për miratimin e rregullave për identifikimin vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet", dhe aktet nënligjore të dalë në bazë të këtyre akteve.

Kërkesa për hartimin e raportit të ndikimit në mjedis është pjesë e shtojcës 9, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të ofertuesve. Detyrimin për depozitimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është pjesë e kriterëve të veçanta të kualifikimit. Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në shtojcën 10 të dokumenteve të tenderit dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis është njëri ndër 5 kriteret për vlerësimin e propozimeve të cilat janë vlera e tarifës koncensionare, Fuqia e instaluar e përcaktuar me prurjen llogaritëse, kohëzgjatja e punimeve, skema e lidhjes së centralit me sistemin elektroenergjitik.

Në mënyrë që gjykata të zgjidhte drejt çështjen duhet të analizonte të gjitha kriteret e vlerësimit dhe ndikimin e secilit prej tyre në projekt.

Përsa i përket kriterit të ndikimit në mjedis gjykata duhet të kishte bërë një analizë më tërësore të ligjit nr.10440, datën 7.7.2011 "Mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar dhe jo të bënte një interpretim të cunguar të tij duke ripohuar vetëm çfarë ka parashikuar pala paditëse në padi dhe gjatë gjyqimit.

Vetë ky ligj parashikon mundësinë e pavlefshmërisë së deklaratës mjedisore dhe në interpretim të nenit 20, paragrafi 5, të ligjit pavlefshmëria e deklaratës mjedisore nuk është absolute por relative pasi ky nen parashikon mundësinë e kurimit të kësaj pavlefshmërie nëpërmjet ribërjes nga e para të VNM-së.

Edhe në këtë aspekt gjykata nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm pasi nuk ka verifikuar nëse jemi në kushtet e parashikuara nga dispozita e sipërpërmendur. Nëse do të verifikoheshin rrethanat e parashikuara në këtë nen do ishim përpara pavlefshmërisë relative të aktit administrativ, pavlefshëmëri e cila për nga natyra e saj mund të kurohet nëpërmjet ribërjes së VNM-së.

Nga ana tjetër janë respektuar të gjitha procedurat e parashikuara në ligj për dhënien me koncesion të HEC "Poçem" dhe vlerësimi është bërë tërësisht në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin për koncesionet dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Projekti për dhënien me koncesion të HEC Poçem është një propozim i pakërkuar dhe si tillë është trajtuar në bazë të nenit 25 të ligjit dhe VKM-në nr.575, datë 10.07.2013 përsa i përket trajtimit të propozimeve të pakërkura.

Propozimi i pakërkuar është paraqitur si një studim fizibiliteti i zhvilluar plotësisht.

Bazuar në kreun I të VKM-së 576/2013 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për vlerësimin e kushteve, kriterëve, mënyrave dhe procedurave për dhënien me koncesion për hidrocentrale të projekt(e)-propozim të pakërkura në përputhje me dispozitat e ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të akteve nënligjore në zbatim të tij dhe të këtyre rregullave."

Në zbatim të kësaj VKM-je është miratuar Urdhri i Ministrit nr.41, datë 18.2.2015 "Për krijimin, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Grupit të Identifikimit të projekt propozimeve të pakërkura (GIPP) për dhënien me koncesion të hidrocentraleve", i ndryshuar.

Projekti-idea është shqyrtuar nga grupi i oponencës teknike të AKBN-së dhe bazuar në konkluzionin e këtij grupi në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur është shqyrtuar nga Grupit të Identifikimit të projekt propozimeve të pakërkura.

Shqyrtimi i propozimit të pakërkuar të paraqitur nga shoqëria "Çinar - San" është kryer nga Grupi i Oponencës teknike të AKBN-së dhe grupi për identifikimin e të projekt propozimeve të pakërkura (GIPP) për dhënien me koncesion të hidrocentraleve, të cilat janë grupe pune të përherëshme të krijuara posaçërisht për shqyrtimin e propozimeve të pakërkura për ndërtimin e hidrocentraleve.

Grupi i Oponencës Teknike ka shqyrtuar projekt-propozimin e Shoqërisë Investitore "Çinarsan Haf. Nuk. Ins. Tur. San" sh.p.k. për HEC-in "Poçem" dhe ndryshe nga sa pretendon pala paditëse në padi në vlerësimin e projektit ka marrë në konsideratë oponencën teknike mbi studimin e fizibilitetit për shfrytëzimin hidroenergjitik të pellgut ujëmbledhës të Lumit Vjosa të njoftuar me shkresën e AKBN me Nr.8586/1 Prot. datë 21.12.2012, dhe në fund të shqyrtimit ka konkluduar si vijon:

*Vlerësimi përfundimtar teknik dhe mjedisor:*

Grupi i Oponencës Teknike vlerëson që projekt-propozimi për HEC-in "Poçem" hartuar nga studio e projektimit "Abkons" dhe "Gr Albania", për shoqërinë Investitore "Çinarsun Haf. Nak. Ins. Tur. San" sh.p.k. është një alternativë tekniko-mjedisore e pranueshme. Ky studim fizibiliteti i HEC "Poçem" përfaqëson një aks (HEC tipi me dige + rezervuar) i kaskadës së lumit Vjosë (rrjedha e poshtme).

Në fazat e mëtejshme të respektohen rekomandimet për studimet inxhinierike mbështetëse të dhëna nga Grupi i Oponencës Teknike".

Në këtë aspekt edhe pretendimet se pala e paditur MEI nuk ka kryer një vlerësim të dobishmërisë dhe efikasitetit të koncensionit janë të pabazuara, pasi bazuar në opionencën e sipërpërmendura janë analizuar dhe argumentuar të gjitha aspektet e rentabilitetit dhe nërçtashmërisë financiare.

Konkretisht paragrafi 5, i raportit të grupit për identifikimin e projekt propozimeve të pakërkua ka argumentuar: "5. Referuar analizës ekonomike dhe plan biznesit për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit "Poçem" parashikohet financimi i projektit në masën 25% nga kapitali i shoqërisë ndërsa pjesa tjetër nga hua bankare me interes 4% për një periudhë kohore prej 12 vitesh dhe "grace period" prej 3 viteve. Te ordhurat vijnë nga shitja e energjisë së prodhuar me çmim të bazuar në përpulje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas bursës HUPX. Pas analizës financiare rezultoi se investimi për ndërtimin e hidrocentralit është rentabël pasi kriteret e vlerësimit të investimit siç është Vlera Aktuale Neto (NPV) rezultoi pozitive, në mbi 200 milion Euro, Periudha e vetëshlyerjes në 7 vite dhe Norma e Brendshme e Këhimit (IRR) është më e madhe se norma e skontimit e marrë në konsideratë". Pretendimi i paditësve për hartimin e studimit të fizibilitetit të vetin nga ana e palës së paditur MEI mbetet i pabazuar dhe kontradiktor me vetë pretendimet e saj mbi zbatueshmërinë e VKM-së 576/2013.

Siç argumentuam më sipër ligji i zbatueshëm në kohën e vlerësimit të projektit objekt i akteve administrative që kundërshtohen ka qenë neni 7, i cili parashikon se mënyra e identifikimit, vlerësimit dhe realizimit të projekteve për propozimet e pakërkua për ndërtimin e hidrocentraleve rregullohet me akt nënligjor të veçantë, konkretisht VKM 576/2013, e cila nuk parashikon detyrimin për hartimin e studimit të veçantë të fizibilitetit, por vetëm analizën financiare dhe të rentabilitetit, e cila është kryer si më sipër.

Siç rezultoi nga sa më sipër në përfundim të analizës, pas marrjes në shqyrtim edhe të projektit Sogreah, grupi i opionencës së AKBN-së ka arritur në konkluzionin se, projekti është një alternativë tekniko mjedisore e pranueshme. Aktualisht projekti nuk ka filluar ende fazën e zbatimit dhe rekomandimet e parashikuara i përkasin fazës së hartimit të projekt-zbatimit, i cili po hartohet aktualisht dhe po marrin në konsideratë të gjitha rekomandimet e parashikuara në raport.

Më tej me urdhrin nr.Urdhërit të Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë nr.228, datë 24.11.2015, është krijuar komisioni për dhënien e koncensionit të hidrocentralit Poçem. Ky akt administrativ është nxjerrë nga një organ plotësisht i identifikueshëm dhe brenda kufijve të kompetencave ligjore të këtij organi. Gjithashtu vlen të theksojmë se, aktet administrative janë nxjerrë në formën e parashikuara në ligj, nga një organ kompetent, në përpulje të plotë me parashikimet ligjore, si dhe janë njoftuar në mënyrën e parashikuara në ligj, elemente këto që i hejnë këtë akt mëse të vlefshëm.

Komisioni në përpulje me kompetencat e tij ka shqyrtuar, diskutuar, hartuar dhe më pas Komisioni ka miratuar Dokumentet Standarde të Koncesionit (DSK) për hidrocentralin "Poçem", në përpulje me legjislacionin për koncesionet dhe Dokumentet Standarde të Koncesionit-Tip, të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP).

Pas hapjes së ofertave u konstatua se për këtë procedurë koncesionare ka dorëzuar ofertën vetëm 1 (një) operator ekonomik, konkretisht Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive të së drejtës turke, "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi", krijuar nëpërmjet kontratës nr.18090, datë 18.12.2015.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe kualifikues, u vlerësua se ky bashkim i përkohshëm i Shoqërive të kualifikohet më tej.

Më tej u vijua me vlerësimin e dokumentacionit ekonomik-financiar dhe teknik, ku u konstatua se ishin në përputhje me kriteret kualifikuese, për të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar janë mbajtur proces-verbalet përkatëse. Gjithashtu është konstatuar se ofertuesi ka paraqitur studimet e kërkuara mjedisore, hidrologjike, gjeologjike etj, si dhe zgjidhjen teknike të funksionimit të HEC-ve. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e HEC Poçem i paraqitur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive ofertuese parashikon ndërtimin e hidrocentralit të tipit me digë rezervuar.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, njofton përfaqësuesin e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive "Çinar-San Hafriyet Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi" se oferta e tyre është prurim.

Njëkohësisht me shkresën nr.2632/33 prot., datë 29.04.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dërgon Formularin e Njoftimit të Fituesit.

Operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive të së drejtës turke, "Çinar-San Hafriyet Nakliyat InsaatTurizm San Ve Tic LTD. Sti" dhe "Ayen Enerji Anonim Sirketi" ka krijuar Subjektin për Qëllime të Veçanta, shoqërinë "KOVLU ENERJJI" sh.p.k. me të cilën është nënshkruar Kontrata Konçesionare me Nr. 2174 Rep., Nr. 755/4 KoL, datë 5 Shtator 2016. Kontrata Konçesionare është publikuar edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike me Nr. 43, datë 31 Tetor 2016.

Referuar nga sa u shpjegua më sipër, rezulton se procedura konçesionare, e cila ka konkluduar me nënshkrimin e Kontratës Konçesionare, është zhvilluar në përputhje të plotë me parashikimet e legjislacionit në fuqi për Konçesionet, duke respektuar çdo parashikim ligjor.

2.Procedura e konsultimit me publikun është kryer në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Vendimi i gjykatës lidhur me procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis është i pabazuar në ligj. Procesi i konsultimit të publikut është kompleks dhe nuk përbehet vetëm nga një fazë apo mënyrë publikimi informacioni.

Gjykata është kufizuar vetëm duke cituar VKM-në nr.247, datë 20.04.2017, pa argumentuar dhe analizuar plotësisht ligjin dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Procedura për deklaratën mjedisore është në përputhje të plotë me ligjin nr.10440, date 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Prezantimet e palës paditëse mbi mangësitë e procesit të konsultimit publik janë në keqinterpretim të ligjit material dhe nuk janë të bazuara në prova.

Paditësi nuk argumenton në asnjë moment se cilat janë procedurat që janë shkelur nga palët e paditura dhe personi i tretë gjatë procedurave për lëshimin e deklaratës mjedisore.

Sic rezultoi edhe nga rrethanat e faktit të sipërpërmendura nga ana e zhvilluesit janë kryer në përputhje me ligjin të gjitha procedurat e kërkuara nga VKM 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshijen e publikut në vendimarrje".

Zhvilluesi ka përmbushur të gjitha procedurat e parashikuara në këto akte.

Procedura e konsultimit me publikun përfshin procedurën para hartimit të VNM-së, gjatë hartimit të VNM-së, seancën dëgjimore, dhe deri në publikimin e deklaratës mjedisore, fakte këto të provuara me prova shkresore nga personi i tretë.

Publikimi i njoftimit nr.317, datë 18.02.2015, në website e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, është tërësisht në përputhje me pikën 2, të kreut II të kësaj VKM-je lidhur me detyrimin për informimin e publikut për çështjet që do të trajtohen në VNM.

Njoftimi i depozituar në cilësinë e provës është në përputhje me praktikën e ndjekur nga AKM dhe institucionet kompetente.

Aplikimi në AKM bëhet nëpërmjet depozitimit të formularëve të plotësuar të cilat më pas publikohen në faqen elektronike të AKM në përputhje me VKM-në e sipërcituar. Njëkohësisht me kërkesën për formularin është depozituar edhe draft VNM e cila përmban të detajuar çështjet që do të trajtohen në VNM e thelluar.

Neni 2.1. i pikës 2. të VKM-së së sipërcituar parashikon "Për të bërë të mundur informimin dhe marrjen e mendimit nga publiku dhe OJF-të, AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga zhvilluesi, publikon në faqen e saj të internetit, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e plotë të paraqitur nga zhvilluesi. Në publikim AKM-ja sqaron...".

Më tej në përputhje me nenin 12 të ligjit 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar vendimi i komisioni të shqyrtimit të aplikimeve për vlerësimin e ndikimit në mjedis për miratimin e VNM-së së thelluar dhe deklaratata mjedisore përkatëse janë publikuar në faqen elektronike të AKM-së në publikimin nr.17 datë 22.04.2015 (depozituar në cilësinë e provës).

Në përputhje me këtë parashikim njoftimi ka qëndruar i publikuar 20 ditë derisa është zhvilluar seanca dëgjimore më datë 28.02.2015.

Pretendimet e palës paditëse mbi njoftimin e OJF mbi mjedisin janë konkluzione të marra në keqinterpretim të ligjit dhe akteve nënligjore të sipërpërmendura.

Zhvillimi i seancës dëgjimore, informimi i publikut të intersuar dhe të ndikuar është tregues i faktit se njoftimet e kryera nga zhvilluesi kanë ezauruar qëllimin e konsultimit publik që kërkon ligji.

Gjithashtu bazuar në VKM-në nr.13, datë 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësitve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis", për të bërë të mundur informimin dhe marrjen e mendimit nga publiku dhe OJF-të, AKM - ja publikon në faqen e saj elektronike për 20 ditë rresht, informacionin e paraqitur nga subjekti.

Sic rezulton nga sa më sipër ky detyrim është përmbushur nga AKM me publikimin e njoftimit dhe draft planit të ndikimit në mjedis i cili përmban të gjitha pikat që janë trajtuar më vonë në VNM-në e thelluar.

Bazuar në pikën 5 të kësaj VKM-je institucionet e përmendura në pikën "1" dhe "2", publiku dhe OJF-të japin mendimin e tyre brenda afatit të kërkuar më sipër dhe nëse ato nuk e paraqesin brenda afatit, nënkuptohet se nuk kanë kërkesa apo sugjerime për çështjet që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së.

Parashikimet ligjore dhe nënligjore, publikimet e sipërpërmendura dhe fakti që të gjithë këto akte janë lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë është provë që nga zhvilluesi dhe palët e paditura kanë përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në ligj dhe VKM Nr.13, datë 04.01.2013, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësitve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis".

Pretendimet e ngritura gjatë gjykimit mbi pamundësinë e aksesit të publikut në këto mënyra komunikimi janë të pabazuara në ligj.

Gjithashtu referencat e paditësve në progres raportin për Shqipërinë për vitin 2016, dhe rezolutën e Parlamentit Evropian janë sërish të paargumentuara.

Në çfarë forme konkretisht janë shkelur këto akte? Cila pjesë e procedurës së vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis ka shkelur parashikimet këtyre akteve?

Palë paditëse në padi dhe gjatë gjykimit ka ngritur pretendimin mbi pavlefshmërinë absolute të deklaratës mjedisore, pa argumentuar dhe provuar se cilat janë shkeljet flagrante të ligjit që sjellin si pasojë pavlefshmërinë absolute të këtij akti administrativ.

Padia përmban kërkime dhe argumentime të trajtuara qartë e të lidhura vetëm me pavlefshmërinë relative të aktit administrativ.

Palë paditëse thjesht propozon se aktet administrative objekt gjykimi janë të pavlefshme, por pa argumentuar cilat janë shkeljet që i bëjnë ato absolutisht të pavlefshme.

Argumentet e ngritura nga pala paditëse lidhen më shumë me pavlefshmërinë relative sesa atë absolute.

Lidhur me pretendimet mbi pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, gjykata e lartë ka një qëndrim të konsoliduar në raste të tilla, përse i përket detyrimit për të specifikuar shkaqet përse aktet administrative janë absolutisht të pavlefshme.

Pala paditëse ka pretenduar pa dhënë shkaqet anulimin e këtyre dy akteve administrative për pavlefshmëri absolute. Pra pala paditëse nuk ka parashtruar shprehimisht dhe qartazi se kërkon pavlefshmërinë absolute të akteve administrative.

feruar këtij qëndrimi, në rastet kur kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ, gjykata nuk shqyrton thelbin e tij, por mjaftohet vetëm me verifikimin e kërkesave të nenit 116 të K.Pr. Administrative, i cili thotë se: "Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme në kuptim të këtij Kodi në rastet e mëposhtme:

a) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar.

b) Kur akti administrativ është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore.

c) Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën ose procedurën e kërkuar nga ligji".

Personi i tretë çmon se, në çështjen objekt gjykimi, padia përmban kërkime dhe argumentime të trajtuara qartë e të lidhura vetëm me pavlefshmërinë relative të aktit administrativ. Në këto rast, kërkimi për pavlefshmëri është i kushtëzuar me ezaurimin e ankimit administrativ dhe respektimit të afateve ligjore për ngritjen e padisë.

- Duke njohur rëndësinë që ka procedura për konsultim të publikut ka parashikuar në nenin 17 të ligjit rregullimin e saj me akt të veçantë nënligjor.

Konkretisht VKM-në nr. 247, datë 30.04.2014. Për këtë procedurë është parashikuar ankim i veçantë administrativ. Ky parashikim përbën njëkohësisht edhe një detyrim për ezaurimin e rekursit administrativ tek Ministri përpara ngritjes së këtyre pretendimeve në gjykatë.

Bazuar në pikën 2.1. të VKM-së 247, datë 30.04.2014, "Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin paraprak dhe të thelluar të VNM-së, në zbatim të legjislatcionit në fuqi. Ankimi i drejtohet ministrit."

Nga dosja dhe as nga pretendimet e palës paditëse në padi nuk rezulton që prej tyre të jetë ezauruar ankimi administrativ sic e parashikon akti nënligjor.

Rrjedhimisht pretendimet e ngritura lidhur me konsultimin publik janë jashtë juridiksionit të kësaj gjykate pasi paditësi nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimit.

Bazuar në nenin 18 të ligjit 49/2012, i ndryshuar, "padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afatfillon nga: c) data e botimit të aktit administrativ, në rastet kur ligji parashikon detyrimin për botimin e aktit;"

Në përputhje me këtë detyrim AKM ka botuar deklaratën mjedisore më datë 22.04.2015, duke filluar nga ky moment e drejta e të gjithë subjekteve të interesuara për të kundërshtuar në gjykatë këtë akt. Ligji i posaçëm nuk parashikon afate të ndryshme ankimi rrjedhimisht në këtë rast zbatohet afati 45 ditor i parashikuar nga ligji 49/2012.

3. Pretendimet e palës paditëse EcoAlbania mbi mungesën e informimit janë të pabazuara në fakte dhe prova. Bazuar në ligjin dhe aktet nënligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis organizatat jofitimprurëse konsiderohen të njoftuara nga publikimi elektronik në faqen zyrtare të AKM konsiderohet e realizuar për këto subjekte.

Madje duke marrë në konsideratë edhe parashikimet e pikës 5 të kësaj VKM-je konstatohet lehtësisht se institucionet e përmendura në pikën "1" dhe "2", publiku dhe OJF-te nëse nuk e paraqesin brenda afatit, nënkuptohet se nuk kanë kërkesa apo sugjerime për çështjet që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së.

Këto pretendime janë edhe më shumë të pabazuara përse i përket OJF të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre çështjet që lidhen me ndikimin në mjedis. Përveç faktit që këto



struktura janë të organizuara posaçërisht për njëkëjen e çështjeve që lidhen me ndikimin në mjedis, ato kanë të gjitha kapacitetet dhe logjistikën e nevojshme për aksesin në këto mënyra komunikimi. Pretendimet e palës paditëse janë kontradiktore me argumentet e saj për legjitimitimin e këtyre subjekteve në këtë gjykim. Nga njëra anë pretendon legjitimitimin e tyre pasi kanë si objekt të veprimtarisë së tyre çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe nga ana tjetër pretendon se mjetet e informimit të aplikuara nuk janë efektive për njoftimin e këtyre subjekteve të cilat objekt të vetëm të veprimtarisë së tyre kanë të çështjet mjedisore.

Gjatë gjyqimit në shkallë të parë u provua se janë depozituar nga zhvilluesi, person i tretë në këtë gjykim, draft VNM me të gjitha çështjet që do të trajtohen në vlerësimin e thelluar të ndikimit në mjedis dhe pavarësisht këtij publikimi OJF paditëse nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim apo vërejtje lidhur me projektin.

4.38 banorët nuk legjitimohen në ngritjen e kësaj padie. Qenia banorë e zonës nuk provohet me prokurën e lëshuar nga paditësit për avokatin por vetëm nga vërtetimet e lëshuara nga organet kompetente vendore.

Konstatimi i gjykatës se legjitimitimi i palës paditëse provohet nga prokurat e depozituar në dosjen gjyqësore është tërësisht i pabazuar dhe kontradiktor.

Bazuar në provat e administruara në dosjen gjyqësore nuk rezultojnë prova përse i përket palës paditëse të përbërë nga 38 banorë të fshatit Kutë, Mëllakastër, nuk vërtetohet cilësia e tyre përkatësisht si banorë të zonës ku do ndërtohet HEC Poçem. Mungesa e legjitimitimit të palëve paditëse 38 banorë të fshatit Kutë u provua edhe gjatë gjyqimit kur nga pala paditëse u pranua që nuk janë depozituar në dosje vërtetimet e banimit të këtyre banorëve nga organet vendore. Plotësimi i banimit në prokurën prej noterit është tërësisht deklarativ. Vërtetimi i banimit provohet nga komunikimi me organet kompetente vendore.

Argumentimi i gjykatës në këtë drejtim është i njëanshëm dhe kontradiktor për shkak se nga njëra anë ka rrëzuar prapësimet e personit të tretë lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore duke pranuar si të provuar faktin që personat që kanë marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore nuk janë banorë të fshatit Kutë mbi bazën e komunikimit shkresor me organet vendore përkatëse, ndërkohë që nga ana tjetër legjitimon palën paditëse duke injoruar faktin që qenia banorë nuk provohet me asnjë komunikim shkresor nga organet përkatëse vendore.

Bazuar në nenin 6, pika publiku i ndikuar është publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore që shprehin interes. Ndërsa kuptimin i fjalës "publik" jepet në ligjin nr.10/431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Përkufizimi i publikut në ligjin për mbrojtjen e mjedisit është i parashikuar në pikën 12 të nenit 5 të këtij ligji i cili parashikon se "Publik" është një ose më shumë persona, fizikë apo juridikë, në përputhje me legjisllacionin e praktikën kombëtare, shoqatave, organizatat dhe grupimet e tyre.

Në rastin konkret paditësit 38 banorë të fshatit Kutë për arsyet që argumentuam më sipër nuk provojnë qenien e tyre si publik i prekur në kuptim të këtij neni. Ndërsa OJF-të sic argumentuam më lart janë informuar në bazë të ligjit nëpërmjet publikimit të draft raportit në faqen elektronike zyrtare të AKM-së dhe nuk kanë paraqitur asnjë vërejtje lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Pretendimet mbi paprekshmërinë e lumit Vjosë dhe dëmtimin që mund të shkaktojnë atij ndërtimi i digave janë të pabazuara.

Aktualisht në pjesën greke të lumit megjithëse është shpallur zonë e mbrojtur nga shteti grek funksionon liqeni hidrocentral i burimeve të Vjosës.

Lumi i Vjosës buron nga malet e Pindit brenda territorit Grek, në afërsi të fshatit Bobusa. Më pas rrjedh përgjatë "Parkut Kombëtar Bikou-Aoos", vazhdon në fushën e Konicës dhe më pas drejt territorit të Shqipërisë deri në grykëderdhjen në Adriatik.

Lumi i Vjosës është i gjatë 290 km, prej të cilave 80 km ndodhen brenda territorit Grek dhe 190 km brenda në Shqipëri.

Lumi i Vjosës rrjedh nga burime në lartësi 1.350 m mbi nivelin e detit.

Aktualisht potenciali ujor i këtyre burimeve mbledhen në një liqen artificial i cili u ndërtua si pjesë e projektit të hidrocentralit të "Burimeve të Vjosës".

Liqeni i hidrocentralit të "Burimeve të Vjosës" ndodhet në zonën e mbrojtur të Gregisë, "VIKO-AOS".

Për ndërtimin e këtij liqeni artificial u nevojiten të ndërtohashin 7 diga dhe më e madhja ka lartësi 78 m.

Sipërfaqja e këtij liqeni është 11.5 km<sup>2</sup>. Zona rreth liqenit artificial është unike dhe karakterizohet nga vlera të larta të biodiversitetit. Hidrocentrali i "Burimeve të Vjosës" është pajisur me leje mjedisore në vitin 1990 dhe e ka rishikuar këtë leje në vitin 2014.

Gjithashtu në opionencën e AKBN-së për propozimin e pakërkuar është theksuar se, ndikimet mjedisore të cilat nuk mund të kompensohen në mënyrë të drejteperdrejte, mund të kompensohen nga montazhet që hidrocentralat do të gjallin në aspektin social, mjedisor dhe turistik. Pra është vlerësuar aspekti social dhe turistik që do të sjellë ndërtimit i hidrocentralit.

Pretendimet mbi shkeljen e ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor", janë të pabazuara dhe në keqinterpretim të këtij ligji.

Ligji 91/2013, parashikon detyrimin për t'ju nënshtruar procesit të vlerësimit strategjik mjedisor të gjitha planeve dhe programeve për bujqësinë, pyjet, peshkimin, energjinë, industrinë etj, të cilat vendosin kuadrin për miratimin në të ardhmen të projekteve të listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit 10440/2011, i ndryshuar. Bazuar në nenin 4/g, të ligjit 91/2013, g) "Planet dhe programet" janë planet dhe programet, hartimi i të cilave kërkohet nga dispozita ligjore, rregullatore dhe administrative, që përgatiten nga autoritetet planifikuese: shtetërore në nivel kombëtar, ndërvendor ose vendor dhe që përpara fillimit të zbatimit të tyre duhet të miratohen përmes një procedure ligjore të përcaktuar.

Pra sic rezulton nga parashikimet e këtij ligji detyrimi për vlerësimin strategjik mjedisor i referohet planeve dhe programe të hartuar nga autoritetet qendrore dhe vendore të planifikuese shtetërore të cilat shërbejnë si bazë për projektet e parashikuara nga ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe jo vetë projekti. Më tej referencat në dispozitat e tjera të këtij ligji janë sërish në keqinterpretim të tij. Neni 7, i këtij ligji kur rendit fazat e procesit të vlerësimit strategjik mjedisor, nga pika e parë deri në të fundit parashikon detyrimin e autoritetit propozues të planit apo programit, i cili në dritën edhe të përkufizimit të sipërpërmendur, del qartë se, ky detyrim është për autoritetet shtetërore dhe jo subjektet që propozojnë projektet.

Gjithashtu pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit 8561/1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", janë të pabazuara. Bazuar në nenin 10 të këtij ligji paraqitja e kërkesës për shpronësim në ministrinë kompetente duhet të shoqërohet nga dokumentacioni që lidhet me projektet dhe lejet e miratuara. Konkretisht pikat b), d), dhe dh) të këtij neni parashikojnë se kërkesa e subjektit privat duhet të shoqërohet nga projektet e nevojshme dhe të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik, lidhur me realizimin e këtyre projekteve. Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet, Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatat përkatëse. Parashikimet ligjore të sipërpërmendura rrëzojnë pretendimet e paditësve mbi zbatimin e ligjit 8561/1999, i ndryshuar në fazën e miratimit të deklaratës mjedisore apo të procedurës së konçensionit, kur ende nuk ka një projekt të miratuar dhe nuk janë lëshuar lejet përkatëse për zhvillimin e tij.

Në këtë fazë është kryer një studim i cili trajton ndikimin social të projektit i cili është përfshirë edhe në opionencën e AKBN-së për projektin.

Pretendimi për marrjen e miratimit nga Ministria e Financave është i pabazuar për arsye se, projekti për ndërtimin e hidrocentralit "Paçem" nuk kërkon mbështetje financiare në kuptim të nenit 42 dhe 3, të ligjit nr. 125/2013.

*Në bazë të nenit 42 miratimi i ministrisë së financave për projektet koncesionare është i nevojshme për projektet që kanë nevojë për mbështetje financiare.*

*Sic rezultojn nga analiza financiare në raportin e GIPP për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit "Poçem" parashikohet financimi i projektit në masën 25% nga kapitali i shoqërisë ndërsa pjesa tjetër nga hua bankare.*

*Projekti nuk parashikon asnjë formë të mbështetjes financiare nga sektori publik.*

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me Vendimin Dt.15.06.2017, pas shqyrtimit paraprakisht të elementëve formalë të ankimit, ka vendosur në përfundim, pranimin e tij.

**Pala nditëse**, rezultojn të ketë ushtruar të drejtën e kundërankimit, duke i kërkuar Gjykatës së Apelit Administrativ, mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për këto shkaqe:

*"1. Ankimuesi Ministria e Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Avokatura e Shtetit pretendon me ankimin se nga ana e personit të tretë nëpërmjet konsulentit GR Albania janë realizuar konform rregullave ligjore e nënligjore procedurat e konsultimit me publikun (pika I, II fq. 3 - 6 e ankimit).*

*Ky pretendim është thjesht ripërsëritje e prapësimeve të bëra nga ankimuesi gjatë gjykimit në shkallë të parë. Nuk sjell asnjë rrethanë të re apo sqarim të rrethanave të faktit të parashtruar në shkallë të parë. Gjithashtu i referohet të njejtave provave shkresore të sjella prej ankimuesit me prapësimet e veta në shkallë të parë dhe nuk referon në ndonjë prove të re.*

*Ankimuesi thjesht pretendon me fjalë në mënyrë deklarative se është respektuar procedura e parashikuar nga (i) Ligji nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"; (ii) VKM nr.13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"; dhe VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", por nuk sjell asnjë argument për të mbështetur këtë pretendim.*

*Në fakt kjo procedurë nuk është respektuar.*

*Sic u provua edhe gjatë gjykimit, dhe sic ka konstatuar edhe Gjykata në vendimin objekt ankimi, rezultojn se në fazën e konsultimit me publikun qoftë nga zhvilluesi, qoftë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë konstatuar kundraligjshmëritë e mëposhtme:*

*Legjislacioni mjedisor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh të posaçme mjedisore për projekte specifike të tilla si ndërtimi i hidrocentralit objekt i këtij gjykimi. Të gjitha detyrimet e legjislacionit mjedisor kanë impakt thelbësor mbi vendimmarrjen për veprimtaritë me ndikim në mjedis brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.*

*Realizimi i projektit të ndërtimit të hidrocentralit Poçem, qoftë edhe mbi bazën e procedurës së parashikuar nga legjislacioni për koncesionet si "propozim i pakërkuar" është objekt i legjislacionit bazë që rregullon procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve zhvillimore në territorin e Republikës së Shqipërisë: (i) Ligji nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"; (ii) VKM nr.13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"; dhe VKM nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".*

*Në fakt, Neni 9 (a) i Ligjit 10440/2011, parashikon se projektet e përfshira në Shtojcën I të ligjit duhet t'i nënshtrohen si fillim vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis.*

*Neni 15 i Shtojcës I të Ligjit 10440/2011 liston projektet e ndërtuara si "Diga dhe instalime të tjera, që janë projektuar për të penguar daljen e ujit ose për të depozituar ujin në*

mënyrë të përhapshme, ku një masë e re ose shtesë uji e penguar ose e depozituar është mbi 10 milionë m<sup>3</sup>, dhe në rastin e këtij projekti është parashikuar që vëllimi i rezervuarit të digës të jetë 295 milionë m<sup>3</sup>.

*Kundraligjshmëritë:*

\* Neni 12 (1) i Ligjit 10440/2011, parashikon se: "Në përfundim të procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri lëshon deklaratën mjedisore, e cila mund t'i sugjerojë autoritetit planifikues: ...b) miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis" dhe më tej në (2) po ky nen përcakton: "Në rastin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni deklarata përmban: a) qëndrimin e ministrit dhe, sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi; b) konfirmimin se ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkollën e reflektimit të tyre; c) informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun; ç) arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi; d) përshtirimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme".

Në rastin konkret, kushtet e parashikuara në (b) dhe (c) të pikës (2) të nenit 12 të Ligjit 10440/2011 të sipërcituar nuk janë përmbushur qoftë nga pikëpamja formale, qoftë nga ajo materiale, pasi nga konsultimi i Deklaratës Mjedisore, paraqitur nga paditësit si provë shkresore në Aneks 6 të provave bashkëlidhur padisë, rezultoi se vetëm në pikën 2 të Deklaratës është pasqyruar sa vijon:

"2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

*Konsultimi me publikun:* Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve lu siguria të pranishmëve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cenuar jetën e banorëve.

Kjo pikë e Deklaratës Mjedisore nuk ezauroi kërkesat e sipërcituara të parashikuara në (b) dhe (c) të pikës 2 të nenit 12 të Ligjit 10440/2011, pasi nuk gjejmë në këtë paragraf të Deklaratës as konfirmimin se ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, as shkollën e reflektimit të tyre, dhe as informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun.

\* AKM, ka shkelur legjislacionin në fuqi në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis, por ka penguar edhe ushtrimin e të drejtave të publikut të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, sipas VKM-së nr. 13, datë 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis".

Të gjitha procedurat e detajuara nga kjo VKM nuk janë respektuar as nga zhvilluesi dhe as nga AKM.

Jo vetëm kaq, por papërgjegjshmëria dhe mosserioziteti i AKM shkojnë përtej, kur në përgjigje të kërkesës për informacion nga paditësi EcoAlbania, AKM me shkresën nr.1547/1 datë 29.06.2016 (Aneks nr.5 i provave shkresore të paraqitura nga paditësat), këthen përgjigje dhe thotë se pranë AKM nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për procedurë VNM për HEC Pocem, nga AKM nuk është lëshuar ndonjë deklaratë/leje për HEC Pocem dhe as nuk disponojnë ndonjë Raport VNM për këtë vepër!

VKM nr.13, datë 04.01.2013, në Kreun II "Zhvillimi i procedurës së thelluar të VNM-së" pjesa A "Faza e zhvillimit të procedurës së thelluar të VNM-së" përcakton se:

"Procedura e thelluar e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 9 të ligjit nr.10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", dhe ndjek këto faza të njëpasnjëshme:

a) njoftimin e AKM-së nga zhvilluesi për synimin e zhvillimit të projektit;

b) konsultimin e AKM-së me institucionet e tjera, publikun dhe OJF-të për çështjet që ato kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

c) komunikimin që AKM-ja i bën zhvilluesit për çështjet që ajo dhe palët e konsultuara kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

ç) hartimin e raportit të thelluar të VNM-së dhe degjесën me publikun;

d) aplikimin në QKL për deklaratën mjedisore, shqyrtimin nga AKM-ja dhe lëshimin e saj nga ministri”.

Gjatë gjyqimit, nga provat e paraqitura nga paditësi dhe moskundershtimi i tyre me pretendime apo prova të tjera nga të paditurit AKM dhe Ministria e Mjedisit, u provua se janë realizuar formalisht vetëm fazat e përcaktuara në pikat “ç” dhe “d” të mësipërme. Fazat e përcaktuara në pikat “a”, “b” dhe “c” nuk janë realizuar.

Më konkretisht nga çfarë u provua nga provat e shqyrtuara në gjykim, rezulton se detyrimet e papërbushura sipas VKM-së nr. 13, datë 04.01.2013 janë si vijon:

Detyrimi i parashikuar në VKM 13/2013	Detyrim për:	Plotësuar (PO/JO)
Kreu II, pjesa B (1): “Zhvilluesi, që synon të zbatojë një projekt, që është subjekt i procedurës së thelluar të VNM-së, njofton AKM-në që në fazat fillestare të zhvillimit të projektit (projektidësë), duke e shoqëruar me informacionin e poshtëshënuar. 1.1; 1.2; 1.3”	Zhvilluesin	JO
Kreu II, pjesa C (1): “AKM-ja, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së (aplikimit) dokumentacionit prej QKL-së, u dërgon për mendim/konsultim një kopje të plotë të tij institucioneve të mëposhtme, duke u theksuar edhe afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh për dërgimin e mendimit të tyre: a) Ministrive të linjës, të cilat kanë përgjegjësi në planifikimin e territorit, mbrojtjen e shëndetit publik, tokës bujqësore, zhvillimit të ekonomisë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës publike; b) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga institucionet e qeverisjes në qark; c) Institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejitim/licencimin e tij apo përgjegjëse për emergjencat natyrore dhe civile.	AKM	JO
Kreu II, pjesa C (2): “ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit nga AKM-ja, u dërgon një kopje të tij institucioneve përfaqësuese të qeverisjes qendrore në qark me përgjegjësi sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të kësaj ndarjeje, si dhe njësisë së qeverisjes vendore që administrojnë territorin ku propozohet projekti, duke u përcaktuar edhe afatin prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh për dhënien e mendimit nga secili institucion.	AKM/ARM	JO
Kreu II, pjesa C (3): “ARM-ja dërgon në AKM mendimet dhe informacionin përkatës brenda 3 (tri) ditëve nga afati i mbarimit të dhënies së mendimit nga institucionet e konsultuara prej saj.”	AKM/ARM	JO
Kreu II, pjesa C (4): “Për të bërë të mundur informimin dhe marrjen e mendimit nga publiku dhe OJF-të, AKM-ja	AKM	JO

<p>publikon në faqen e saj elektronike, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e paraqitur nga subjekti, duke sqaruar se brenda këtij afati mund të jepen mendime për çështjet që duan të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, si dhe sqarimet për procedurën që do të zbatohet për informimin e konsultimin dhe dëgjuesën publike."</p>		
<p>Kreu II, pjesa Ç (1): "Brenda 5 (pesë) ditëve nga data e përfundimit të afatit për marrjen e mendimit, sipas përcaktimit të ndarjes "C" të këtij kreu, AKM-ja i komunikon me shkrim zhvilluesit, si më poshtë vijon:</p> <p>a) Kërkesat e saj, të institucioneve, publikut dhe të OJF-të, të cilat duhet të merren parasysh dhe të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;</p> <p>b) Një sqarim të përmbledhur për kërkesat e procedurës së thelluar të VNM-së, deri në paraqitjen e aplikimit në QKL dhe dhënien e deklaratës mjedisore;</p> <p>c) Detyrimin për informimin, konsultimin dhe dëgjuesën me publikun dhe OJF-të të raportit të thelluar të VNM-së dhe vlerësimin e mendimeve të dhëna në raport përpara se të paraqitet në QKL;</p> <p>ç) Analizimin e të paktën dy alternativave për zbatimin e projektit;</p> <p>Udhëzime për studimet dhe metodat për sigurimin e informacionit mjedisor dhe parashikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;</p> <p>d) Udhëzime për masat për mbrojtjen e mjedisit që duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;</p> <p>e) Strukturën dhe renditjen e informacionit në raportin e thelluar të VNM-së, në përputhje me shtojcën II të këtij vendimi;</p> <p>af) Faktin që projekti është subjekt i procedurës ndërkufitare të VNM-së, duke dhënë edhe udhëzimet përkatëse për këtë rast</p>	AKM	JO
<p>Kreu II, pjesa Ç (2): "Komunikimi i AKM-së me zhvilluesin publikohet, menjëherë në faqen elektronike të AKM-së dhe një kopje u dërgohet institucioneve të konsultuara."</p>	AKM	JO
<p>Kreu II, pjesa D: "Hartimi i raportit të thelluar të VNM-së dhe dëgjesa publike</p>		
<p>1. Hartimi i raportit të thelluar të VNM-së është përgjegjësi e zhvilluesit dhe hartohet në përputhje me shtojcën II të këtij vendimi. Gjatë hartimit të tij, zhvilluesi informon dhe konsultohet me publikun në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</p>	Zhvilluesi	Pjesërisht (Nuk është bërë informimi dhe konsultimi me publikun sipas kërkesave të VKM 247/2014)
<p>2. Pasi është hartuar raporti i thelluar i VNM-së, zhvilluesi njofton AKM-në për organizimin e dëgjuesës publike, duke informuar edhe për informimin dhe konsultimet e kryera gjatë hartimit të raportit.</p>	Zhvilluesi	Pjesërisht (nuk është dhënë informacioni për informimin dhe konsultimin e publikut)

3. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, i kërkon Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) të bashkëpunojë me njësinë e qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit për realizimin e dëgjësës publike në përputhje me kërkesat e nenit 17 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", dhe të akteve ligjore përkatëse.	AKM/ARM	Pjesërisht (nuk është bashkëpunuar me njësitë e qeverisjes vendore)
- 4. ARM-ja është e pranishme në ditën e dëgjësës publike dhe ka rol mbikëqyrës, duke regjistruar në mënyrë të pavarur mendimet dhe kërkesat e dhëna gjatë takimit nga publiku dhe palët e pranishme.	ARM	PO
5. ARM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore, përcjell në AKM informacion për mënyrën se si është zbatuar procedura, si dhe mendimet e kërkesat e dhëna nga publiku dhe palët e pranishme.	ARM	IC

Nga sa më sipër rezultoi e provuar se Deklarata Mjedisore ka konfirmuar formalisht një fakt që nuk ka ngjarë, sic është marrja në konsideratë e mendimeve të publikut, për sa kohë publiku i interesuar nuk është përfshirë fare në konsultim dhe as nuk jep e nuk mund të japë informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun, pasi nuk ka pasur një proces të tillë.

Një dokument i paraqitur nga shoqëria konsulente e zhvilluesit "GR Albania", i datuar Mars 2015 (pjesë e provave shkresore të paraqitura si Aneks 6 nga paditësit), dhe të cilit i referohet ankimesi në ankim, i referohet një takimi të organizuar prej saj në Hotel Fieri, në qytetin e Fierit me një listë emërore prej 50 personash dhe me disa foto, por duket qartë se ky dokument dhe takimi i fotografuar janë krejtësisht formalë dhe fiktivë. Kjo pasi sic u provua gjatë gjyqimit:

- (i) banorët e bashkive Mallakastër dhe Selenicë që preken drejtpërdrejtë nga projekti dhe OJF të fushës as nuk janë njoftuar, as nuk janë thirrur dhe as është dhënë mundësia në çfarëdo forme që të realizohet një proces real dhe ligjor konsultimi;
- (ii) personat pjesëmorrës në atë takim nuk kanë asnjë lidhje me komunitetin e interesuar, apo OJF të interesuara (vertetimet nga Bashkitë Selenicë dhe Mallakastër - Aneks 14 dhe Aneks 15 të provave shkresore të paraqitura nga paditësit);
- (iii) nuk janë përfshirë në realizimin e konsultimit sic kërkohet nga Ligji 10440/2011, Agjencia Rajonale e Mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore, institucione të tjera që do lëshojnë leje apo autorizime sic janë Këshilli Kombëtar i Ujit apo Këshilli i Basenit Ujor, OJF-të dhe publiku direkt i interesuar;
- (iv) i vetmi publikim, sic u provua gjatë gjyqimit edhe nga pohimi gjyqësor i personit të tretë KOVLU Energji sh.p.k., është ai i bërë në faqen e internetit të AKM (<http://akm.gov.al/publiku.html>), ku në kalendarin e publikimeve për muajin Shkurt 2015 rezulton publikimi si vijon:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton palët e interesuara për datat e zhvillimit të konsultimit me publikun

2014	2015	2016
Janar	Shkurt	Mars
Prill	Maj	Qershor
Korrik	Gusht	Shtator
Tetor	Nëntor	Dhjetor

<b>Subjekti</b>	<b>Di e Takimit</b>
CINAR SAN TIRANA BRANCH - Yuksel Ctnar hec, FR 18.02.2015	08.03.2015
<b>RAPORT I THELLUAR I NDIKIMIT NE MJEDIS</b> Vjosa varianti i 2 per akm.	

Pra, ky publikim i bërë në datë 18.02.2015, që njofton se me datë 08.03.2015, zhvilluesi do realizojë konsultimin me publikun është i vetmi publikim i bërë qoftë nga AKM, qoftë nga zhvilluesi për konsultim me publikun.

Është e cuditshme se si është arritur që në të njëjtën datë (18.02.2015) që është tërhequr nga zhvilluesi formulari për konsultimin me publikun, është plotësuar ky formular, është njoftuar në AKM, është bërë publikimi në faqe dhe është llogaritur mbajtja në faqe për 20 ditë!!!

Sidoqoftë, duhet sqaruar se duke filluar nga data 18 Shkurt 2015, 20 ditë përfundojnë më datë 10 Mars 2015, pra "takimi" në Fier është bërë 2 ditë para plotësimit të 20 ditëshit.

\* AKM, ka shkelur legjislacionin në fuqi në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis, duke penguar edhe ushtrimin e të drejtave të publikut të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, edhe në raport me detyrimet e përcaktuara në VKM nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

Të gjitha procedurat e detajuara nga kjo VKM nuk janë respektuar as nga zhvilluesi dhe as nga AKM.

VKM nr.247 përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga AKM-ja gjatë VNM-së së thelluar në lidhje me informimin dhe përfshirjen e publikut.

Përkatesisht, Kreu II "Informimi, konsultimi dhe dëgjesa publike gjatë procedurës së thelluar të VNM-së" përcakton procedurat e detajuara, aktorët e përfshirë, afatet dhe mënyrat e komunikimit për përfshirjen e publikut në këtë vendimmarrje.

Asnjë nga kërkesat dhe procedurat e specifikuara në këtë Kre, nuk është zbatuar as nga AKM dhe as nga zhvilluesi.

Më konkretisht nga çfarë u provua nga provat e shqyrtuara në gjykim, rezultoi se detyrimet e përmbyshura sipas VKM nr.247, datë 30.04.2014 janë si vijon:

Detyrimi i parashikuar në VKM 13/2013	Detyrim për:	Plotësuar (PO/JO)
Kreu II, pika 2.1: "Për të bërë të mundur informimin dhe marrjen e mendimit nga publiku dhe OJF-të, AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga zhvilluesi, publikon në faqen e saj të internetit, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e plotë të paraqitur nga zhvilluesi. Në publikim AKM-ja sqaron: a) procedurën që do të zbatohet për informimin, konsultimin dhe dëgjuesen publike për projektin deri në miratimin e Deklaratës Mjedisore; b) mënyrën dhe afatin kohor (20 ditë), duke sqaruar që brenda këtij afati mund të jepen mendime për çështjet, që duan të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së; c) afatin e parashikuar për miratimin e Deklaratës Mjedisore dhe publikimit të saj në faqen e saj të internetit; ç) mënyrën dhe afatin e ankimit ndaj procedurës së pjesëmarrjes së	AKM	JO
Kreu II, pika 2.4: "AKM-ja publikon menjëherë në faqen e saj të internetit komunikimin me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, ku përfshihen edhe mendimet e kërkesat e dhëna nga publiku.	AKM	JO



<p><i>Kreu II, pika 3: "3.1. Me qëllim ndërgjegjësimitin e publikut për ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, zhvilluesi, gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet në mënyrë të pavarur me publikun për këto ndikime duke kryer: a) publikimin e informacionit të plotë për projektin që është paraqitur në AKM, ekspozimin e informacionit që disponon për projektin në një zyrë të posaçme në zonën ku propozohet projektii ose në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore (NJQV) përkatëse;</i></p> <p><i>b) anketimin direkt të publikut të qendrave të banuara në zonën e ndikimit të mundshëm të projektit në mjedis;</i></p> <p><i>c) gjatë publikimit dhe anketimit, sqarimin nga zhvilluesi të qëllimit dhe përcaktimit të mënyrës së kontaktit se ku mund të dërgohen mendimet (adresën postare, numrin e telefonit dhe postën elektronike).</i></p> <p><i>3.2 Mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publikut merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së.</i></p> <p><i>3.3. Zhvilluesi dokumenton materialet e përdorura dhe evidencat përkatëse të procesit të informimit dhe konsultimit me publikun, duke i ruajtur dhe paraqitur ato si pjesë e dokumentacionit të aplikimit për Deklaratën Mjedisore."</i></p>	Zhvilluesi	JO
<p><i>Kreu II, pika 4.1:</i></p> <p><i>"Zhvilluesi ka këto përgjegjësi:</i></p> <p><i>a) Njofton AKM-në për dëgjuesën publike, duke i dërguar programin për organizimin e saj, raportin e thelluar të VNM-së dhe përmbledhjen joteknike të tij;</i></p> <p><i>b) Realizon njoftimin e publikut për organizimin e dëgjuesës publike; I dërgon NJQV-së dhe ARM-së nga 30 copë kopje të printuara të raportit të VNM-së dhe të përmbledhjes joteknike të tij, të cilat i vihen në dispozicion publikut të interesuar;</i></p> <p><i>c) Siguron mjediset ku do të mbahet dëgjesa me publikun;</i></p> <p><i>d) Siguron pjesëmarrjen e ekspertit/ekspertëve, që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së, ditën që organizohet dëgjesa publike;</i></p> <p><i>e) dh) Merr në konsideratë mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku ditën e dëgjuesës dhe i pasqyron ato në raportin e thelluar të VNM-së ose argumenton arsyet e pamundësisë së marrjes në konsideratë.</i></p>	Zhvilluesi	Pjesërisht (JO pikat b, c)

<p>Kreu II, pika 4.2:  <i>"AKM-ja ka këto përgjegjësi:</i>  a) Pas njoftimit nga zhvilluesi, udhëzon ARM-në përkatëse për rolin e saj në realizimin e dëgjësës publike;  b) Publikon në faqen e saj të internetit njoftimin për organizimin e dëgjësës publike;  c) I dërgon zyrtarisht një kopje të njoftimit strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri;  ç) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën publike;  d) Merr mendimin e publikut në fazën e shqyrtimit të projektit për Deklaratën Mjedisore;  dh) Merr në konsideratë rezultatet dhe kërkesat e publikut gjatë shqyrtimit për Deklaratën Mjedisore dhe procesit të VNM-së;  e) Publikon në faqen e saj të internetit informacionin që disponon për</p>	AKM	JO (me përjashtim të pikës b)
<p>Kreu II, pika 4.3.  <i>"ARM-ja ka këto përgjegjësi:</i>  a) Bashkëpunon me zhvilluesin dhe NJQV-në për organizimin e dëgjësës publike;  b) Afishon në ambientet e saj të punës dhe publikon në faqen e saj të internetit njoftimin përkatës për dëgjësën publike;  c) Ekspozon në ambientet e saj të punës kopjet e përmbladhjes joteknike të raportit të VNM-së;  ç) Merr pjesë ditën e dëgjësës dhe mban shënim diskutimet e bëra nga të pranishmit;  d) I dërgon AKM-së raportin për diskutimet e bëra gjatë dëgjësës publike brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dëgjësja publike;  dh) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën.</p>	ARM	JO
<p>Kreu II, pika 4.4.  <i>"Njësia e qeverisjes vendore ka këto përgjegjësi:</i>  a) Publikon në ambientet dhe faqen e saj elektronike njoftimin përkatës për dëgjësën publike;  b) Ekspozon pranë zyrave të saj kopjet e përmbladhjes joteknike të raportit të VNM-së;  c) Bashkëpunon me zhvilluesin, duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën publike;  ç) Nxist përfshirjen e komunitetit në pjesëmarrjen për dëgjësën publike;</p>	NJQV	JO (është lënë jashtë nga AKM/ARM)

<p>Kreu II, pika 5. "Bashkërendimi paraprak për organizimin e dëgjësës publike</p> <p>5.1. Zhvilluesi, mbasi ka hartuar raportin e thelluar të VNM-së, njofton AKM-në për organizimin e dëgjësës, duke i dërguar: a) planin e punës për organizimin e dëgjësës;</p> <p>b) informacionin për konsultimet e kryera gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;</p> <p>c) kopjen e njoftimit të hartuar sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi;</p> <p>d) kopjen elektronike të përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së.</p> <p>5.2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, udhëzon ARM-në përkatëse të bashkëpunojë me NJQV-në dhe me zhvilluesin e projektit për realizimin e dëgjësës publike, duke i dërguar informacionin e paraqitur nga zhvilluesi sipas pikës 5.1.</p> <p>5.3. ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së njoftimit prej AKM-së, komunikon me NJQV në zonën ku propozohet projekti, duke i dërguar një kopje të plotë të informacionit që ka marrë prej AKM-së, si dhe e informon për përgjegjësinë që ka në:</p> <p>a) publikimin dhe afishimin e njoftimit për dëgjësën publike;</p> <p>b) ekspozimin e përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së, pranë zyrave të NJQV-së;</p> <p>c) garantimin e pjesëmarrjes së stafit përkatës të NJQV-së në dëgjësën publike;</p> <p>d) nxitjen e komunitetit për pjesëmarrje në dëgjësën publike.</p> <p>5.4. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, i dërgon strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri një kopje të plotë të tij, e cila e publikon në rrjetet e mundshme të informimit. Zhvilluesi, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që i bën AKM-së sipas pikës 5.1, dërgon në NJQV të paktën 100 kopje të shtypura të përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së.</p>	<p>AKM/ARM/JO Zhvilluesi</p>	
<p>Kreu II, pika 6.1</p> <p>"Zhvilluesi i projektit, paralel me njoftimin e AKM-së, realizon, me shpenzimet e veta, informimin për zhvillimin e seancës dëgjimore. Informimi zgjat 20 (njëzet) ditë rresht dhe përfshin:</p> <p>a) publikimin e njoftimit, me informacionin që kërkohet sipas shtojcës I, në median audiovizive e median e shkruar lokale dhe, në rast se projekti ka karakter kombëtar, edhe në median kombëtare;</p> <p>b) vendosjen e një table informuese në vendin ku do të zhvillohet projekti, ku njoftimi për dëgjësën publike afishohet për 20 (njëzet) ditë rresht në mënyrë dhe vend të dukshëm;</p>	<p>Zhvilluesi</p>	<p>JO Pranuar me pohim gjyqësor nga personi i tretë</p>

<p>Kreu II, pika 6:</p> <p>6.2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që merr nga zhvilluesi sipas pikës 5.1, kryen këto veprime:</p> <p>a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;</p> <p>b) Afishon në hapësirën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjuesën publike.</p> <p>ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të AKM-së, sipas pikës 5.2., kryen këto veprime:</p> <p>a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;</p> <p>b) Afishon në zyrën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjuesën publike;</p> <p>c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.</p> <p>6.4. NJQV-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të ARM-së, sipas pikës 5.3., kryen këto veprime:</p> <p>a) Afishon në mjediset e saj, deri në datën e mbajtjes së seancës dëgjimore, njoftimin për dëgjuesën publike;</p> <p>b) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;</p> <p>c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.</p>	<p>AKM/ARM/JO, NJQV</p>	<p>pervec pikës 6.2 (a) publikuar vetëm për 18 ditë</p>
<p>Kreu II, pika 7.1.</p> <p>Seanca dëgjimore me publikun organizohet në një vend të përshtatshëm, sa më pranë vendndodhjes së projektit dhe <u>jo më herët se dita e 30-të kalendarike</u> nga data e njoftimit të AKM-së prej zhvilluesit, sipas pikës 5.1.</p>	<p>AKM/ARM/JO Zhvilluesi</p>	

Në referim të sa më sipër, në kushtet e zhvillimit të një procedure krejtësisht të kundraligjshme, që nuk zbaton dispozitat urdhëruese të ligjit, AKM, jo vetëm ka shkelur legjislacionin në fuqi në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis, por ka penguar edhe ushtrimin e të drejtave të publikut të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, e drejtë kjo e dhënë edhe me anë të dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit nr.10/440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", VKM nr.13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis" dhe VKM nr.247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

Gjithashtu, duhet të theksohet se nevoja për një VNM serioze dhe profesionale, vecanërisht për projektin e Pocemit, është specifikuar edhe nëvizuar edhe Rezolutën e Parlamentit European të 14 Prillit 2016 në lidhje me Progres Raportin e vitit 2015 për Shqipërinë (2015/2896(RSP)), e cila në pikën 23 të saj shprehet se Parlamenti European: "I bën thirrje qeverisë shqiptare për të kontrolluar zhvillimin e hidrocentraleve në zona të ndjeshme mjedisore të tilla si rreth lumit Vjosa dhe në zonat e mbrojtura dhe për të ruajtur integritetin e parqeve ekzistuese kombëtare, rekomandohet përmirësimi i vlerësimit të ndikimit të cilësisë në mjedis, i cili do të lejojë mbështetjen në standardet e BE-së të përcaktuara me anë të direktivave për Zogjtë dhe Habitatet dhe Direktivën e Sistemit të Ujërave; inkurajon qeverinë shqiptare për të rritur transparencën përmes pjesëmarrjes publike dhe konsultimeve për projektet e planifikuara".

Duke avancuar akoma më shumë, Komisioni European në Progres Raportin për Shqipërinë 2016, në Kapitullin 4.27 "Kapitulli 27. Mjedisë dhe ndryshimet klimatike",

vlerëson se: "Cilësia dhe zbatimi i VNM-ve duhet të përmirësohet, sidomos në sektorin e hidrocentraleve dhe minierave. Në sektorin e energjisë nuk zbatohen kërkesat strategjike mjedisore të vlerësimit, të cilat do të zgjerohen për të mbuluar të gjitha planet dhe programet përkatëse".

Për arsyet e mësipërme, Deklarata Mjedisore lëshuar nga Ministri i Mjedisit me Nr. Identifikimi 19, Nr. Vendimi 17, Nr. Prot 663, datë 24.04.2015, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, është në kushtet e aktit administrativ absolutisht të pavlefshëm, në kuptim të nenit 116 (c) të Ligjit nr 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative", si akt i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, dhe në këto rrethana Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pranoi kërkimin e paditësve dhe konstatoi pavlefshmërinë absolute të saj sipas nenit 17 (c) të Ligjit 49/2012.

2. Ankimuesi Ministria e Mjedisit në pikën III të ankimit (fq 7-15) nuk sjell asnjë argument, por thjesht transponon të plotë përmbajtjen e Deklaratës Mjedisore lëshuar nga Ministri i Mjedisit me Nr. Identifikimi 19, Nr. Vendimi 17, Nr. Prot 663, datë 24.04.2015.

Për të gjitha arsyet e mësipërme i kërkojmë Gjykatës Administrative të Apelit të mos pranojë ankimin e paraqitur nga pala e paditur Ministria e Mjedisit dhe të vendosë lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë".

**Pala paditëse**, rezulton të ketë ushtruar të drejtën e apelit kundërshtues ndaj ankimit të personit të tretë "Kovlu Energji" sh.p.k, duke i kërkuar Gjykatës së Apelit Administrativ, mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke konfirmuar, veç shkaqeve të apelit kundërshtues ndaj ankimeve të të paditurve Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Avokaturës së Shtetit, edhe këto shkaqe:

"Ankimuesi, shoqëria KOVLU ENERGJI, pretendon me ankim se pavlefshmeria e deklaratës mjedisore nuk sjell pavlefshmerinë automatikisht edhe të procedurës së koncesionit. Ky pretendim i ankimuesit është ngritur mbi premisa të pasakta. As paditësit, në konkluzionet e tyre përfundimtare dhe as gjykata në arsyetimin e vendimit objekt ankimi, nuk kanë vlerësuar që pavlefshmeria e procedurës së koncesionit, është pasojë automatike e pavlefshmerisë së deklaratës mjedisore.

Ndryshe nga sa parashtron ankimuesi, pavlefshmeria absolute e vendimit për shpalljen fitues dhe lidhjen e kontratës, u konstatua për shkak se është një akt që buron dhe bazohet në një akt absolutisht të pavlefshëm (Raporti i VNM dhe Deklarata Mjedisore lëshuar nga Ministri i Mjedisit me Nr. Identifikimi 19, Nr. Vendimi 17, Nr. Prot 663, datë 24.04.2015).

a) Në lidhje me VNM dhe Deklaratën Mjedisore si kushte skualifikuese:

U provua gjatë gjykimit, se nga data 17.03.2016 deri në datën 19.04.2016, Komisioni i Dhënies së Koncesionit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e ofertave dhe me Vendimin nr.1 datë 21.04.2016, ka vendosur klasifikimin dhe propozimin për shpallje fituese të së vetmes ofertë të paraqitur për konkurim, atë të bashkimit të shoqërive Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Çirketi & Ayen Enerji Anonim Sirketi.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) në publikimin e njëftimit të kontratës dhe Dokumentave Standarte të Koncesionit, në Aneksin 9 ka përcaktuar edhe kriteret për kualifikimin e ofertuesve.

Në këtë Aneks, një nga kriteret për kualifikim është edhe kushti që ofertuesit duhet të paraqesin "Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, të përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 10/440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Sic edhe u provua në gjykim, Raporti i VNM dhe Deklarata Mjedisore përkatëse nuk janë përgatitur dhe lëshuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10440/2010 dhe akteve nënligjore përkatëse dhe u konstatuan nga Gjykata si absolutisht të pavlefshëm.

Për pasojë edhe vendimarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë MEI, konkretisht Vendimi nr.1 datë 21.04.2016, i KYO pranë MEI që ka si premisë konsideratën e

gabuar se Raporti i VNM i paraqitur dhe Deklarata Mjedisore perkatase plotësojne kushtin kualifikues, rezulton se është pasojë e një akti absolutisht të pavlefshëm.

Pra sic edhe Gjykata me te drejte ka arsyetuar duhet të konstatohet pavlefshmëria absolute e Vendimit nr.1 datë 21.04.2016, i KVO pranë MEI, pasi Raporti i VNM i paraqitur dhe Deklarata Mjedisore duke konstatuar si absolutisht të pavlefshme, nuk mund të sjellin pasojë juridike, pasi konsiderohet sikur nuk kanë ekzistuar asnjehere.

Edhe pretendimi i ankimuesit per referim në nenin 117, paragrafi 3 te Kodit te Procedurave Administrative është i pabazuar dhe i vendosur ne premisa te gabuara.

Ankimuesi synon te orientoje pretendimin e vet duke prezumuar se kemi te bejme me pavlefshmeri absolute te nje pjese te aktit, por nuk eshte keshtu.

Procedura koncesionare dhe vendimi perfundimtar eshte nje e tere dhe integrale, pra ne nuk mund ti kerkohet gjykates te analizoje procedurën duke e repetuar ne pjese te vecanta dhe as nuk mund te behet nje vleresim i tille.

Rikujtojmë këtu, se legjislacioni per procedurat koncesionare dhe Dokumentat Standarte të Koncesionit, në Aneksin 9 ka kane përcaktuar edhe kriteret për kualifikimin e ofertuesve, jane taksative ne lidhje me rastin kur nuk plotësohet qofte edhe nje nga kriteret per kualifikimin e ofertuesve, duke përcaktuar në menyre eksplicite se mosplotësimi i qofte edhe njerit prej kriterëve ka si pasojë skualifikimin e ofertuesit.

Pra ne rastin konkret, mosplotësimi i kriterit per paraqitjen e "Raportit te Vlerësimit te Ndikimit në Mjedis, të përgatitur në përputhje me Ligjin nr.10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, është kusht skualifikues, por pikese pari është prove se vendimmarrja e KVO per shpalljen fitues dhe lidhjen e kontrates bazohet ne nje akt absolutisht te pavlefshem, cka e ben edhe vendimmarrjen te pavlefshme.

Ankimuesi, gabon ne arsyetimin e vet kur ngaterron Shtojcen 10 te Dokumentave Standarte te Koncesionit: "Kriteret e Vlerësimit", me shtojcen 9 te Dokumentave Standarte te Koncesionit: "Kriteret per kualifikimin e Ofertuesve".

Te dytat jane taksative: mungesa qofte edhe e njerit prej elementeve passjell skualifikimin dhe perfashtimin nga gara te ofertuesit, ndersa te parat jane objekt vleresimi me pike nga KVO pasi jane plotësuar 100% kriteret e Shtojces 9.

Pra nuk ka vend vleresime ne kriteret e Shtojces 9, pasi permbushja e tyre verifikohet votem ne formen POJO, ndersa kriteret e vlerësimit te Shtojces 10, aplikohen per renditjen nepermjet pikeve te ofertuesve te kualifikuar qe kane kaluar me "Po" plotësimin e te gjitha kriterëve te Shtojces 9.

Parashtrimet e tjera ne kete pike (1) te ankimit jane thjesht rrefime ne lidhje me proceduren e koncesionit dhe hapat e ndjekura dhe nuk kane lidhje as me vendimin objekt ankimi as me pretendimet perfundimtare objekt padie".

## GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV

pasi dëgjoji relatimin e çështjes nga gjyqtari kryesues, referuar akteve bashkëngjitur dosjes Nr.1813 (1845) Dt.02.05.2017:

### VËREN

Referuar Ekstraktit Historik të Regjistrimit DL01.04.2015, rezulton se shoqëria tregtare "Çinar-San Tiran Branch" degë e shoqërisë së huaj, ushtron prej vitit 2012 aktivitet tregtar, ndër të tjera edhe në fushën e hapjes, gërmimit dhe bërjes së çdo lloj mbushjeje të digave, liqeneve artificial, rrugëve automobilistike, çdo lloj punimi të infrastrukturës, tuneleve, hekurudhave, aeroporteve, minierave dhe objekteve të tjera të ngjashme, bërjes së çdo lloj projekti, dhënies së shërbimit inxhinierik dhe arkitekturor në lidhje me objektet e sipërpërmendura si dhe dhënien e shërbimit të konsulencës në lidhje me to, dhënies së

shërbimeve inxhinierike dhe artikteturore, hartimi i projekteve, planeve, bërja e llogaritjeve dhe analizës së fizibilitetit, dhënia e shërbimit të konsulencës, studimit, kërkimit si dhe dhënia e shërbimeve të transmetimeve profesionale, kryerjes dhe marrjes përsipër të ndërtimeve me çelik, beton, gurë, dërrasë, parafabrikate dhe të tjera të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit.

Nëpërmjet Kërkesës Nr.317 Prot Dt.18.02.2015 "Kërkesë për tërheqje të formularit për konsultim publik", drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Shoqëria tregtare "GR ALBANIA Planning & Environmental Consulting Company", rezulton të ketë bërë me dije se:

*"Unë i nënshkruar Suela Spahiu, përfaqësues i shoqërisë "GR ALBANIA", në kuadër të organizimit të konsultimit me publikun, në lidhje me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Miedis të aktivitetit në kryen shoqëria innë. hëj këtë kërkesë për tërheqje të formularit të kërkesë, bazuar në VKM Nr.247, Datë 30.04.2015, "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" dhe Urdhërit Nr.78, datë 14.05.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së.*

*Më poshtë gjeni të dhëna lidhur me shoqërinë dhe aktivitetin që ajo kryen:  
Shoqëria: Çinar-San Tiran Branch  
Përfaqësuesi: Yuksel Çinar  
Aktiviteti: Ndërtim HEC  
Vendodhja (Qarku, Rrethi, Bashkia/Komuna, Fshati): Fier, Mallakastër, Fier/Kutë, Poçem".*

Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ([www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)), më datë 18.02.2015 rezulton të jetë publikuar: *Cinar San Tirana Branch-Yuksel Cinar, HEC, FR Raporti i Thelluar i Ndikimit në Mjedis Vjosa varianti i 2 për akm.*

Në Mars 2015, Shoqëria tregtare "GR ALBANIA Planning & Environmental Consulting Company", me porosi të "Çinar-San" sh.p.k, rezulton të ketë përpiluar Raportin e Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e HEC-it Poçem.

Pjesë e raportit rezulton të jetë dhe "Konsultimi me publikun për Hartimin e VNM Ndërtimi i HEC-it POÇEM", në të cilin pasqyrohet procesi i konsultimit publik (njoftimi, realizimi, agjenda e dëgjësës publike), si dhe lista e pjesëmarrësve në takimet e organizuara në kuadër të këtij procesi, në ambientet e Hotel "Fieri", në qytetin e Fierit.

Bazuar në Kërkesën e paditësit "EcoAlbania", rezulton që Bashkia Mallakastër<sup>1</sup>, Njësia Administrative Aranitas<sup>2</sup>, Njësia Administrative Hekal<sup>3</sup>, Njësia Administrative Kutë<sup>4</sup>, Njësia Administrative Fratar<sup>5</sup>, Njësia Administrative Ballsh<sup>6</sup>, Njësia Administrative Greshicë<sup>7</sup>, të kenë konfirmuar të mosqenurit e personave pjesëmarrës në konsultimin publik, banorë të këtyre njësive.

Ministri i Mjedisit rezulton të ketë miratuar Deklaratën Mjedisore Nr.663 Prot/Nr.192 Identifikimi, Nr.17 Vendimi Dt.24.04.2015, që konsiston në:

<sup>1</sup> Shkresa Nr.2007/2 Prot Dt.17.11.2016.

<sup>2</sup> Shkresa Nr.67 Prot Dt.15.11.2016.

<sup>3</sup> Shkresa Nr.144/1 Rëgj. Dt.10.11.2016.

<sup>4</sup> Shkresa Nr.35 Prot Dt.10.11.2016.

<sup>5</sup> Shkresa Nr.47 Prot Dt.10.11.2016.

<sup>6</sup> Shkresa Nr.610 Prot Dt.10.11.2016.

<sup>7</sup> Shkresa Nr.366 Prot Dt.11.11.2016.

*"Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:*  
*Person Juridik: "Çinar-San Tiran Branch" me LC-2092*  
*Nr.NIPT-i: L22124014S*  
*Adresa e selisë: Pallati Fines Nobis, Kulla F, Rruga "Samë Frashëri, Tiranë*  
*Personi përgjegjës: Yuksel Çinar*  
*Për të zhvilluar projektin: "Ndërtim i HEC-it Poçem".*

Këshilli i Ministrave rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.677 Dt.29.7.2015 "Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Poçem", duke konfirmuar nëpërmjet tij se:

*"Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.125/2013, datë 25.4.2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave*

**VENDOSI:**

- 1. Miratimin e bonusit prej 8 (tetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë "Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Şirketi" për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Poçem".*
- 2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare".*

Ministri i Energjisë dhe Industrisë rezulton të ketë disponuar Urdhrin Nr.288 Dt.24.11.2015, i ndryshuar<sup>8</sup>, që konsiston në:

*"1.Ngritjen e komisionit për dhënie e koncesionit, të hidrocentralit "Poçem", me përberjen e mëposhtme:...*

*2.Komisioni për dhënie e koncesionit, të përgatisë dokumentet e tenderit, bazuar në ligjin e sipërpërmendur si dhe të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat që do të prunohen dhe/ose kërkesat për pjesëmarrjen që do të dorëzohen si dhe të kryejë detyrat e tjera të përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji.*

*3.Komisioni të përcaktojë procedurën e zbatueshme për dhënie e Koncesionit të këtij hidrocentralit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret në fuqi.*

*4.Ngarkohet anëtarët e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.*

*5.Komisioni për dhënie e koncesionit, të hidrocentralit "Poçem", do të asistohet nga firma konsulentë "AF Mercados EMI" Madrid-Spanjë.*

Ministri i Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktues, rezulton të ketë disponuar Njoftimin e Kontratës Nr.2632/26 Prot Dt.22.01.2016 (në gjuhën shqipe dhe angleze), nëpërmjet të cilit konfirmohen:

*"Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktues: Ministria e Energjisë dhe Industrisë...*

*Objekti dhe lloji i Kontrates: Dhënie me koncesion të hidrocentralit "Poçem" dhe lloji i kontrates "Pune".*

*Kezgjatja e Kontrates: 35 vjet.*

*Vendndodhjen e objektit të Kontrates: Ndërtimi i hidrocentralit me dige në do të jete në vendin e quajtur Poçem, rrjedhen e poshtme të Lumit Vjose në kuote operimi 70 m.n.m.d (bjefi i poshtem i HEC Kalivac).*

<sup>8</sup> Ndryshuar me Urdhrin Nr.288/1 Dt.22.01.2016 "Për një ndryshim në Urdhrin Nr.288, datë 24.11.2015 "Për ngritjen e Komisionit "Për dhënie e koncesionit të hidrocentralit "Poçem" të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, sa i takon numrit të anëtarëve të komisionit, duke i reduktuar nga 11 në 7.



Informacionin ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik. Ne përputhje me shtojcën 9 të DSK

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit. Ne përputhje me shtojcën 10 të DSK.  
Afati kohor për dorëzimin e ofertave: Brenda dhe jo me vonë se: Data 17/03/2016, Ora

12<sup>00</sup>  
09 Afati kohor për hapjen e ofertave: Brenda dhe jo me vonë se: Data 17/03/2016, Ora 12

Periudha e vlefshmerise se ofertave: 150 dite”.

Më datë 17.03.2016 rezultoi të jetë mbledhur Komisioni i Dhënies me Koncesion të Hidrocentralit “Poçem”, i cili pas mbylljes së pranimit të ofertave dhe hapjes së tyre, ka konstatuar dorëzimin e vetëm një oferte, nga operatori ekonomik “Çinar-San Tiran Branch”<sup>9</sup>.

Më tej, Komisioni i Dhënies me Koncesion të Hidrocentralit “Poçem” rezultoi të jetë mbledhur më datë 07.04.2016, për të vlerësuar kriteret kualifikuese të ofertuesit, duke konstatuar se:

“Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti” dhe “Ayen Enerji Anonim Sirketi” ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe në përputhje me kërkesat e parashikuara në shtojcën nr.9 të DSK.

Më pas, u shqyrtua dokumentacioni kualifikues ekonomik-financiar dhe pas vlerësimit të saj, rezultoi se Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive ka burime të mjaftueshme financiare duke përmbytur kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe se kualifikohet për fazën e mëtejshme.

Më tej, u mor në shqyrtim dokumentacioni kualifikues teknik dhe profesional dhe pas vlerësimit të saj, u konstatua se Ofertuesi gëzon të gjitha kapacitetet teknike dhe profesionale për realizimin e këtij objekti”.

Më datë 15.04.2016, Komisioni i Dhënies me Koncesion të Hidrocentralit “Poçem” zhvilloi mbledhjen e radhës, duke konfirmuar nëpërmjet saj, se:

“Sikurse është konstatuar tashme, ofertuesi i vetëm, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Çinar- San Hafriyat Nakliyat İnçaat Turizm San Ve Tic Ltd.Çti” dhe “Ayen Enerji Anonim Çirketi” ka paraqitur ofertën teknike, e cila bazohet në ndërtimin e veprave hidroteknike me përmasa të mëdha me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 99.5 MË dhe energji mesatare vjetore prej më shumë se 300 GWh.

Në këto kushte, duke pasur parasysh madhësinë e projektit, me qëllim vlerësimin sa më të plotë dhe të saktë të kësaj oferte, nga anëtarët e komisionit është gjykuar përfshirja në këtë proces, së pari, kontributi dhe vlerësimi i konsulentëve të jashtëm bazuar dhe në pikën 4 të Urdhrit të ministrit për ngritjen e Komisionit të Dhënies me Koncesion.

Se dyti, bazuar në përcaktimin e nënpikës 5.2.2. të pikës 5.2. “Vlerësimi i Ofertave” të Dokumentave të Koncesionit, mbështetur dhe në nenin 16 të Ligjit për Koncesionet, përpara vlerësimit përfundimtar teknik nga ana e Komisionit, Komisioni kërkon edhe hartuesit e projektit teknik dhe mjedisor të ofertës së paraqitur, për ta prezantuar këtë projekt dhe për të dhënë sqarime të mëtejshme bazuar në të dhënat dhe vete përmbajtjen e ofertës së paraqitur.

Në të njëjtën mbledhje, kërkohet prononcimi i z. Redi Baduni në detyrën e drejtorit të mjedisit në Ministrinë e Mjedisit i cili ka trajtuar çështje mjedisore në kuadër të Grupit të

<sup>9</sup> Formulari i Ofertës rezultoi të jetë dorëzuar nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti” dhe “Ayen Enerji Anonim Sirketi”, në cilësinë e ofertuesit për procedurën konkurruese “Dhënie me koncesion të Hidrocentralit – Poçem”.

*Identifikimit të Propozimeve të Pakërkua, që së bashku me anëtarët e tjerë ka identifikuar Projekt-propozimin për ndërtimin e hidrocentralit të Poçemit.*

*Në përfundim, u la për detyrë të njoftohet ofertuesi dhe njëkohësisht z. Baduni, për këtë takim, i cili paraprakisht, do të propozohet nga ana e komisionit, të zhvillohet të martën e datës 19 Prill në orën 12<sup>00</sup>, pranë ambienteve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”.*

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 19.04.2016, Komisioni i Dhënies me Koncesion të Hidrocentralit “Poçem”, pas marrjes së sqarime, rezultojn të ketë planifikuar datën 21.04.2016, për të vlerësuar projektin sipas përcaktimeve të DSK-së.

Komisioni i Dhënies me Koncesion të Hidrocentralit “Poçem”, në mbledhjen e datës 21.04.2016, ka vendosur:

*“Kualifikimin si ofertë të parën dhe të vetme me 92 pikë. Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd Sti” dhe “Ayen Enerji Anonim Sirketi” dhe në baze të Ligjit Nr 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, dhe VKM nr.576, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet”, njofton ofertuesin fitues për klasifikimin përfundimtar si dhe i propozon Kryetarit të Autoritetit Kontraktues, të shpallë fitues Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnçaat Turizm San Ve Tic Ltd.Çti” dhe “Ayen Enerji Anonim”.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, rezultojn të ketë disponuar Vendimin Nr.1 Dt.21.4.2016, me të cilin ka vendosur:

*“1.Të klasifikojë Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti” dhe “Ayen Enerji Anonim Sirketi”, si ofertë e vetme, me shumën totale të pikëve, prej 92 pikë.*

*2.Të njoftohet shoqëria pjesëmarrëse.*

*3.T’i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor shpalljen fituese të procedurës konkurruese për ndërtimin e HEC-it “Poçem” Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti” dhe “Ayen Enerji Anonim Sirketi”.*

Ministri i Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktues, rezultojn të ketë miratuar Raportin Përmbledhës Nr.2692/32 Prot Dt.29.04.2016 “Mbi zhvillimin e procedurës koncesionare dhe vlerësimin e ofertave për “Dhënien me koncesion të hidrocentralit Poçem”, nëpërmjet të cilit është propozuar shpallja e fituesit Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti” dhe “Ayen Enerji Anonim Sirketi”.

Ministri i Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktues, rezultojn të ketë disponuar Formularin e Njoftimit të Fituesit Nr.2632/33 Prot Dt.29.04.2016, që konsiston në njoftimin e pranimit të ofertës së paraqitur më datë 17.03.2016, nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti” dhe “Ayen Enerji Anonim Sirketi”, për marrjen me koncesion të hidrocentralit “Poçem”.

Nëpërmjet Shkresës Nr.2632/34 Prot Dt.29.04.2016, Ministri i Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktues, rezultojn të ketë njoftuar përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë tregtare “Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti”, mbi faktin e pranimit të ofertës së paraqitur më datë 17.03.2016, për marrjen me koncesion të hidrocentralit “Poçem”.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nëpërmjet Shkresës Nr.1547/1 Prot Dt.29.06.2016, rezulton t'i ketë bërë me dije paditësit "EcoAlbania", faktin se:

*"1.Pranë AKM nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për procedurë VNM për HEC Poçem.*

*2.Për HEC Poçem, nuk është lëshuar ndonjë deklaratë/leje.*

*3.Duke qenë se nuk ka aplikim për këtë veper, nuk disponojmë asnjë Raport VNM, në lidhje me aktivitetin".*

Nëpërmjet Shkresës Nr.5082/1 Prot Dt.08.08.2016, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore rezulton t'i ketë bërë me dije paditësit "EcoAlbania", se:

*"Në përgjigje të Shkresës tuaj me Nr.35 Prot., datë 27.06.2016, mbi kërkesën për informacion mbi HEC-in "Poçem", ju bëjmë me dije se grupi i Oponencës Teknike pranë AKBN-së ka bërë vlerësimin e studimit të fisibilitetit të HEC-it "Poçem", për vijueshmërinë e procesit dhe informacione të mëtejshme ju lutem drejtohuni MEI (Autoriteti Kontraktor), si autoriteti përgjegjës për lidhjen e kontratave koncesionare".*

Më datë 09.08.2016 nga Shoqëritë tregtare Çinar-San Hafriyat Nakliyat Insaat Turizm San Ve Tic Ltd.Sti dhe Ayen Enerji Anonim Sirkeci, rezulton të jetë krijuar shoqëria tregtare "Kovlu Enerji" sh.p.k, me objekt të aktivitetit "Ndërtimi i HEC-it Poçem, të tipit me digë në rrjedhën e poshtme të lumit Vjosë, të tipit BOT, (Ndërto-opero-transfero), prodhim, transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike, nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve me anë të procedurave të koncesionit. Ndërtim, depozitim, shfrytëzim i burimeve ujore dhe natyrore me qëllim prodhimin e energjisë. Krijimin e linjave të prodhimit, të njësisve të vogla dhe të mëdha për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike së prodhuar nga burime natyrore dhe alternative".

Ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta, shoqëria "Kovlu Enerji" sh.p.k, në cilësinë e koncesionarit, rezulton të jetë nënshkruar Kontrata e Koncesionit Nr.2174 Rep/755/6 Kol Dt.05.09.2016 e Formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Poçem", e publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.43 Dt.31.10.2016 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Duke mos qenë dakord me sa më sipër, paditësat e kanë bërë çështjen konflikt gjyqësor, duke kërkuar nëpërmjet padisë së dorëzuar më datë 02.12.2016, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Deklaratës Mjedisore me nr. Identifikimi 19, nr. Vendimi 17, Nr. Prot. 663 Dt.24.04.2015 lëshuar nga Ministri i Mjedisit me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit Nr.228 Dt.24.11.2015 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe çdo akti tjetër të Ministrit që i paraprin atij që ka vendosur në parim realizimin e procedurave koncesionare, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr.1 Dt.21.04.2016 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë MEI dhe të gjitha veprimeve të tjera administrative të prejardhura nga Urdhri Nr.228 Dt.24.11.2015 i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, konstatimin e paligjshmërisë së kontratës së lidhur mes MEI dhe Subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "KOVLU ENERJII" sh.p.k me NIPT L62010004L, kontratë Noteriale me Nr. 2174 Rep., Nr. 755 Kol., Dt.05.09.2016, njoftimi për të cilën është botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.43 Dt.31.10.2016, si veprim që nuk prodhon pasoja juridike, ose nëse do të konsiderohet e nevojshme, detyrimin e MEI për të zgjidhur kontratën për arsye të interesit publik.

Njëherësh me padinë, paditësat rezultojnë të kenë paraqitur dhe kërkesën për marrje mase sigurimi padie, nëpërmjet pezullimit të zbatimit të kontratës së lidhur mes MEI dhe Subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "KOVLU ENERGI" sh.p.k deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes me vendim të formës së prerë.

Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, rezultojnë të ketë disponuar vendimin datë 13.12.2016, që konsiston në refuzimin e saj.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë, zhvilluar në mungesë të të paditurit Ministria e Mjedisit, pala paditëse, veç shkaqeve të ngritura në kundërankim, ka pretenduar edhe se:

*"Paditësat në mënyrë të rastësishme në muajin Shtator 2015 kanë ardhur në dijeni të VKM nr.677 datë 29.07.2015 "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë për dhënie me koncesion të hidrocentralit Pocem". Paditësat ishin në padljeni totale të ndonjë procedure të filluar për realizimin e këtij projekti.*

*Për shkak të ndjeshmërisë publike jo vetëm kombëtare por edhe europiane ndaj pasurisë natyrore që përben lumi Vjosa jo vetëm për Shqipërinë, por i konsideruar si një nga lumenjtë e fundit - në mos lumi i fundit i kontinentit Evropian i mbetur i virgjër, një grup i madh qytetarësh dhe OJFsh, mes të cilëve edhe paditësit, u angazhuan menjëherë me përpjekjet për të zbuluar dhe kuptuar çfarë veprimtarie po kryhej nga MEI në këtë lumë.*

*Me shumë vështirësi u arrit të zbulohet se MEI kishte filluar procedurën e realizimit të Projektit "Ndërtimi i hidrocentralit të Pocemit, në rrjedhën e Vjosës deri në kuotën 70 m.a.s.l (poshtë hidrocentralit të Kalivacit)", i cili do të operohet si koncesioni i Hidrocentralit të Pocemit nga Qeveria Shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në bazë të një propozimi të pakërkuar të paraqitur nga shoqëria turke Çinar-San Hafriyat Nakliyat İncaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Çirketi.*

*Nga ai pak dokumentacion që paditësat kanë mundur të sigurojnë (me shkresën nr.411/1 datë 01.09.2016 të MEI, me shkresën nr.1547/1 datë 29.06.2016 të AKM dhe nëpërmjet kërkimit të pavarur), rezultojnë se e gjithë procedura administrative e realizimit të këtij projekti karakterizohet nga paligjshmëria e aktivitetit administrativ të të paditurve, të cilët kanë vepruar në shkelje flagrante të një mori dispozitash ligjore në fuqi.*

*Sipas të dhenave dhe informacioneve të mbledhura nga paditësit, kronologjia e ngjarjeve dhe statusi ligjor i Projektit "Ndërtimi i hidrocentralit të Pocemit" paraqitet si vijon:*

*1.Në një kohë të panjohur për paditësat, shoqëria turke Çinar-San Hafriyat Nakliyat İncaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Çirketi, i ka paraqitur MEI propozim të pakërkuar së bashku me studim fizibiliteti për realizimin nëpërmjet kontratës së koncesionit të Projektit "Ndërtimi i hidrocentralit të Pocemit, në rrjedhën e Vjosës deri në kuotën 70 m.a.s.l (poshtë hidrocentralit të Kalivacit).*

*2.Në datën 18.03.2015, pa asnjë njoftim pranë dhe nga ARM dhe organet e pushtetit vendor, shoqëria GR Albania, konsulente e shoqërisë Çinar-San Tiran Branch, ka organizuar një takim në qytetin e Fierit, me pjesëmarrje sipas saj të 50 personave, të cilët nuk rezultojnë asnjëri pjesë e komitetit të banorëve të zonës ku planifikohet të ndërtohet hidrocentrali;*

*3.Në datë 24.04.2015, shoqëria Çinar-San Tiran Branch, është pajisur me Deklaratën Mjedisore lëshuar nga Ministri i Mjedisit me Nr. Identifikimi 19, Nr. Vendimi 17, Nr. Prot 663;*

*4.Në datë 14.05.2015, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, ka dhënë opinionin teknik për studimin e fizibilitetit të paraqitur me propozimin e pakërkuar të shoqërisë Çinar-San Hafriyat Nakliyat İncaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Çirketi;*

*5.Me Urdhërin nr.288 datë 24.11.2015 "Për ngritjen e Komisionit për Dhënie të Hidrocentralit Pocem". Ministri i Energjisë dhe Industrisë i ka dhënë udhë fillimit të procedurave koncesionare për hidrocentralin Pocem;*

*6.Me datë 22.01.2016, Komisioni i Dhënies së Koncesionit ka miratuar Dokumentat*

Standarte të Koncesionit (DSK) për hidrocentralin Pocem dhe po në të njëjtën datë është bërë publikimi i njoftimit të kontratës dhe DSK në Sistemin e Prokurimeve Elektronike;

7. Nga data 17.03.2016 deri në datën 19.04.2016, Komisioni i Dhënies së Koncesionit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e ofertave dhe me Vendimin nr.1 datë 21.04.2016, ka vendosur klasifikimin dhe propozimin për shpallje fituese të së vetmes ofertë të paraqitur për konkurim, atë të bashkimit të shoqërive Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnçaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Çirketi & Ayen Enerji Anonim Sirketi;

8. Me datë 05.09.2016 mes MEI dhe Subjektit për Qëllime të Vecanta shoqëria "KOVLU ENERJJI" sh.p.k. me NIPT L62010004I, është lidhur kontrata koncesionare noteriale me nr.2174 Rep nr.755 Kol, e datës 05.09.2016, njoftimi për të cilën është botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.43 datë 31.10.2016.

Të dhënat shkencore specifike për Vjosën dhe biodiversitetin e saj janë ende të limituara, ndaj në momentin aktual, është praktikisht e pamundur që impaktet e digave mbi Vjosë të vlerësohen objektivisht dhe me vërtetësi. Pikërisht në lidhje me këtë çështje, në një konferencë ndërkombëtare shkencore të mbajtur në Qershor 2016, mbi 200 shkencëtarë të mirënjohur ndërkombëtarisht kanë nënshkruar një Memorandum, duke kërkuar në mënyrë specifike për Vjosën që:

"Në lidhje me këtë, pellgu ujor i Vjosës në gjendjen e tij të ndikimit të pakët antropogjen - mund të shërbejë si një strehë natyrore në shkollë të gjerë dhe si një laborator më rëndësi për mbarë Evropën. Për shkak të vazhdimësisë së pashqetësuar lumore, të transportit të sedimenteve dhe morfo-dinamikës lumore, si dhe të biodiversitetit të tij të veçantë, Vjosa përbën një sistem ndërkombëtar model, të veçantë për dinamikën e ndërlikuar morfologjike dhe biologjike të korndoreve lumorë, për studime që ndihmojnë në bashkë kalibrimin e vlerësimit të ndërhyrjeve në lumenj, dhe mund të shërbejë si një vend krahasues ndërkombëtar për kërkime mbi ndryshimin e klimës.

Për këtë, planet e sotme për ndërtimin e digave për hidrocentrale kërkojnë vlerësime të hollësishme mbi strukturën dhe dinamikën hidrologjike, sedimentologjike dhe ekologjike, të cilat do të bëjnë gjithashtu të mundur përpunimin e koncepteve alternative me ndikim të ulët. Ne këshillojmë që gjithë vlerësimet e ndikimit në mjesdis për çdo ndërtim hidrocentrali të ndjekin në mënyrë të rreptë standardet e BE-së".

Ndërkohë që qeveria shqiptare ka avancuar në planet e saj me ndërtimin e HEC Pocem, nuk është përgatitur një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) i përshtatshëm dhe i besueshëm për këtë projekt. Njohuritë shkencore rreth ekosistemit të Vjosës (biodiversiteti, transporti i sedimentit etj) janë shumë të limituara, ka shumë pak vlerësime të tilla shkencore. Pra, është e pamundur të vlerësohet dhe parashikohet me saktësi ndikimi i digave të projektuara. Edhe pse ekzistojnë një numër i vogël studimesh, është e qartë se Vjosa është një pikë e rëndësishme për biodiversitetin. Sidoqoftë, gjasat janë që kur të kryhen vlerësime dhe studime të tjera thelbësore, do të zbulohen dhe evidentohen akoma më shumë specie.

Pavarësisht nga sa më sipër, njohuritë aktuale tregojnë se speciet dhe habitatet e mbrojtura të listuara në Aneksët e Konventës së Bernës janë në rrezik nëse ky projekt zbatohet.

Sipas vlerësimeve të deritanishme, të paktën 177 specie të listuara në Aneksët e Konventës së Bernës gjenden në luginën e Vjosës: 9 gjitarë, 112 specie zogjsh, 12 specie peshqish, 32 amfibë dhe reptilë, 9 specie insektesh dhe 3 bimë vaskulare. Vlerësime të mëtejshme me shumë gjasa do të zbulojnë edhe më shumë specie të mbrojtura nga Konventa e Bernës. Bazuar në këto gjetje dhe cilësitë e habitatit, e gjithë lugina e Vjosës do të kualifikohet si zonë Emerald dhe do të kërkonte mbrojtje. Të paditurit, nëpërmjet vendimmarrjes së tyre të pa mbështetur në një VNM të saktë dhe serioze, kanë injoruar sektorin më me vlerë dhe dinamik të ekosistemit të Vjosës, zonën që shtrihet mes Tepelenës dhe Selenicës. Jo vetëm kaq, por edhe zona aktuale e mbrojtur Emerald "Peisazhi i mbrojtur i kompleksit ligatinor Vjosë - Nartë" (19,412 ha) do të dëmtohet seriozisht.

Projekti i Pocemit do të shkaktojë shkatërrim të rrjedhës së poshme dhe biodiversitetit

në këto zona. Rezervuari që është projektuar do të shkaktojë përmbytje të mëdha të zonave ku shtrihen ishujt, pyjet dhe tokat bujqësore. Si rrjedhojë të gjitha specie që gjallojnë në këto zona rrezikohen seriozisht.

*Vlerat sociale-ekonomike dhe kulturore:*

Lumi Vjosa ka një vend të veçantë dhe të rëndësishëm në jetën e përditshme të banorëve që jetojnë përgjatë brigjeve të tij. Tarracat e saj u sigurojnë fshatrave tokën pjellore për aktivitete bujqësore të tilla, si prodhimet agrokulturore dhe blegtorale.

Sasia dhe shumëllojshmëria e peshkut janë jetike për ekonominë dhe mirëqenien e komunitetit vendas. Turizmi rekreativ në Vjosë dhe degët e tij janë gjithnjë në rritje, veçanërisht në vitet e fundit në të cilën entuziastët kanë filluar të organizojnë veprimtari të tilla si rafting, kanotazh, not, etj. Shumë biznese të vogël dhe të rinj si kompanitë e eko-turizmit në zhvillim, kanë bazuar eksistencën e tyre në rrjedhat natyrore të Vjosës.

Sipas opionencës teknike të bërë për projektin nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), opionencia që MEI ka refuzuar tua vere zyrtarisht në dispozicion paditesve, parashikimi fillestar tregon që sipërfaqja e përmbytur do të jetë rreth 2400 hektarë, numri i familjeve që mund të zhvendosen rreth 90, ndërsa kostat e shpronësimit dhe sistemit të familjeve janë ende të të papërllogaritura. Deri më tani ky është i vetmi dokument që i ka cekur në mënyrë sipërfaqësore këto ndikime. Vetë VNM që është pikërisht dokumenti që duhet të adresojë ndikimet social-ekonomike, nuk ka paraqitur të dhëna specifike dhe reale, projeksione apo masat zbutëse për këtë qëllim.

*Kërcënimet:*

Kërcënimet aktual më i madh për lumenjtë është ndërtimi i HEC-ëve. Më shumë se 500 diga të hidrocentralesh janë ngritur dhe planifikohen të ndërtohen në të gjithë Shqipërinë. Përgjatë pjesës shqiptare të lumit të Vjosës, Ministria e Energjisë synon të ndërtojë 8 diga, 32 së bashku me digat në degët e Vjosës. Ndërtimi i këtyre digave, ose i vetëm njëres prej tyre, do të shkatërronte vlerat e jashtëzakonshme ekologjike të lumit Vjosa. Këto ndërhyrje do të ndryshonin tërësisht regjimin e saj hidrologjik dhe do të pengonin transportin natyror të sedimenteve, forcës fillestare që u jep formë shumë proceseve dinamike dhe morfologjike. Vjosa është një thesar evropian. Vlera e saj më e madhe është gjendja e saj natyrore si një ekosistem në tërësi. Ndërtimi i digave do të shkatërronte këtë ekosistem unik dhe potencialin e tij të lartë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në të ardhmen dhe gjithashtu bien ndesh me legjislacionin e BE-së si Direktivat e Natura 2000, Direktiva për Zogjtë dhe Habitatet dhe Direktiva Komizë e Ujërave. Vjosa shërben si kufi i shumë zonave të mbrojtura përgjatë luginës së saj (3 prej të cilave janë përcaktuar si Park Kombëtar sipas kategorizimit të International Union for Conservation of Nature and Natural Resources (IUCN) II).

HEC Pocem do të kështë ndikime të forta negative në të gjithë lumin, por veçanërisht nga zona e rezervuarit deri në detin Adriatik.

1. Përmbyt sipërfaqe të mëdha tek rezervuari.

2. Përkeqëson cilësinë e ujit të Vjosës në zonën e rezervuarit dhe poshtë digës, grumbullimit të substancave të rrezikshme në rezervuar dhe për shkak të reduktimit të aftësisë vetëpastruese të ujit.

3. Ndërpret dhe pengon migrimin e specieve dhe për pasojë lidhjen e popullatave.

4. Bllokon transportin e sedimentit (rëra, zhavorret etj.). Kjo shkakton një nivel të panjohur të akumulimit në rezervuar. Poshtë digës, Vjosa do të ketë deficit të sedimentit, që do të shkaktojë carje të shtratit lumor dhe do të përfundojë me erosion të brigjeve.

5. Carja e shtratit lumor do të shkaktojë thellim të nivelit të ujrave sipërfaqësorë, cka do të thotë pakësim i ujit të pijshëm për komunitetin lokal në zonat e Selenicës, Novoselës etj.

6. Efektet në biodiversitet do të jenë negative, dhe kjo është ende e pamatshme nga ana sasiore, megjëse ekzistojnë shumë pak të dhëna shkencore të besueshme.

7. Niveli i grumbullimit të sedimentit në rezervuarin e Pocemit është ende i panjohur. Kjo lidhet drejtpërdrejt me efikasitetin dhe fizibilitetin financiar të projektit. Sa më shumë

sediment të grumbullohet në rezervuar, az më pak energji gjenerohet.

Është e rëndësishme të theksojmë se të gjitha çështjet e mësipërme duhej të ishin trajtuar në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe kjo nuk ka ndodhur, pikërisht pasi sic do të arsyetojmë në vijim, e gjithë procedura për përgatitjen e VNM e konkluduar me lëshimin e Deklaratës Mjedisore ka qenë në kundërshtim me ligjin dhe, së bashku me mungesën e seriozitetit, kanë prodhuar një Raport VNM krejtësisht formal, sipërfaqësor, madje të mbushur me gabime dhe mangësi të theksuara.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, konstatojmë se:

1. Do të kishte qenë me vlerë për një shqyrtim gjyqësor sa më të plotë, që nga ana e gjykatës të ishte krijuar mundësia që të thirrreshin si dëshmitarë, ekspertët e sugjeruar nga ana jonë, për të konkluduar sa më saktë në lidhje me brendinë e Raportit të VNM;

2. Të paditurit Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Mjedisit nuk kanë sjellë as pretendime të tyre dhe as prova që të kundërshtojnë pretendimet e ngritura nga ne, pra në kuptim të nenit 26 Ligjit nr.49/2012 mbetet që të konviderohen të pretenduara faktet e pretenduara nga paditësit në lidhje me Deklaratën Mjedisore.

3. I padituri Ministria e Energjisë dhe Industrisë, nuk paraqiti asnjë provë që të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura nga ana jonë, përveç Kontratës së lidhur me personin e tretë, e cila provon se nuk qëndron pretendimi i ngritur nga ana jonë që barra financiare e shpronësimeve do të përballohet nga fonde publike.

4. Personi i tretë "Kovlu Energji" sh.p.k., nëpërmjet pohimit gjyqësor në seancën e datës 13.04.2017 provoi pretendimin e paditësive, se në rryshe nga sa parashikon ligji dhe aktet nënligjore përkatëse, i vetmi njoftim dhe komunikim publik që është bërë në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis është ai bërë në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të njoftuar datën e takimit në Fier.

Përmbledhje e paligjshmërive dhe kërtimeve të padisë.

Nga tërësia e provave që u morën dhe u administruan gjatë shqyrtimit gjyqësor paditësit paraqesin në vijim analizën dhe konkluzionet e veta të detajuara për pretendimet e tyre:

Sic u parashtrua më sipër, e gjithë procedura për ndërtimin e hidrocentralit të Pocemit, që nga marrja e propozimit të pakërkuar e deri në lidhjen e kontratës, është kryer në mungesë të plotë të transparencës, dhe përfshirjes së publikat dhe subjekteve të interesuara (përfshirë edhe paditësit).

Deklarata Mjedisore lëshuar nga Ministri i Mjedisit me Nr. Identifikimi 19, Nr. Vendimi 17» Nr. Prot 663, datë 24.04.2015, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, është lëshuar në kundërshtim me legjislacionin bazë që rregullon procesin e Vlerësimit të Ndikimit në mjedis të projekteve zhvillimore në territorin e Republikës së Shqipërisë".

Gjatë gjykimit në shkallë të parë, palët e paditura, personi i tretë dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapsuar të njëjtat fakte, konfirmuar edhe në ankimet respektive kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit tonë, duke kërkuar në bazë të tyre, rrëzimin e padisë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr.1813 (1845) Dt.02.05.2017, ka vendosur pranimin e padisë, sipas disponimeve të pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit tonë, duke argumentuar se:

"...Analiza e provave në lidhje me faktin dhe ligjin e zbatueshëm:

Në lidhje me legjitimitimin e palëve:

Sipas nenit 32 të K.Pr. Civile padia mund të ngrihet:

a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur.

Në kuptim të kësaj dispozite procedurale civile, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për

njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkeltur ose të mohuar, kjo duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (legjitimim aktiv) dhe vetëm kundra atij që me veprën e tij, mban ose shkel të drejtën e kërkuarit (legjitimim pasiv).

Interesi i ligjshëm gjendet i pasqyruar dhe në dispozita të tjera proceduriale që rregullojnë gjykimin e mosmarrveshjeve administrative.

Kështu sipas nenit 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;

d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cënuar një interes i ligjshëm publik:

i. nga një akt normative;

ii. nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj;

iii. çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave proceduriale del se personi fizik apo juridik mund të kërkojnë zgjidhjen e konfliktit administrativ nëse plotësohen apo përmbushen dy kushte:

Së pari, akti administrative duhet të jetë i paligjshëm.

Së dyti, paditësi të jetë cënuar në interesat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të terthortë.

Legjitimiteti i palës në një proces gjyqësor nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim.

Neni 32 i K.Pr.Civile, si dhe neni 15 i ligjit nr.49/2012, e kondicionon të drejtën e paditësit për të ngritur padi me interesin e ligjshëm që duhet të ketë ai për njohjen ose rrëzimin e një pretendimi. Interesi i ligjshëm lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të cënuar prej dikujt tjetër.

Sipas nenit 48 të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, (E drejta për padi gjyqësore) në rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjeje dhe dëmtimi të tij, publiku ka të drejtë:

b) të ngrjëjë padi në gjykatë, në përputhje me kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kundër autoritetit publik ose personit fizik e juridik, që ka sjellë dëme në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë.

E drejta e publikut për të ngritur padi gjyqësore për çështjet mjedisore është parashikuar edhe në nenin 9 ligjin nr.8672 datë 26.10.2000 "Për ratifikimin e "Konventës së AARHUSIT për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit" ku në pikën 5 të këtij neni është përcaktuar se: "Me qëllim që të rritet efektiviteti i klauzolave të këtij nenin, çdo Palë do të sigurojë që publikut t'i jepet informacion për të drejtën e tij për t'ju drejtuar procedurave të shqyrtimit administrativ e gjyqësor dhe do të marrë në konsideratë krijimin e mekanizmave ndihmës të përshtatshëm, për të hequr ose pakësuar pengesat financiare ose pengesa të tjera në ushtrimin e së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës."

Në pikën 12 të nenit 5 të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, është dhënë përkufizimi i termi "Publik" në të cilin është përcaktuar se: "Publik" është një ose më shumë persona, fizikë apo juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre."

Gjithashtu, në pikën 5 të nenit 2 të ligjit nr.8672 datë 26.10.2000 "Për ratifikimin e "Konventës së AARHUSIT për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit" është dhënë përkufizimi i termi "Publik i interesuar" në të cilin është përcaktuar se: "Publiku i interesuar" nënkupton publikun e ndikuar ose që mund të ndikohet, apo që është i interesuar për vendimarrjen mjedisore; për qëllimet e këtij përkufizimi, shoqatat joqeveritare që



promovojnë më tej mbrojtjen e mjedisit dhe plotësojnë kërkesat e vëna në ligjet kombëtare, do të konsiderohen të interesuara."

Referuar dokumentave të identifikimit, si dhe prokurës së posaçme datë 23.07.2016, rezulton e provuar se paditësit Romina Mustafaraj, Tetem Mustafarj, Kujtim Sulaj etj, janë banorë të fshatit Kute, Boshkia Mallakastër, zonë në të cilën do të realizohet projekti i ndërtimit të hidrocentralit Poçem dhe, në referim të nenit nenin 32/a të K.Pr.Civile, nenit 15/a të ligjit nr.49/2012, nenit 48 të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, si dhe nenit 9 të ligjit nr.8672 datë 26.10.2000 "Për ratifikimin e "Konventës së AARHUSIT për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit" ata kanë legjitimet aktiv për t'iu drejtuar me padi gjykatës, si subjekte të interesuara për vendimarrjet mjedisore, për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së tyre të pretenduar si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur, pasi vendimet administrative objekt gjykimi të sipërcituara, rrezikon të dëmtojnë mjedisin ku ata jetojnë, duke cënuar drejtpërdrejt interesat e tyre që lidhen me mjedisin.

Po ashtu, pala paditëse organizata jofitimprurëse, shoqata "Eco Albania", në bazë të dispozitave ligjore të sipërcituara si dhe nenit 15 shkronja "d" të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", gëzon legjitimet aktiv, për t'iu drejtuar me padi gjykatës, si subjekt i interesuar për vendimarrjet mjedisore, pasi ajo është person juridik jofitimprurës (shoqatë) e regjistruar me Vendimin nr.4040 datë 15.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë, me objekt të veprimtarisë së saj ndër të tjera dhe për ato për çështjet mjedisore.

Ndërsa, sa i përket palës paditëse organizatës jofitimprurëse "EuroNatur" dhe "Riverwatch", gjykata, çmon se ata nuk gëzojnë legjitimet aktiv, për t'iu drejtuar me padi gjykatës, pasi ata nuk rezultojnë të jenë të regjistruara si persona juridik në Republikën e Shqipërisë, por përkatësisht në Gjermani dhe Austri.

Në nenin 90 të K.Pr.Civile është dhënë përkufizimi se cilat janë palët në procesin gjyqësor civil. Sipas kësaj dispozite "Palë në një gjykim civil janë personat fizik ose juridik, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi".

Po cilat janë kushtet që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik, për të qenë palë në gjykimin civil?

Në nenin 91 të K.Pr.Civile është përcaktuar se: "Kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil personat që ushtrojnë lirisht të drejta, të cilat duhet të respektohen nga të tjerët. Personat, që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre".

Nga përmbajtja e neneve 90 dhe 91 të K.Pr.Civile, arrihet në përfundimin se për të qenë palë në një gjykim civil, duhet që personat fizik ose juridik të plotësojnë dy kushte kryesore:

- a) Zotësinë juridike për të qenë palë në gjykimin civil;
- b) Zotësinë për të vepruar në gjykimin civil.

Për të kuptuar zotësinë juridike dhe atë për të vepruar të personit juridik, duhet referuar në dispozitat e Kodit Civil që bën fjalë për personat juridik.

Kështu, në nenin 24 të Kodit Civil është përcaktuar se: "Personat juridik janë publik dhe privatë".

Sipas nenit 26 të Kodit Civil, "Personat juridik privat janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat fitojnë personalitet juridik në mënyrën e caktuar nga ligji".

Ndërsa, në nenin 29 të Kodit Civil është përcaktuar se: "Personi juridik ka zotësi të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile që nga çasti i krijimit të tij dhe, kur ligji parashikon se duhet të regjistrohet, që nga çasti i regjistrimit".

Në nenin 39-51 të Kodit Civil është parashikuar krijimi i shoqatave, organizimit dhe

mënyra e funksionimit të tyre, fitimi i personalitetit juridik, shpërndarja etj.

Kështu, sipas nenit 39 të Kodit Civil "Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizik ose jo më pak se dy personave juridik që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj."

Sipas nenit 42 të Kodit Civil, "Shoqata fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë."

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, arrihet në përfundimin se personi juridik e fiton personalitetin juridik kur krijohet dhe, në rastet kur duhet të regjistrohet që nga çasti i regjistrimit. Pra që në këtë moment thuhet se personi juridik fiton zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar, ose siç është përcaktuar në dispozitën e sipërcituar të Kodit Civil, (zotësinë e personit juridik).

Në rastin në gjykim, ashtu siç u citua më sipër organizatat jofitimprurëse, shoqatat "EuroNatur" dhe "Riverwatch" nuk rezultojnë të jenë të regjistruara si persona juridik në Republikën e Shqipërisë, por përkatësisht në Gjermani dhe Austri dhe në këtë kuadër ata nuk kanë personalitet juridik në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe as zotësinë për të vepruar e për të marrë pjesë në një gjykim civil.

Legjitimimi pasiv i të paditurve,

-Agjencia Kombëtare e Mjedisit:

Organizimi dhe mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është parashikuar në ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, ku në nenin 59 të këtij ligji është përcaktuar se:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj.

Ndërsa, në nenin 60 të ligjit të sipërpërmendur, janë parashikuar funksionet e AKM, ku një ndër këto funksione është: "Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione."

Në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, Agjencia Kombëtare e Mjedisit duke qenë organi që ka përgjegjësinë kryesore për vlerësimin e ndikimit në mjedis si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurave për dhënien e lejes mjedisore, gëzon legjitimitet pasiv në këtë gjykim.

- Ministria e Mjedisit:

Në bazë të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për përgaditjen e strategjive dhe planeve mjedisore, si dhe për dhënien e lejeve mjedisore.

Po sipas ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, neni 12 të tij, Ministri i Mjedisit që është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për mjedisin është organi që miraton "deklaratën mjedisore" në përfundim të procedurës së thelluar të ndikimit në mjedis.

Në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, Ministria e Mjedisit, duke qenë organi që ka përgjegjësinë kryesore për përgaditjen e strategjive dhe planeve mjedisore, si dhe organi që bën miratimin e dhënies së lejes mjedisore, si dhe "deklaratës mjedisore" për projektet në fushën e energjitikës, gëzon legjitimitet pasiv në këtë gjykim.

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë:

Në bazë të ligjit nr.125/2013 datë 25.04.2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat" Ministria e Energjisë dhe Industrisë është në cilësinë e autoritetit kontraktor për dhënie me konçesion të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe nënshkrimin e kontratës së konçesionit me operatorin ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë.

Duke qenë në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe nënshkrues i kontratës konçesionare Nr. 2174 Rep, dhe Nr. 755/4 Kol, datë 05.09.2016, me subjektin për qëllime të veçanta, shoqërinë "KOVLU ENERGJI" sh.p.k, që është objekt i këtij gjykimi, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, gëzon gjithashtu legjitimitet pasiv në këtë gjykim.

Në lidhje me ezaurimin e rrugës administrative të ankimit:

Një nga kushtet formale të paraqitjes së padisë në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative është ajo e ezaurimit të rrugës administrative të ankimit, si dhe ai i respektimit të afatit të paraqitjes së padisë.

Sipas nenit 137, paragrafi 3 (tre) të ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 K.Pr.Administrative, ligj ky që ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së akteve administrative, objekt gjykimi (ankimi administrativ) "Në parim palët e interesuara mund të drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ".

Po ashtu, ligji i posaçëm "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" nr. 49/2012, në nenin 16 pika 1 të tij, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se subjekti të drejtohet gjykatës.

Sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit të sipërpërmendur, përjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;

c) organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.

Në lidhje me shterimin ose jo të ankimit administrativ, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr.1 datë 26.11.2010, kanë arritur në përfundimin unifikues sipas të cilit: "Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhënien juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankimi administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ".

Sa i përket aktit administrativ "Deklerate mjedisore" me nr.vendimi 17 datë 24.04.2015 të lëshuar nga Ministri i Mjedisit, si ligji nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, ashtu dhe ligji nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlersimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, ligje këto që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit dhe që gjenden të zbatueshme në çështjen në gjykim, nuk kanë parashikuar në mënyrë të shprehur se ndaj këtij akti mund të bëhet ankimi administrativ, si dhe nuk kanë parashikuar organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht sipas hierarkisë duhet të drejtohet apelimi administrativ.

Ndërsa sa i përket aktit tjetër administrativ, Urdhërit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr.228 datë 24.11.2015, si dhe të gjithë procedurës për dhënie me konçesion të HEC "Poçem", deri në nënshkrimin e kontratës konçesionare me subjektin për qëllime të veçanta "KOVLU Energji" sh.p.k, ligji nr.125/2013 datë 25.04.2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat", gjithashtu nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur ndonjë

procedurë ankimi administrativ, por sipas përmbajtjes së nenit 43 të tij, ai të referon te ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në nenin 63 dhe 64 të tij ka parashikuar se:

Neni 63

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

2. Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve pune nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkalljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

3. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe marrë një vendim të arryrtuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

4. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet edhe autoritetit kontraktor.

Neni 64/3

1. Palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë".

Nga sa shihet, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se të shkohet në gjykatë.

Pavarësisht sa më sipër, nga pala paditëse është pretenduar për pavlefshmëri absolute të akteve administrative objekt gjykimi.

Kur pretendohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ, ligjvënësi ka parashikuar qartë në nenin 117/2 të K.Pr.Administrative se secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë.

Në analizë të dispozitës ligjore të mësipërme, rezulton qartë se për këtë lloj kërkimi (konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ), gjykata ka juridiksion të drejtpërdrejtë dhe e merr në shqyrtim çështjen, pavarësisht nëse paditësi nuk ka ezauruar rrugën administrative të parashikuar nga ligji i posaçëm.

Ligjvënësi ka parashikuar juridiksion të drejtpërdrejtë në gjykatë të këtij kërkimi, pasi një akt administrativ, absolutisht i pavlefshëm, që nga momenti i nxjerrjes së tij, nuk krijon pasojë juridike për të cilin ai është nxjerrë. Për shkak të shkeljes së rëndë të ligjit, pavlefshmëria absolute e një akti nuk mund të rregullohet në të ardhmen, as nga organi që e ka lëshuar aktin, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tillë ai nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve që iu kundërdrejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore.

Këtë qëndrim kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.3/2008, ku shprehimisht është theksuar se: "Nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërvarur nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata, nuk mund ta nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, por në zbatim të nenit 121 të K.Pr.Administrative, konstaton pavlefshmërinë për efekt të zgjidhjes së pasojave juridike që janë krijuar nga akti".

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 117 të K.Pr.Administrative, si dhe nenit 16, pika 2, germa "b" të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative

dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" pala paditëse legjitimohet për t'iu drejtuar drejtpërdrejt gjykatës me padë për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së saj të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur dhe se çështja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

Në lidhje me afatin e ngritjes së padisë:

Ashtu siç u citua më sipër, kusht tjetër formal për paraqitjen e padisë, është ai i respektimit të afatit të paraqitjes së padisë.

Në nenin 18 pika 1 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (Afati për ngritjen e padisë) thuhet se:

1. Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve.

Ky afat fillon nga:

a) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;

b) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë.

2. Afati i mësipërm është 1 vit, në rastet kur akti administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë. Në rastin e mosparaqitjes së padisë brenda 1 viti, për arsye se udhëzimet në aktin administrativ nuk japin informacion të saktë për të drejtën e padisë, padia paraqitet edhe pas 1 viti, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data kur paditësi ka marrë dijeni për ekzistencën e së drejtës së padisë dhe vetëm kur paditësi jep shpjegime të besueshme për këto rrethana në padinë e tij.

Në lidhje me afatet e parashkrimit legjislativoni ynë parashikon dy kategori të afateve të parashkrimit: afate të përgjithshme dhe afate të posaçme, ku afatet e përgjithshme janë më të gjata se afatet e posaçme.

Afatet e përgjithshme të parashkrimit zbatohen për të gjitha kërkesat që i shtrohen parashkrimit shues, kur për këto nuk është caktuar në ligjë një afat i posaçëm parashkrimi.

Ashtu siç u citua më sipër, afati i përgjithshëm i ngritjes së padisë për të kundërshtuar një akt administrativ, sipas nenit 18, pika 1 të ligjit nr.49/2012, është 45 ditë, dhe si përjashtim nga ky rregull 1 vit, në rastet kur akti administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë, afat ky që fillon nga data e njoftimit të aktit.

Ashtu siç u theksua më sipër, nga paditësit është pretenduar për pavlefshmëri absolute të akteve administrative objekt gjykimi, dhe sipas nenit 117/2 të K.Pr.Administrative, kërkesa për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ mund të bëhet në çdo kohë, pra nuk i nënshtrohet afatit të parashkrimit.

I njejtë rregull vlen edhe për veprimin juridik, kontratën konçesionare me Nr.2174 Rep, dhe Nr. 755/4 Kol, datë 05.09.2016, pasi duke qenë një veprim juridik që rrjedh nga një akt administrativ të pretenduar si absolutisht i pavlefshëm, siç është "deklarata njëditore" me nr.vendimi 17 datë 24.04.2015 të lëshuar nga Ministri i Mjedisit etj, edhe në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtij veprimi juridik, kërkesa mund të bëhet në çdo kohë dhe se nuk i nënshtrohet afatit të parashkrimit.

Në lidhje me themelin e çështjes.

Referuar rrethanave të faktit, shkakat ligjorë të padisë, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, si dhe provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore, gjykata i çmon të bazuara kërkimet e palës paditëse, duke arsyetuar si më poshtë:

Ashtu siç u citua më sipër, nga ana e palës paditëse është pretenduar për pavlefshmëri absolute të akteve administrative objekt gjykimi.

Rastet e pavlefshmërisë absolute, janë parashikuar në mënyrë shteruese në nenin 116 të ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 (Kodi i Procedurave Administrative), ligjë ky që ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së akteve administrative objekt gjykimi, në të cilin është parashikuar se:

Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptim të këtij Kodi, në

rastet e mëposhtme:

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i pautentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Në shqyrtimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, gjykata, nuk shqyrton thelbin e tij por, mjaftohet vetëm me verifikimin e shkaqeve të pavlefshmërisë absolute të parashikuar në nenin 116 të K.Pr. Administrative.

Në lidhje me kërkimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Deklaratë Mjedisore me nr.663 prot. dhe nr.vendimi nr. 17 datë 24.04.2015 të Ministrit të Mjedisit:

Në nenin 4 të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, është përcaktuar se: "Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparsi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë."

Në nenin 25 të ligjit të sipërpërmendur është parashikuar vlerësimi i ndikimit në mjedis, në të cilin është përcaktuar se:

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të usaj veprimtarie në mjedis.

2. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

5. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Sipas nenit 1, Kreu I, të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Ndërsa, sipas nenit 2, Kreu I, të ligjit të sipërpërmendur, objekti i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësisve, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike.

Në nenin 6, Kreu I, të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, është dhënë përkufizimi i termit "zhvillues", "vlerësim i ndikimit në mjedis", "Publik i ndikuar", "deklaratë mjedisore" etj. në të cilin thuhet se:

2. "Zhvillues" është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik.

3. "Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)" është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga

projekte të propozuara publike dhe private.

5. "Publik i ndikuar" është publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore që shprehin interes.

6. "Vendim" është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin është vendosur nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

7. "Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis", më poshtë "Deklarata mjedisore", është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimin të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar".

Hapi i parë që ndihet në lëshimin e deklaratës mjedisore është vlerësimi i ndikimit në mjedis, i cili fillon me paraqitjen e kërkesës nga ana e zhvilluesit të projektit.

Në Kreun II të ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji siç është Vendimi nr. 13 datë 04.01.2013 i Keshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimin të ndikimit në mjedis" etj, janë parashikuar në mënyrë të detajuar e gjithë procedura që ndiqet për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Kështu, sipas pikës 2, neni 7, Kreu II të ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, procedura e vlerësimin të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimin të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimin të ndikimit në mjedis.

Zhvillimi i i procedurës paraprake dhe asaj të zhvilluar të vlerësimin të ndikimit në mjedis është parashikuar në Vendimin nr. 13 datë 04.01.2013 i Keshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimin të ndikimit në mjedis".

Kështu, sipas Kreut I, të Kësaj VKM-je, procesi paraprak i vlerësimin të ndikimit në mjedis, kalon nëpër disa faza si:

a) Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit shogërues nga zhvilluesi në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe përcjellja e tyre nga QKL-ja në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);

b) Konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera dhe publikimi i kërkesës;

c) Marrja e vendimit nga AKM-ja, njoftimi i QKL-së, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, institucioneve të konsultuara, si dhe publikimi i vendimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

Ndërsa, në Kreun II të VKM-së të lartpërmendur, zhvillimi i procedurës së thelluar të vlerësimin të ndikimit në mjedis (VMN) kalon nëpër këto faza:

a) njoftimin e AKM-së nga zhvilluesi për synimin e zhvillimit të projektit;

b) konsultimin e AKM-së me institucionet e tjera, publikun dhe OJF-të për çështjet që ato kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

c) komunikimin që AKM-ja i bën zhvilluesit për çështjet që ajo dhe palët e konsultuara kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

ç) hartimin e raportit të thelluar të VNM-së dhe dëgjuesën me publikun;

d) aplikimin në QKL për deklaratën mjedisore, shqyrtimin nga AKM-ja dhe lëshimin e saj nga ministri.

Në vijim në Kreun III të VKM-së së sipërcituar është parashikuar paraqitja e aplikimit nga ana e zhvilluesit në QKL dhe shqyrtimi dhe miratimi i deklaratës mjedisore.

Por, para se të miratohet dhënia e deklaratës mjedisore, ligji nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij siç është Vendimi nr. 247 datë 30.04.2014 i Keshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e

publikut në vendimarrjen mjedisore" kanë parashikuar si kusht vlersimin e ndikimit në mjedis.  
Sipas pikës 3, neni 7, Kreu II të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlersimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, "Dokumentat bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Në nenin 14, Kreu II të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlersimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, janë përcaktuar palët që marrin pjesë në procesin e vlersimit të ndikimit në mjedis të cilët janë:

- a) zhvilluesi i projektit;
- b) ministria dhe strukturat e saj të varëta;
- c) ministrinë e linjës dhe strukturat e varësisë;
- ç) njësitë e qeverisjes vendore;
- d) publiku dhe organizatat jofitimprurëse;
- dh) institucionet që kanë përgjegjësi të përfshihen në procesin e VNM-së;
- e) shtetet fqinje, në rast të VNM-së në kontekst ndërkufitar, sipas kërkesave të Konventës së ESPOO-s.

Në nenin 15, 16, dhe 17 të Kreut II të ligjit të sipërpërmendur, është përcaktuar dhënia e mendimit të institucioneve të tjera gjatë procedurës së VNM-së, informimi i publikut si dhe zhvillimi i seancave dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara, gjatë VNM-së.

#### Neni 15

Mendimi i institucioneve të tjera;

1. Gjatë procedurës së VNM-së, AKM-ja dhe ministria, sipas kompetencave, konsultohen edhe me institucionet e përmendura në shkronjat "c", "ç" dhe "dh" të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, duke u dërguar edhe kopje të dokumentacionit të paraqitur nga zhvilluesi i projektit.

2. Institucionet e konsultuara japin brenda afatit të kërkuar mendimin e tyre, sipas funksioneve dhe përgjegjësi të përkatëse.

3. Nëse institucionet e lartpërmendura nuk paraqesin mendimet e tyre brenda afatit të kërkuar nënkuptohet se ato janë dakord me zhvillimin e projektit dhe nuk kanë komente.

#### Neni 16

Informimi i publikut gjatë VNM-së;

1. Zhvilluesi për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij.

2. Informacionin për informimin dhe konsultimin me publikun, zhvilluesi e paraqet si pjesë të dokumentacionit të nevojshëm gjatë aplikimit për deklaratën në QKL.

#### Neni 17

Seanca dëgjimore gjatë VNM-së;

1. AKM-ja gjatë procedurës së VNM-së së thelluar, zhvillon seancë dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara, duke synuar tërheqjen e mendimit të tyre në vendimarrjen përfundimtare për projektin.

2. Seanca dëgjimore zhvillohet në bashkëpunim edhe me njësinë e qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit.

3. Menjëherë pas përcaktimit të vendit, datës dhe orës për zhvillimin e seancës dëgjimore, njësia e qeverisjes vendore bën njoftimin drejtuar publikut dhe OJF-ve të interesuara për të marrë pjesë në takim.

4. Mendimi dhe komentet e publikut e të OJF-ve, të pranishëm në takim, janë kriter i domosdoshëm, gjatë procesit të vendimarrjes së VNM-së.

Një rol të rëndësishëm në vlersimin e ndikimit në mjedis ka informimi dhe përfshirja e



publikut në vendimarrjen mjedisore.

Rregullat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore, janë parashikuar në Vendimin nr.247 datë 30.04.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore".

Në Kërcën II të kësaj VKM-je, janë parashikuar përgjegjësitë që kanë një sërë institucionesh për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimarrjen mjedisore, gjatë procedurës së thelluar të VNM-së, duke filluar me zhvilluesin e projektit, Agjencia Komëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit si dhe Njësia e Qeverisjes Vendore e zonës ku shtrihet projekti.

Kështu sipas pikës 4.1 të Kësaj VKM-je, zhvilluesi ka këto përgjegjësi:

a) Njofton AKM-në për dëgjesën publike, duke i dërguar programin për organizimin e saj, raportin e thelluar të VNM-së dhe përmbledhjen joteknike të tij;

b) Realizon njoftimin e publikut për organizimin e dëgjesës publike;

c) I dërgon NJQV-së dhe ARM-së nga 30 copë kopje të printuara të raportit të VNM-së dhe të përmbledhjes joteknike të tij, të cilat i vihen në dispozicion publikut të interesuar;

ç) Siguron mjediset ku do të mbahet dëgjesa me publikun;

d) Siguron pjesëmarrjen e ekspertit/ekspertëve, që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së, ditën që organizohet dëgjesa publike;

dh) Merr në konsideratë mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku ditën e dëgjesës dhe i pasqyron ato në raportin e thelluar të VNM-së ose argumenton arsyet e pamundësisë së marrjes në konsideratë.

4.2 AKM-ja ka këto përgjegjësi:

a) Pas njoftimit nga zhvilluesi, udhëzon ARM-në përkatëse për rolin e saj në realizimin e dëgjesës publike;

b) Publikon në faqen e saj të internetit njoftimin për organizimin e dëgjesës publike;

c) I dërgon zyrtarisht një kopje të njoftimit structures përkatëse për komunikimin me publikun në ministri;

ç) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjesën publike;

d) Merr mendimin e publikut në fazën e shqyrtimit të projektit për Deklaratën Mjedisore;

dh) Merr në konsideratë rezultatet dhe kërkesat e publikut gjatë shqyrtimit për Deklaratën Mjedisore dhe procesit të VNM-së;

e) Publikon në faqen e saj të internetit informacionin që disponon për pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit të VNM-së për projektin.

4.3 ARM-ja ka këto përgjegjësi:

a) Bashkëpunon me zhvilluesin dhe NJQV-në për organizimin e dëgjesës publike;

b) Afishon në ambientet e saj të punës dhe publikon në faqen e saj të internetit njoftimin përkatës për dëgjesën publike;

c) Ekspozon në ambientet e saj të punës kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së;

ç) Merr pjesë ditën e dëgjesës dhe mban shënim diskutimet e bëra nga të pranishmit;

d) I dërgon AKM-së raportin për diskutimet e bëra gjatë dëgjesës publike brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dëgjesa publike;

dh) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjesën.

4.4 Njësia e qeverisjes vendore ka këto përgjegjësi:

a) Publikon në ambientet dhe faqen e saj elektronike njoftimin përkatës për dëgjesën publike;

b) Ekspozon pranë zyrave të saj kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së;

c) Bashkëpunon me zhvilluesin, duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjuesën publike;

ç) Nxit përfshirjen e komunitetit në pjesëmarrjen për dëgjuesën publike;

d) Merr pjesë në ditën e zhvillimit të dëgjuesës publike.

Po ashtu, në pikën 5, Kreu II, të VKM-së nr.247 datë 30.04.2014, është parashikuar bashkërendimi i këtyre institucioneve për organizimin e dëgjuesës publike, në të cilën është parashikuar se:

5.1 Zhvilluesi, mbasi ka hartuar raportin e thelluar të VNM-së, njofton AKM-në për organizimin e dëgjuesës, duke i dërguar:

a) planin e punës për organizimin e dëgjuesës;

b) informacionin për konsultimet e kryera gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

c) kopjen e njoftimit të hartuar sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi;

ç) kopjen elektronike të përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së.

5.2 AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, udhëzon ARM-në përkatëse të bashkëpunojë me NJQV-në dhe me zhvilluesin e projektit për realizimin e dëgjuesës publike, duke i dërguar informacionin e paraqitur nga zhvilluesi sipas pikës 5.1.

5.3 ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së njoftimit prej AKM-së, komunikon me NJQV-në në zonën ku propozohet t projekt, duke i dërguar një kopje të plotë të informacionit që ka marrë prej AKM-së, si dhe e informon për përgjegjësinë që ka në:

a) publikimin dhe afishimin e njoftimit për dëgjuesën publike;

b) ekspozimin e përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së, pranë zyrave të NJQV-së;

c) garantimin e pjesëmarrjes së stafit përkatës të NJQV-së në dëgjuesën publike;

ç) nxitjen e komunitetit për pjesëmarrje në dëgjuesën publike.

5.4 AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, i dërgon strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri një kopje të plotë të tij, e cila e publikon në rrejetet e mundshme të informimit.

5.5 Zhvilluesi, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që i bën AKM-së sipas pikës 5.1, dërgon në NJQV të paktën 100 kopje të shtypura të përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së.

Ndërsa, në pikën 6 të Kreut II të VKM-së së sipërpërmendur, është parashikuar, detyrimi i institucioneve të lërtpërmendura për informimin e publikut për dëgjuesë publike, në të cilin është përcaktuar se:

6.1 Zhvilluesi i projektit, paralel me njoftimin e AKM-së, realizon, me shpenzimet e veta, informimin për zhvillimin e seancës dëgjimore. Informimi zgjat 20 (njëzet) ditë rresht dhe përfshin:

a) publikimin e njoftimit, me informacionin që kërkohet sipas shtojcës I, në median audiovizive e median e shkruar lokale dhe, në rast se projekti ka karakter kombëtar, edhe në median kombëtare;

b) vendosjen e një table informuese në vendin ku do të zhvillohet projekti, ku njoftimi për dëgjuesën publike afishohet për 20 (njëzet) ditë rresht në mënyrë dhe vend të dukshëm;

c) ekspozimin e materialeve të dëgjuesës në zyrat e NJQV-së përkatëse.

6.2 AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që merr nga zhvilluesi sipas pikës 5.1, kryen këto veprime:

a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;

b) Afishon në hapësirën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjuesën publike.

6.3 ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të AKM-së, sipas pikës 5.2, kryen këto veprime:

a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;

b) Afishon në zyrën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjuesën publike;

c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.

6.4 NJQV-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të ARM-së, sipas pikës 5.3, kryen këto veprime:

a) Afishon në mjediset e saj, deri në datën e mbajtjes së seancës dëgjimore, njoftimin për dëgjuesën publike;

b) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;

c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.

6.5 Publiku dhe palët e interesuara mund të japin mendimet e tyre në formë elektronike apo me shkrim deri ditën e organizimit të dëgjuesës publike. Mendimet duhet të dërgohen në kontaktet e adresat e përcaktuara nga AKM-ja në njoftimin përkatës.

6.6 Mendimet e dhëna nga publiku, vetëm pranë AKM-së, i dërgohen nga AKM-ja të plota zhvilluesit të projektit, jo më vonë se 4 (katër) ditë nga data e mbajtjes së dëgjuesës publike.

Në vijim në pikën 7 të Kreut II të kësaj VKM-je, është parashikuar zhvillimi i seancës dëgjimore në të cilën thuhet se:

7.1 Seanca dëgjimore me publikun organizohet në një vend të pershtatshëm, sa më pranë vendndodhjes së projektit dhe jo më herët se dita e 30-të kalendarike nga data e njoftimit të AKM-së prej zhvilluesit, sipas pikës 5.1.

7.2 Ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore janë të pranishëm:

a) zhvilluesi i projektit me ekspertin/ekspertët që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së;

b) përfaqësuesi i ARM-së në qark/AKM-së;

c) përfaqësues të NJQV-së së zonës ku propozohet projekti;

ç) përfaqësues dhe palë të tjera të interesuara.

7.3 Përfaqësuesit e zhvilluesit prezantojnë rezultatet e raportit të thelluar të VNM-së për projektin, duke mbajtur shënim edhe mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku.

7.4 Publiku dhe palët e tjera të interesuara shprehin mendimet e tyre për rezultatet e raportit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

7.5 Përfaqësuesit e ARM-së mbajnë shënim në mënyrë të pavarur diskutimet e plota të seancës dëgjimore dhe i pasqyrojnë ato në një raport të posaçëm, që i dërgohet AKM-së brenda 5 (pesë) ditëve nga data e mbajtjes së seancës dëgjimore.

7.6 Raporti i dërguar në AKM nga ARM-ja publikohet menjëherë në faqen e internetit të AKM-së.

Referuar rastit në gjykim, në rastin e miratimit dhe dhënies së deklaratës mjedisore zhvilluesit të projektit, nga ana e palës së paditur AKM dhe Ministria e Mjedisit, gjykata konkludon se nuk është respektuar procedura e parashikuar në ligjin nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij të sipërcituara.

Referuar provave të shqyrtuara në këtë gjykim, rezulton se AKM-ja, ARM-ja dhe NJQV, e vendodhjes së ndërtimit të projektit, nuk kanë ushtruar fare përgjegjësitë e tyre në rastin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në asnjërin prej fazave të VNM-së, si përsa i përket informimit ashtu dhe përfshirjes së publikut në vendimarrjen mjedisore.

Nga palët e paditura dhe personi i tretë, janë paraqitur si prova vetëm projekt raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe raporti i vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis për ndërtimin e Hec-it Poçem, të hartuara nga zhvilluesi, nëpërmjet konsulentit të saj shoqërisë "GR Albania", ndërsa autoritetet e tjera përgjegjëse si AKM-ja, ARM-ja dhe NJQV, nuk kanë

marrë fare pjesë në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre.

Edhe nga ana e zhvilluesit të projektit, në vlersimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgaditjeve për planifikimin e projektit zhvillimor para kërimit të lejes përkatëse të zhvillimit, konstatohet se informimi dhe pjesëmarrja e publikut në VNM, ka qenë fiktive dhe jo ezauruese.

Nga ana e zhvilluesit nuk është përmbushur detyrimi për informimin e publikut për dëgjuesën publike, sipas parashikimeve të pikës 6 të VKM-së nr.247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore", që kanë të bëjnë me: publikimin e njoftimit me informacionin që kërkohet sipas shtojcës I të këtij vendimi në mediat audiovizive në median e shkruar lokale dhe në atë më karakter kombëtar duke qenë se kishim të bënim me një projekt kombëtar, vendosjen e tabelave informuese në vendin ku do të zhvillohet projekti, ekspozimin e materialave të dëgjuesës në zyrat e NJQV përkatëse etj.

Nga provat e paarqitura në këtë gjykim rezulton se është zhvilluar vetëm një dëgjuesë publike në datën 28.02.2014 në qytetin e Fierit dhe, jo në zonën ku do të ndërtohej HEC-i, (Njësia Administrative Kute) ku nuk kanë marrë pjesë asnjë prej institucioneve të sipërcituara si ARM-ja dhe NJQV, pjesëmarrja e të cilave ishte e detyrueshme, dhe pothuajse asnjë prej banorëve të zonës ku do të ndërtohej projekti, pasi referuar shkresës nr 35 prot. datë 10.11.2016 të Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Mallakastër, asnjë prej emrave të listës të paraqitur nga pala e paditur si pjesëmarrës në dëgjuesën publike të zhvilluar në datën 28.02.2015, nuk është banor i Njesisë Administrative Kute.

Nga sa më sipër, mosrespektimi i procedurës së kërkuar nga ligji për miratimin dhe dhënien e deklaratës mjedisore nga ana e palës së paditur AKM dhe Ministria e Mjedisit, kanë çuar në shkeljen e një sërë parimeve për mbrojtjen e mjedisit si: parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, parimin e ruajtjes së burimeve natyrore, parimin e përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit, parimin e së drejtës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut, parime këto të sanksionuar në ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar.

Nga sa më sipër, gjykata çmon se akti administrativ Deklaratë Mjedisore me nr.663 prot. dhe nr.vendimi nr.17 datë 24.04.2015 të Ministrit të Mjedisit, objekt gjykimi, është akt i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ligji, nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlersimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, çka e bën këtë akt absolutisht të pavlefshëm, në kuptim të nenit 116, shkronja "c" të të Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin është përcaktuar se: "Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme kur janë nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji."

Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasojat ligjore pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tilla (neni 117, paragrafi i 1-rë i K.Pr.A). Për shkak të shkeljes së rëndë të ligjit, pavlefshmëria absolute e një akti nuk mund të rregullohet në të ardhmen, as nga organi që e ka lëshuar aktin, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tillë ai nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve që tu kundërdrejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore.

Pavlefshmëria absolute e aktit është një gjendje e tillë që dëshmon për inekzistencën e nulitetin e aktit, si dhe të pasojave të tij juridike që në momentin që është miratuar, dhe se për konstatimin e kësaj pavlefshmërie nuk kërkohet domosdoshmërisht subjekt specifik dhe i lidhur drejtpërdrejt me aktin, e thënë ndryshe, gjykata mund të shprehet për nulitetin e aktit absolutisht të pavlefshëm edhe në mungesë të një kërkesë të veçantë (kryesisht).

Kjo gjën rregullim dhe në nenin 117 paragrafi i 2-të të K.Pr.A, ku theksohet se: "Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë".

Në respektim të këtij përcaktimi ligjor edhe aktet e tjera administrative siç janë Urdhëri i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr.228 datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhënien e koncesionit të Hidocentralit "Poçem" dhe Urdhëri nr.228/1 datë 22.01.2016 "Për

një ndryshim në Urdhërin nr. 228 datë 24.11.2015, Vendimi nr. 1 datë 21.04.2016 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë MEI "Për vlerimin e ofertave për dhënie me koncesion të hidocentralit "Poçem" si dhe kontrata e koncesionit me Nr. 2174 Rep. dhe Nr. 755/4 Kol. datë 05.09.2016, e formës "Bot" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidocentralit "Poçem" e lidhur midis Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "KOVLU ENERGJI" sh.p.k, janë akte administrative dhe veprime juridike absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë mbi bazën e një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, siç është Deklaratë Mjedisore me nr. vendimi 17 datë 24.04.2015, i cili është njëri ndër dokumentat kryesorë standarte të tenderit, të përcaktuar nga Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat, i ngritur me Urdhërin nr. 222 datë 24.11.2015 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, të ndryshuar, që siç u thaksua më sipër nuk mund të sjellë pasojë juridike pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Nga sa u analizua më sipër, gjykata arrin në përfundimin se kërkespadia e paraqitur nga paditësit, personat fizik si Romina Mustafaraj, Teten Mustafaraj, Kujtim Sulaj etj, banorë të fshatit Kute Mallkastër dhe shoqata "Eco Albania" duhet pramuar tërësisht, duke u vendosur si më poshtë:

- Konstatimin e pavlefshmerisë absolute të "Deklaratës Mjedisore" nr. 663 prot. dhe nr. vendimi nr. 17 datë 24.04.2015 të lëshuar nga Ministri i Mjedisit.

- Konstatimin e pavlefshmerisë absolute të Urdhërit të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 228 datë 24.11.2015 "Për ngritjen e komisionit për dhënie me koncesion të hidocentralit "Poçem" dhe Urdhërin nr. 228/1 datë 22.01.2016 "Për një ndryshim në Urdhërin nr. 228 datë 24.11.2015.

- Konstatimin e pavlefshmerisë absolute të Vendimit nr. 1 datë 21.04.2016 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë MEI "Për vlerimin e ofertave për dhënie me koncesion të hidocentralit "Poçem".

- Konstatimin e paligjshmerisë absolute të kontratës së koncesionit me Nr. 2174 Rep. dhe Nr. 755/4 Kol. datë 05.09.2016, e formës "Bot" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidocentralit "Poçem" të lidhur midis Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe subjektit për qëllime të veçanta shoqëria "KOVLU ENERGJI" sh.p.k.

- Rrëzimin e padisë për palët paditëse, organizata jofitimprurëse "Rivercatch" dhe organizata jofitimprurëse "Euro Natura" si të pabazuar në ligj, kjo për shkak të moslegjitimitetit aktiv.

Gjithashtu, në dhënie të një vendimi përfundimtar, gjykata ka detyrimin ligjor për tu shprehur në lidhje me shpenzimet gjyqësore të kryera nga palët gjatë gjyqimit.

Sipas nenit 106 të K.Pr.Civile, taksa mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, n.q.s ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata.

Ndër shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësit janë, taksa e regjistrimit të padisë në shumën 3000 lekë. Gjithashtu, në këtë gjykim paditësit u përfaqësuan nga av. Vladimir Meçi. Sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve nr. 1284/3 datë 16.03.2005, "Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënie të ndihmës juridike" kur nuk ka marrëveshje ndërmjet palëve për shpërblimin e avokatit, tarifa e shpërblimit për avokat për përfaqësimin në çështjet civile në gjykatën e shkallës së parë me palë, është në shumën 40.000 lekë. Në rastin konkret nuk rezulton që ndërmjet paditësive dhe përfaqësuesit të tyre Av. Vladimir Meçi, të ketë një marrëveshje për shpërblimin për shërbimin e avokatëve, kështu që duhet aplikuar tarifa e mësipërme prej 40.000 lekë.

Nisur sa më sipër, shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësit siç janë ato për taksën e regjistrimit të padisë në shumën 3.000 lekë, si dhe shpërblimi për avokatin në shumën 40.000, gjithsej në shumën (3.000 + 40.000 = 43.000) lekë, duhet të ngarkohen palëve të paditura".

Bazuar në ankimin e palëve të paditura, personit të tretë dhe Avokaturës së Shtetit, në Gjykatën e Apelit Administrativ u regjistrua çështja administrative Nr.15600 (31103-04003-86-2017) Akti Dt.24.07.2017.

Me vendim të ndërmjetëm, disponuar më datë 30.05.2024 në dhomë këshillimi, gjykata, bazuar në Nenin 1/2 të Ligjit Nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, Nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, VKM-në Nr.504 Dt.13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë" dhe VKM-në Nr.112 Dt.02.03.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit", vendosi të kryejë kalimin procedural të të drejtave të të paditurit, nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga Ministria e Turizmit, tek Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Vendimi i ndërmjetëm iu komunikua palëve ndërgjyqëse dhe Avokaturës së Shtetit, nëpërmjet Dëftesave të Komunikimit Dt.31.05.2024.

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit Administrativ.**

Gjykata e Apelit Administrativ çmon të nevojshme të evidentojë paraprakisht faktin se, gjykatat administrative që vihen në lëvizje me padi apo me kërkesë dytësore (marrje mase sigurimi para ngritjes së padisë), lipset të verifikojnë paraprakisht të qenurit kompetente ose jo në shqyrtimin e tyre, në kuptim të dispozitave të Kreut III të Ligjit Nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, që parashikojnë se:

#### **Neni 10**

*"1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ.*

*2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:*

*a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë".*

#### **Neni 7**

*"Gjykatat administrative janë kompetente për:*

*a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik".*

#### **Neni 17**

*"1. Padia ngrihet...*

*a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ".*

Gjykata e Apelit Administrativ vëren se, me konstatimin e të qenurit të gjykatës ku është dorëzuar padia, kompetente për shqyrtimin e saj, në zbatim të parimit të një procesi të rregullt gjyqësor, gjykimi administrativ realizohet në bazë të një rendi kronologjik veprimesh procedurale, që nisën me verifikimin në përputhje me Nenin 25 të Ligjit Nr.49/2012, të

elementeve formale të padisë, që dikton në rast konstatimi të metash, disponimin e vendimit për plotësimin e tyre brenda afatit të caktuar nga gjykata.

Ezaurimi pa problematika i kësaj faze, dikton verifikimin në vijim të plotësimit ose jo të kushteve formale të padisë, parashikuar në Kreun IV (Nenet 14-19) e që konsistojnë në: kushtin e legjitimitetit, të shterimit ose jo të rrugës administrative të ankimit, të respektimit ose jo të afateve shuese të padisë etj.

Sigurisht që, edhe verifikimi i kushteve formale të padisë, përbën një fazë që ezaurohet në bazë të përparësisë së një kushti (sikurse është legjitimiteti), në raport me kushtet e tjera (sikurse është afati i ngritjes së padisë etj), në kuptimin që, konfirmimi i mungesës së legjitimitetit të paditësit, e hën të panevniqshëm vijimin e analizës së faktit të ngritjes ose jo prej tij të padisë, në afatin e parashikuar në ligj.

Konstatimi i faktit të mosplotësimit të njërit prej këtyre kushteve, dikton vendimmarrje të ndryshme, në varësi të faktit të disponimit ose jo prej gjykatës, të vendimit të ndërmjetëm për shqyrtimin e provave dhe konkretisht:

- kur fakti i mosplotësimit të njërit prej kushteve formale të padisë, konstatohet para vendimit të ndërmjetëm për shqyrtimin e provave, gjykata disponon me vendim jopërfundimtar, në përputhje me parashikimet e Nenin 39 të Ligjit Nr.49/2012, sipas përmbajtjes së të cilit:

*"1. Gjykata administrative jep vendime jopërfundimtare vetëm në rastin e mospranimit të padisë dhe të pushimit të gjykimit.*

*2. Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave".*

- kur fakti i mosplotësimit të njërit prej kushteve formale të padisë, konstatohet pas vendimit të ndërmjetëm për shqyrtimin e provave, gjykata disponon me vendim përfundimtar për rrëzimin e padisë.

Ndërsa, konstatimi i gjykatës mbi plotësimin e kushteve formale të padisë, dikton kalimin prej saj të çështjes, për shqyrtim në themel.

Pikërisht, të vlerësuarit të plotësuar në rastin konkret, të kushteve formale të padisë, kane diktuar shqyrtimin e çështjes në themel.

Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit Administrativ, përkundër shkaqeve të ngritura në ankimin e palës së paditur, konfirmon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se:

*"Referuar dokumentave të identifikimit, si dhe prokurës së posaçme datë 23.07.2016, rezulton e provuar se paditësit Romina Mustafaraj, Tetem Mustafarj, Kujtim Sulaj etj, janë banorë të fshatit Kute, Bashkia Mallakastër, zonë në të cilën do të realizohet projekti i ndërtimit të hidrocentralit Poçem dhe, në referim të nenit nënin 32/a të K.Pr.Civile, nenit 15/a të ligjit nr.49/2012, nenit 48 të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, si dhe nenit 9 të ligjit nr.8672 datë 26.10.2000 "Për ratifikimin e "Konventës së AARHUSIT për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit" ato kanë ligjimitet aktiv për t'iu drejtuar me padi gjykatës, si subjekte të interesuara për vendimmarrjet mjedisore, për të*

kërkuar rivendosjen e së drejtës së tyre të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur, pasi vendimet administrative objekt gjykimi të sipërcituara, rrezikon të dëmtojë mjedisin ku ata jetojnë, duke cënuar drejtpërdrejt interesat e tyre që lidhen me mjedisin.

Po ashtu, pala paditëse organizata jofitimprurëse, shoqata "Eco Albania", në bazë të dispozitave ligjore të sipërcituara si dhe nenit 15 shkronja "d" të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", gëzon legjitimitet aktiv, për t'iu drejtuar me padë gjykatës, si subjekt i interesuar për vendimarrjet mjedisore, pasi ajo është person juridik jofitimprurës (shoqatë) e regjistruar me Vendimin nr.4040 datë 15.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë, me objekt të veprimtarisë së saj ndër të tjera dhe për ato për çështjet mjedisore.

~~nga pala paditëse akti pretenduar për pavlefshmëri absolute të aktit administrative objekt gjykimi.~~

Kur pretendohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ, ligjvënësi ka parashikuar qartë në nenin 117/2 të K.Pr.Administrative se secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë.

Në analizë të dispozitës ligjore të mësipërme, rezulton qartë se për këtë lloj kërkimi (konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ), gjykata ka juridiksion të drejtpërdrejtë dhe e merr në shqyrtim çështjen, pavarësisht nëse paditësi nuk ka ezauruar rrugën administrative të parashikuar nga ligji i posaçëm.

Këtë qëndrim kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.3/2008...

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 117 të K.Pr.Administrative, si dhe nenit 16, pika 2, germa "b" të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" pala paditëse legjitimohet për t'iu drejtuar drejtpërdrejt gjykatës me padë për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së saj të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur dhe se çështja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësor".

Sa i takon zgjidhjes në themel, Gjykata e Apelit Administrativ vëren se, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, reflekton zbatimin e kufijve të shqyrtimit gjyqësor, përcaktuar në Nenin 37/1 të Ligjit Nr.49/2012, sipas përmbajtjes së të cilit:

"1. Gjykata shqyrtton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ".

Gjykata e Apelit Administrativ çmon se gjykata e shkallës së parë, në kuptim të Nenit 17/2 të Ligjit Nr.49/2012, ka cilësuar saktë faktet dhe veprimet e lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke identifikuar dispozitat e detyrueshme për t'u zbatuar prej saj në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes dhe duke i interpretuar ato në mënyrë korrekte.

Ky vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një analize të hollësishme të rrethanave të faktit, konstatuar në mënyrë të plotë e të drejtë.

Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit Administrativ vlerëson tejet korrekt përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se:



*"Rastet e pavlefshmërisë absolute, janë parashikuar në mënyrë shteruese në nenin 116 të ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 (Kodi i Procedurave Administrative), ligjë ky që ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së akteve administrative objekt gjykimi..."*

*Referuar rastit në gjykim, në rastin e miratimit dhe dhënies së deklaratës mjedisore zhvilluesit të projektit, nga ana e palës së paditur AKM dhe Ministria e Mjedisit, gjykata konkludon se nuk është respektuar, procedura e parashikuar në ligjin nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlersimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij të sipërcituara.*

*Referuar provave të shqyrtuara në këtë gjykim, rezulton se AKM-ja, ARM-jë dhe NJQV, e vendodhjes së ndërtimit të projektit, nuk kanë ushtruar fare përgjegjësitë e tyre në rastin e vlersimit të ndikimit në mjedis, në asnjërin prej fazave të VNM-së, si përsa i përket informimit ashtu dhe përfshirëj se publikut në vendimarrjen mjedisore*

*Nga palët e paditura dhe personi i tretë, janë paraqitur si prova vetëm projekt raporti (vlersimit të ndikimit në mjedis si dhe raporti i vlersimit të thelluar të ndikimit në mjedis për ndërtimin e Hec-it Poçem, të hartuara nga zhvilluesi, nëpërmjet konsulentit të saj shoqërisë "GR Albania", ndërsa autoritetet e tjera përgjegjëse si AKM-ja, ARM-ja dhe NJQV, nuk kanë marrë fare pjesë në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre.*

*Edhe nga ana e zhvilluesit të projektit, në vlersimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgaditjeve për planifikimin e projektit zhvillimor para kërkimit të lejes përkatëse të zhvillimit, konstatohet se informimi dhe pjesëmarrja e publikut në VNM, ka qenë fiktive dhe jo ezauruese...*

*Nga provat e paraqitura në këtë gjykim rezulton se është zhvilluar vetëm një dëgjese publike në datën 28.02.2014 në qytetin e Fierit dhe, jo në zonën ku do të ndërtohej HEC-i, (Njësia Administrative Kute) ku nuk kanë marrë pjesë asnjë prej institucioneve të sipërcituara si ARM-ja dhe NJQV, pjesëmarrja e të cilave ishte e detyrueshme, dhe pothuajse asnjë prej banorëve të zonës ku do të ndërtohej projekti, pasi referuar shkresës nr.35 prot. datë 10.11.2016 të Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Mallakastër, asnjë prej emrave të listës të paraqitur nga pala e paditur si pjesëmarrës në dëgjесën publike të zhvilluar në datën 28.02.2015, nuk është banor i Njesisë Administrative Kute...*

*Në respektim të këtij përcaktimi ligjor edhe aktet e tjera administrative, janë absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë mbi bazën e një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, siç është Deklaratë Mjedisore me nr.vendimi 17 datë 24.04.2015, i cili është njëri ndër dokumentat kryesorë standarte të tenderit, të përcaktuar nga Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat, i ngritur me Urdhërin nr.222 datë 24.11.2015 të Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, të ndryshuar, që siç u theksua më sipër nuk mund të sjellë pasoja juridike, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë".*

*Gjykata e Apelit Administrativ, në konfirmim të qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë, çmon të nevojshme të evidentojë faktin se, lloji i pavlefshmërisë që i atribuohet aktit objekt gjykimi, përbën elementin përcaktues në funksion të analizës së pretendimeve të parashtruara në kërkespadi nga njëra anë dhe nga ana tjetër të zbatimit nga gjykata të njërit prej parimeve themelore të procesit gjyqësor, parashikuar në Nenin 6 K.Pr.Civile, që parashikon se:*

*"Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet".*

*Në konfirmim të argumentave të vëna në themel të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, lipset vërejtur se, analiza e pretendimeve për pavlefshmëri absolute për shkak mosrespektimi procedure, dikton pashmangshmërisht referimin edhe në dispozitat e Ligjit Nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i*

ndryshuar, që parashikojnë përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i disponimit, në rast shqyrtimi të padive me të njëjtin shkak dhe objekt, si në rastin tonë.

Konkretisht, në Nenin 40/4 të ligjit, sa i takon llojit të vendimeve përfundimtare që mund të disponojnë gjykatat administrative, parashikohet në mënyrë eksplicite se:

*"4. Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta".*

Gjykata e Apelit Administrativ vëren se, pikërisht kjo dispozitë e parashikuar në ligjin e posaçëm, në bazë të të cilit funksionojnë gjykatat administrative, bëhet përcaktuese në raport me vlerësimin e pretendimeve për pavlefshmëri absolute, për shkak procedure, ngritur në padi.

Thënë ndryshe, Gjykata e Apelit Administrativ vëren se, në funksion të zbatimit të kësaj dispozite, shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit administrative objekt gjykimi, dikton verifikimin e krijimit ose jo të të njëjtës situatë faktike, megjithë respektimin ose jo të procedurës ligjore nga ana e organit administrativ.

Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit Administrativ konfirmon prapësimin në parim, të Avokaturës së Shtetit, se:

*"Gjykata edhe në rast se konstaton ekzistencën e shkeljeve procedurale, në fund vendos për rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi vlerëson se pasojat do të ishin të njëjta".*

Gjykata e Apelit Administrativ çmon të nevojshme të evidentojë se, nëpërmjet kësaj dispozite, ligjvënësi nuk ka synuar ta kufizojë analizën e gjykatës në verifikimin e thjeshtë të pasojës/nxjerrjes ose jo të aktit nga organi administrativ, duke e detyruara ta rrëzojë padinë në rast konstatimi të këtij fakti.

Në kuptim të kësaj dispozite, thelbi analizës së gjykatës nuk konsiston tek mundësia e nxjerrjes së aktit/ardhjes së pasojës, por tek ligjshmëria e tij.

Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka analizuar dhe konkluduar se, mungesa e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, çënon në thelb vlefshmërinë e deklaratës mjedisore, me pasojë pavlefshmërinë edhet të kontratës koncesionare.

Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit Administrativ nuk konfirmon përfundimin e Avokaturës së Shtetit, se:

*"...rasti objekt gjykimi është shembulli më konkret se shkeljet procedurale të cilat rezultuan në deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Deklaratës Mjedisore nuk ndikojnë në procedurën e zhvilluar nga MEI. Por, edhe sikur këto shkelje të kishin ndikuar, pavarësisht tyre, pasojat do të ishin të njëjta".*

Duke e konsideruar flagrant këtë qëndrim të Avokaturës së Shtetit, Gjykata e Apelit Administrativ nuk mund të pranojë se, edhe pse përfaqësojnë akte të të njëjtës procedurë, kontrata koncesionare nuk kushtëzohet nga vlefshmëria e deklaratës mjedisore/vlerësimi i ndikimit në mjedis.

Në vlerësimin e Gjykatës së Apelit Administrativ, nuk ka dhe nuk mund të ketë referencë që të përligjë qëndrimin e Avokaturës së Shtetit se, procedura nga MEI do të kishte

vijuar dhe se kontrata koncesionare do të ishte nënshkruar, megjithë problematikat e deklaratës mjedisore, pra megjithë mungesën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Gjykata e Apelit Administrativ tërheq në këtë kontekst vëmendjen mbi faktin se, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë ka vendosur standardin sipas të cilit, mungesa e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, përbën shkelje procedurale të tillë që pasjell pavlefshmërinë e çdo akti administrativ në funksion të të cilit ai miratohet.

Në konfirmim të këtij standardi, Gjykata e Apelit Administrativ vlerëson se, ankimet e të paditurve dhe Avokaturës së Shtetit, nuk përmbajnë shkaqe për ndryshimin në favor të tyre, të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Shpenzime gjyqësore lidhur me këtë çështje, në Gjykatën e Apelit Administrativ, nuk u kryen.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në Nenin 50/b të Ligjit Nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, unanimisht:

### **VENDOSI**

- Lënien në fuqi të Vendimit Nr.1813 (1845) Dt.02.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Shpenzime gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ, nuk u kryen;
- E drejta e rekursit kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmyja e komunikimit të tij të arsyetuar, palëve ndërgjyqëse.

U shpall sot në Tiranë, më 27 të Qershorit 2024.

**ANËTAR**  
Eriol ROSHI  
dv

**ANËTARE**  
Altina NASUFI  
dv

**KRYESUESE**  
Blerona HASA  
dv

Vërtetohet njësisht me origjinalin

*Kancelari  
Leonard Stajaj  
Stajaj*